



UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
PROGRAMI I DOKTORATURËS “SHKENCA EKONOMIKE”

**“PROBLEMATIKAT DHE ROLI I KONTROLLIT
TATIMOR NË PERFORMANCËN E
ADMINISTRATËS TATIMORE NË SHQIPËRI”**

UDHËHEQËSI SHKENCOR
Prof. As. Dr. Shkëlqim Fortuzi

DISERTANT
Nevila Kiri, Msc

Korrik, 2016

Copyright
i
Nevila KIRI
2016

Udhëheqësi i Nevila KIRI vërteton se ky është version i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:

**“PROBLEMATIKAT DHE ROLI I KONTROLLIT
TATIMOR NË PERFORMANCËN E ADMINISTRATËS
TATIMORE NË SHQIPËRI”**

Prof. As. Dr. Shkëlqim Fortuzi

“PROBLEMATIKAT DHE ROLI I KONTROLLIT TATIMOR NË PERFORMANCËN E ADMINISTRATËS TATIMORE NË SHQIPËRI”

Përgatitur nga: Nevila KIRI, Msc

Disertacion i paraqitur në

Fakulteti i Biznesit

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Në përputhje të plotë

Me kërkesat

Për gradën “Doktor”

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Korrik, 2016

FALENDERIME

Finalizimi i këtij disertacioni është rezultat i një pune të gjatë dhe i bashkëpunimit me shumë persona.

Së pari, falenderoj udhëheqësin Prof. As. Dr. Shkëlqim Fortuzi, për udhëzimet profesionale dhe mbështetjen gjatë realizimit të punimit.

Së dyti, falenderoj profesorët e Shkollës së Doktoraturës të Fakultetit të Biznesit, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, që kontribuan në rritjen profesionale dhe më krijuan mundësinë të paraqes disertacionin për mbrojtje.

Së fundmi, falenderoj të gjithë personat e tjerë që më ndihmuan direkt ose më inkurajuan në realizimin e punimit.

Deklaratë mbi origjinalitetin

Nevila Kiri

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam e vetëdijshme se në rast të mospërputhjeve, Këshilli i Profesorëve të UAMD-së është i ngarkuar të më revokojë gradën “Doktor”, që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me “Rregulloren e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë (Doktoratë) të UAMD-së, neni 33, miratuar prej Senatit Akademik të UAMD-së me Vendimin nr. _____, datë _____.

Durrës, më _____

Firma

Përmbledhje

Shumica e vendeve në tranzicion po përjetojnë nivele të larta të evazionit fiskal dhe shmangies tatimore kështu administratës tatimore (qeverisë) në Shqipëri i lind nevoja të evidentojë problematikat e politikës fiskale, faktorët ndikues të sjelljes së tatimpaguesve dhe të përforcojë strukturat e veta me qëllim përmirësimin e situatës dhe arritjen e një rezultati më të mirë në realizimin e të ardhurave tatimore.

Një komponent i rëndësishëm i administratës tatimore është kontrolli tatimor. Kontrolli nga administrata tatimore është një ekzaminim i deklaratave tatimore, llogarive, librave dhe regjistrimeve tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin, që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta. Administrata tatimore kontrollon saktësinë e të gjitha dokumenteve, që kanë të bëjnë me statusin ligjor, rezidencën, veprimtarinë ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore, si dhe çdo dokument tjetër me ndikimin në përcaktimin e detyrimit tatimor (ligji nr. 9920 datë 19.05.2008, Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar). Objektivi i përgjithshëm i kontrollit tatimor është të vlerësojë riskun e paraqitjes së detyrimeve tatimore më të vogla dhe të hartojë procedurë për të testuar atë risk (Manuali i Kontrollit, 2011).

Në një studim të realizuar nga Forumi Kombëtar i Biznesit në qershor të vitit 2014 u konstatua se shqetësimet e biznesit në lidhje me kontrollin tatimor kanë të bëjnë ndonjëherë me dispozitat ligjore si në rastin e procesit të ankimimit, por në pjesën më të madhe të rasteve ato lidhen me procesin e zbatimit të kontrollit tatimor.

Ky punim ka si synim të trajtojë problematikat e politikës fiskale aktuale, të evidentojë faktorët ndikues në sjelljen e tatimpaguesve dhe elementët ndikues në efikasitetin e administratës tatimore dhe të pasqyrojë ndikimin e kontrollit tatimor në performacën e administratës tatimore.

Motivimi kryesor i këtij studimi përkon me evidentimin e problemeve si nga ana e tatimpaguesve ashtu edhe nga ana inspektorëve tatimor me qëllim përmirësimin e performancës së administratës tatimore.

Sjellja jo transparente e tatimpaguesve ndikon negativisht në burimet e disponueshme për të financuar shërbimet publike. Kjo krijon shtrembërim dhe pabarazi, duke dëmtuar tatimpaguesit e ndershëm. Gjithashtu, kjo sjellje kërkon ndërhyrjen e qeverisë në vendosjen e një rregulli dhe ndërtimin e një gjykimi fiskal. Efikasiteti e kontrollit tatimor ka një ndikim të rëndësishëm në marrëdhëniet e autoriteteve tatimore dhe tatimpaguesve. Megjithatë, autoritetet tatimore duhet të gjejnë edhe mjete të tjera për të luftuar mashtrimet, veçanërisht ndërtimin e marrëdhënieve të besimit mes autoriteteve tatimore dhe tatimpaguesve (Ameur, Tkiouat, 2012).

Fjalët kyçe: problematikat e politikës fiskale, efikasiteti e administratës tatimore, kontrolli tatimor, niveli i deklarimit të të ardhurave

Summary

Most emerging economies are facing a high rate of tax evasion and tax avoidance, thus tax administration needs to identify fiscal policy problems, factors affecting taxpayers's behaviour, to consolidate its own structure aiming to improve the situation and achieve a high performance in tax collections.

One important component of tax administration is also tax audit. Tax audit of tax administration is an examination of all tax declarations, accounts and all business transactions, including all documents regarding revenues, expenses, assets, liabilities and financial transactions with third parties. Tax administration controls all documents regarding legal status, residency, economic activity, payments, tax liabilities, and all other documents important to tax liability calculation (law number 9920, date 19.05.2008, For Tax Procedures in Republic of Albania). The general objective of a tax audit is to evaluate the risk of underestimating the tax liabilities and to draw up a procedure to test that risk. In another study done by the National Business Forum in June 2014, it is noticed that the problems of business regarding tax audit are related to the process of audit control more than law's provisions.

This study tends to deal with problems that create actual fiscal policy, to evidence factors affecting legal compliance of taxpayer and efficiency of tax administration and to emphasize the role of tax audit in tax administration's performance.

The motivation for this research is related to facing taxpayers and tax administration employees' problems aiming to improve the performance.

Noncompliance tax behaviour affects negatively resources available to finance public expenditure. This creates inequality affecting honest taxpayers. Moreover, this behaviour necessitates government intervention in establishing rules and building a fiscal judgement. Efficiency of tax audit has an important influence in the relationship between tax authorities and taxpayers. Tax authorities should find other tools to fight fraud, especially building credibility relationship between tax authorities and taxpayers (Ameur, Tkiouat, 2012).

Key words: fiscal policy problems, efficiency of tax administration, tax audit, level of revenues declared

Tabela e përmbajtjes

Falenderime
Deklaratë mbi origjinalitetin
Përmbledhje
Tabela e përmbajtjes
Lista e tabelave
Lista e figurave
Lista e shkurtimeve

KAPITULLI 1. HYRJA	14
1.1 Parathënie	14
1.2 Identifikimi i çështjeve të kërkimit.....	15
1.3 Qëllimi i studimit.....	16
1.4 Objektivat e studimit	17
1.5 Modeli konceptual i studimit.....	17
1.6 Pyetjet kërkimore	18
1.7 Metodologjia e studimit.....	18
1.8 Rëndësia e studimit	19
1.9 Kufizimet e studimit	19
1.10 Strukturimi i punimit	20
KAPITULLI 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	21
2.1 Parimet e tatimeve	21
2.2 Klasifikimi i tatimeve	22
2.2.1 Tatimi i vetëm ose i shumëfishtë	22
2.2.2 Tatimi proporcional.....	23
2.2.3 Tatimi progresiv	23
2.2.4 Tatimet direkte dhe indirekte.....	24
2.3 Drejtësia tatimore	24
2.3.1 Drejtësia horizontale.....	25
2.3.2 Drejtësia vertikale.....	25
2.4 Administrata tatimore në shqipëri	25
2.4.1 Vizioni i administratës tatimore	27
2.4.2 Misioni i administratës tatimore	27
2.4.3 Vlerat e administratës tatimore.....	27

2.4.4	Objektivat e administratës tatimore	27
2.4.5	Qëllimet strategjike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2014 – 2017	28
2.5	Tatimet e rëndësishme sipas legjislacionit në fuqi	30
2.5.1	Tatimi mbi vlerën e shtuar	30
2.5.2	Tatimi mbi të ardhurat	32
2.5.3	Krahasimi i normave me vendet e rajonit dhe ecuria në Shqipëri	34
2.5.4	Sanksionet ligjore	37
2.6	Kontrolli tatimor	42
2.6.1	Karakteristikat e kontrollit tatimor në Shqipëri	42
2.6.2	Baza ligjore e kontrollit tatimor	43
2.6.3	Detyrimet dhe të drejtat e tatimpaguesve	45
2.6.4	Detyrimet e të drejtat e inspektorëve tatimor	47
2.6.5	Procedurat teknike të detajuara për kryerjen e një kontrolli tatimor	47
2.7	Evazioni fiskal	50
2.7.1	Karakteristikat e ekonomisë informale	51
2.7.2	Faktorët ndikues në evazionin fiskal	56
KAPITULLI 3. Metodologjia		68
3.1	Variablat e marrë në studim	68
3.2	Përzgjedhja e kampionit	69
3.3	Përpunimi statistikor i të dhënave të grumbulluara	70
3.3.1	Analizë regressive me shumë variabla	70
3.3.2	Regresion kuantil për modelin e parë	71
3.3.3	Rast studimor i kontrollit tatimor	72
3.3.4	Përpunimi i të dhënave	72
KAPITULLI 4. Analiza e rezultateve dhe gjetjet		73
4.1	Pyetjet kërkimore të punimit	73
4.2	Modelet e ndërtuara	73
4.2.1	Modeli: Përqindja e Deklarimit të të Ardhurave për Efekte Tatimore	73
4.2.2	Modeli: Faktorët ndikues në efikasitetin e administratës tatimore	83
4.2.3	Koment probabilitar për nivelin e deklarimit	85
4.2.4	Regresioni kuantil për deklarimin e të ardhurave për efekte tatimore	86
4.2.5	Analiza e variancës për efektin e statusit ligjor dhe degës mbi evazionin	88
4.3	Analiza përshkuese	88

4.3.1 Analiza përshkruese për pyetësin ndaj tatimpaguesve	88
4.3.2 Analiza përshkruese për pyetësin ndaj punonjësve	93
4.3.3 Rasti studimor në lidhje me drejtorinë rajonale tatimore	98
KAPITULLI 5. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	99
5.1 Konkluzione	99
5.1.1 Konkluzione në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar.....	99
5.1.2 Konkluzione në lidhje me tatimin mbi të ardhurat	100
5.1.3 Konkluzione në lidhje me kontributet	100
5.1.4 Konkluzione në lidhje me kontrollin tatimor	101
5.1.5 Konkluzione në lidhje me politiken fiskale në përgjithësi	101
5.1.6 Konkluzione në lidhje me eficiencën e administratës tatimore	101
5.2 Rekomandime.....	102
5.2.1 Rekomandime në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar	102
5.2.2 Rekomandime në lidhje me tatimin mbi të ardhurat	103
5.2.3 Rekomandime në lidhje me kontributet.....	103
5.2.4 Rekomandime në lidhje me kontrollin tatimor.....	103
5.2.5 Rekomandime në lidhje me përmirësimin e eficiencës së administratës tatimore	104
5.2.6 Rekomandime për studime të mëtejshme	104

BIBLIOGRAFIA

APENDIKSET

LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1 Normat e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi.....	32
Tabela 2.2 Krahasimi nivelit të normave tatimore me vendet e rajonit.....	34
Tabela 2.3 Indikator tatimor të rëndësishëm	37
Tabela 2.4 Shkeljet dhe sanksionet kryesore.....	38
Tabela 2.5 Indikatorë të matjes së performancës	40
Tabela 2.6 Tregues të Administratës Tatimore krahasuar me vendet e rajonit për vitet 2009 dhe 2010	41
Tabela 2.7 Tregues të Administratës Tatimore në Shqipëri për periudhen 2010-2014.....	42
Tabela 2.8 Baza ligjore ku mbështetet kontrolli tatimor	44
Tabela 2.9 Pësia e zbulimeve tatimore nga kontrolli ndaj të ardhurave të DPT-së.....	50
Tabela 2.10 Përputhshmëria me ligjet fiskale	52
Tabela 2.11 Madhësia e ekonomisë informale në 28 vendet e Bashkimit Europian gjatë viteve 2003 – 2015 (si % ndaj GDP-së).....	53
Tabela 2.12 Madhësia e ekonomisë informale të 3 shteteve europiane (jo anëtare të BE-së) gjatë viteve 2003 – 2015 (si % ndaj GDP-së)	53
Tabela 2.13 Madhësia e ekonomisë informale të 5 shteteve jo europiane shumë të zhvilluara gjatë viteve 2003 – 2015 (si % ndaj GDP-së)	54
Tabela 2.14 Madhësia e ekonomisë informale të mesatareve të ndryshme jo të ponderuara gjatë viteve 2003 – 2015 (si % ndaj GDP-së)	54
Tabela 2.15 Faktorët ndikues të marrë në studimin e evazionit në Malajzi	66
Tabela 2.16 Rezultatet e përpunimit statistikor të studimit për Malajzinë	66
Tabela 4.1 Rezultatet e analizës së regresionit për modelin të parë	74
Tabela 4.2 Testi i heteroskedasticitetit për modelin e parë	77
Tabela 4.3 Testi i korrelacionit serial për modelin e parë	78
Tabela 4.4 Testi i stabilitetit për modelin e parë	79
Tabela 4.5 Rezultatet e analizës së regresionit për versionin e dytë të modelit të parë.....	80
Tabela 4.6 Testi heteroskedasticitetit për versionin e dytë të modelit të parë	81
Tabela 4.7 Testi korrelacionit serial për versionin e dytë të modelit të parë.....	82
Tabela 4.8 Testi stabilitetit për versionin e dytë të modelit të parë.....	82
Tabela 4.9 Hedhja poshtë/vërtetimi i hipotezave	83
Tabela 4.10 Rezultatet e analizës së regresionit për modelin e dytë	84
Tabela 4.11 Testi heteroskedasticitetit për modelin e dytë.....	84
Tabela 4.12 Testi stabilitetit për modelin e dytë	85
Tabela 4.13 Testi korrelacionit serial për modelin e dytë	85
Tabela 4.14 Komenti probabilitar për nivelin e deklarimit	86
Tabela 4.15 Komenti probabilitar për nivelin e deklarimit	86
Tabela 4.16 Regresioni kuantil.....	87
Tabela 4.17 Analiza e variancës për efektin e statusit ligjor dhe degës mbi evazionin.....	88
Tabela 4.18 Zbulimet ndër vite nga kontrolli tatimor	98

LISTA E FIGURAVE

Figura 1.1 Modeli konceptual i parë i studimit	17
Figura 1.2 Modeli konceptual i i dytë i studimit	18
Figura 2.1 Tatimi proporcional.....	23
Figura 2.2 Tatimi progresiv.....	24
Figura 2.3 Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në Shqipëri.....	26
Figura 2.4 Ecuria e të ardhurave të grumbulluara nga TVSH	31
Figura 2.5 Ecuria e të ardhurave të grumbulluara nga TAP	32
Figura 2.6 Ecuria e të ardhurave të grumbulluara nga TF.....	33
Figura 2.7 Krahasimi i normave me vendet e rajonit	35
Figura 2.8 Ecuria e të ardhurave tatimore në vite në Shqipëri	35
Figura 2.9 Struktura e të ardhurave në Shqipëri.....	35
Figura 2.10 Numri i tatimpaguesve ndër vite	36
Figura 2.11 Struktura e tatimpaguesve	36
Figura 2.12 Nivelet e matjes së performancës.....	41
Figura 2.13 Ekonomia informale.....	55
Figura 2.14 Pengesat kryesore të zhvillimit të ekonomisë	55
Figura 2.15 Krahasimi me vendet e Europës juglindore dhe BEEPS.....	56
Figura 2.16 Faktorët ndikues në ekonominë informale	62
Figura 4.1 Testi i normalitetit për modelin e parë	76
Figura 4.2 Testi i normalitetit për versionin e dytë të modelit të parë.....	80
Figura 4.3 Testi i normaliteti për modelin e dytë	85
Figura 4.4 Problematikat për TVSH.....	89
Figura 4.5 Problematikat për TA.....	90
Figura 4.6 Problematikat për Kontributet.....	91
Figura 4.7 Problematikat për Kontrollat Tatimore	92
Figura 4.8 Problematikat për Politiken Fiskale	92
Figura 4.9 Struktura e mostres sipas gjinisë	93
Figura 4.10 Struktura e mostres sipas moshës.....	93
Figura 4.11 Struktura e mostres sipas arsimit.....	94
Figura 4.12 Problematikat në lidhje me politiken fiskale.....	95
Figura 4.13 Efiçienca e administratës tatimore	95
Figura 4.14 Objektiviteti i administratës	96
Figura 4.15 Sistemi informatik.....	96
Figura 4.16 Cilësia e kontrollit.....	97
Figura 4.17 Trajtimi punonjësve	98
Figura 4.18 Realizimi i të ardhurave përkundrejt zbulimeve të kontrollit	98

LISTA E SHKURTIMEVE

TVSH – Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

TA – Tatimi mbi të Ardhurat

TF – Tatimi mbi Fitimin

TAP – Tatimi mbi Të Ardhurat Personale

DPT – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

MF – Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë

AT – Administrata Tatimore

GDP – General Domestic Product (Prodhimi i Brendshëm Bruto)

BEEPS – Business Environment and Enterprise Performance Survey (Raporti i Mjedisit
të Biznesit dhe Performancës së Sipërmarrjeve)

KAPITULLI 1. HYRJA

1.1 PARATHËNIE

Një pjesë e madhe e ekonomive në botë por veçanërisht e vendeve në tranzicion ballafaqohen me nivele të larta të evazionit fiskal dhe shmangies tatimore. Administrata tatimore duhet të analizojë faktorët që influencojnë nivelin e deklarimit të të ardhurave nga ana e tatimpaguesve konkretisht evidentimin e problematikave të kësaj politike fiskale në lidhje me TVSH, TA, Kontibutet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe të konsolidojë infrastrukturen me qëllim përmirësimin e situatës në mënyrë që të arrijë një performancë më të mirë në realizimin e të ardhurave tatimore. Kontrolli tatimor mbetet një nga çështjet më të trajtuara në këtë rast. Pavarësisht se ekzitojnë edhe struktura të tjerë të rëndësishme që ndikojnë në performancën e administratës tatimore, kontrolli tatimor ka një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e ndërgjegjësimit të tatimpaguesve. Cilësia e kontrollit tatimor është trajtuar si një nga treguesit bazë të performancës së administratës tatimore që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në grumbullimin e të ardhurave tatimore. Evazoni fiskal dhe shmangia tatimore sjell nivel të ultë të realizimit të të ardhurave e cila shkakton në nivele të ulëta të investimeve publike. Objekti i studimit do të jetë evidentimi i problematikave aktuale të politikës fiskale, identifikimi i faktorëve ndikues në sjelljen e tatimpaguesve dhe ndikimi i kontrollit tatimor në performancën tatimore. Ekzistojnë studime në lidhje me strukturimin dhe menaxhimin e kontrollit tatimor dhe faktorët që e bëjnë më cilësor një kontroll tatimor. Këto studime theksojnë se një kontroll tatimor i pavarur, i bazuar në vlerësime të sakta të riskut, i realizuar nga persona me integritet dhe profesionalizëm arrin rezultate të dëshiruara.

Me ndryshimet e shpejta të kushteve ekonomike, administratës tatimore u është kërkuar nga qeveritë, ndër vite, të kontribuojnë më shumë dhe të marrin ngarkesa të reja duke synuar që të garantojnë buxhetet me të ardhurat e nevojshme për të realizuar programet ekonomike dhe sociale në përfitim të qytetarëve. Kriza e fundit ekonomike botërore dhe e rajonit ka ndikuar administrimin fiskal duke u kushtëzuar gjithë qeverive të rrisin më shumë performancën tatimore në mbështetje të minimizimit të informalitetit dhe luftës ndaj evazionit fiskal dhe shmangies tatimore.

Në një vend si Shqipëria, ku ekonomia informale është prezente (Banka Botërore, 2015), tatimpaguesit mundohen të shfrytëzojnë të gjitha “mënyrat” që gjejnë për të shmangur pagesën e detyrimeve tatimore. Diferenca mes tatimeve që duhen të mblidhen me ato që janë mbledhur në fakt¹ llogaritet të jetë diku mes 16% dhe 20% për TVSH dhe për tatim fitimin mesatarisht 38%, gjithashtu në qoftë se nuk do të ishin marrë masa për kontrolle tatimore evazoni potencial arrin tek 66% (Banka Botërore, 2015). Gjithashtu, ndryshimet e herëpashershme të legjislacionit tatimor dhe barra tatimore krijon vështirësi tek biznesi deri në gjetjen e rrugëve abuzive. E ndodhur në këto kushte, për administratën tatimore në Shqipëri, mbajtja e një administrate tatimore eficiente dhe efektive është një sfidë e vështirë.

Në të gjitha vendet, kontrolli tatimor luan një rol të rëndësishëm në performancën e administratës tatimore. Qëllimi kryesor i administratës tatimore është ndërgjegjësimi i tatimpaguesve në lidhje me detyrimet tatimore. Një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e

1 Hendeku tatimor

efiçencës dhe efektivitetit të një administrate është implementimi i një sistem kontrolli tatimor të duhur në lidhje me kushtet në të cilën ndodhet vendi.

Ky studim përbën një përpjekje shkencore për të paraqitur problematikat e politikës fiskale aktuale dhe faktorët ndikues në performancën e administratës tatimore në Shqipëri. Nëpërmjet këtij studimi do të bëhet i mundur të provohet lidhja që ekziston midis faktorëve të ndryshëm që janë marrë në studim (që mendohet që ndikojnë efiçencën) dhe efiçencës së administratës tatimore. Njëkohësisht nga një rast studimor, do të shikohet ç'pjesë e të ardhurave realizohet nga kontrolli tatimor nga totali i të ardhurave të grumbulluara.

Ky studim përbën një risi në këtë fushë pasi për Shqipërinë nuk ka studime që kanë trajtuar këto çështje më përpara por edhe do t'i shërbejë menaxherëve të lartë të administratës tatimore dhe politikbërësve për të marrë masat e duhura në mbajtjen nën kontroll të këtyre problematikave.

1.2 IDENTIFIKIMI I ÇËSHTJEVE TË KËRKIMIT

Arritja e një performance të lartë në mbledhjen e të ardhurave dhe vendosja e një marrëdhënie besueshmërie mes tatimpaguesve dhe administratës tatimore është sfidë për administratën tatimore në vendin tonë. Mosdeklarimi i saktë i të ardhurave dhe evazioni fiskal nxjerr në pah nevojën e një analize më të thellë të situatës. Ky studim ka si synim të trajtojë problematikat e politikës fiskale aktuale dhe ndikimin e kontrollit tatimor në performancën e administratës tatimor në Shqipëri.

Motivimi kryesor i këtij studimi përkon pikërisht me evidentimin e problemeve të politikës fiskale aktuale dhe përcaktimin e elementëve dhe natyrës së një kontrolli tatimor efiçient që i nevojitet administratës tatimore në vendin tonë me qëllim përmirësimin e performancës së saj.

Sjellja jo transparente e tatimpaguesve ndikon negativisht në burimet e disponueshme për të financuar shërbimet publike. Kjo krijon shtrembërim dhe pabarazi, duke dëmtuar tatimpaguesit e ndershëm. Gjithashtu, kjo sjellje kërkon ndërhyrjen e qeverisë në vendosjen e një rregulli dhe ndërtimin e një gjykimi fiskal. Efiçienca e kontrollit tatimor ka një ndikim të rëndësishëm në marrëdhëniet e autoriteteve tatimore dhe tatimpaguesve. Megjithatë, autoritetet tatimore duhet të gjejnë mjete të tjera për të luftuar mashtrimet, veçanërisht në ndërtimin e marrëdhënieve të besimit mes autoriteteve tatimore dhe tatimpaguesve (Ameur, Tkouat, 2012).

Për të qënë efektiv një kontroll tatimor, nevojiten të plotësohen disa kërkesa të tilla si:

- përcaktimi i një skeme organizacionale të përgjegjësive të cilat janë fuqitë garantuese të kontrollit tatimor dhe sigurojnë garanci në arritjen e qëllimeve pa ndërhyrje nga jashtë por njëkohësisht pa ndonjë abuzim nga autoritetet kontrolluese;
- krijimi i një platforme ligjore sa më të thjeshtë, të kompletuar dhe fleksibël;
- rekrutimi i stafit të kualifikuar dhe të motivuar për të përmbushur sa më mirë kontrollin tatimor;
- shpërblimi i personelit sipas rëndësisë sociale të punës së tij dhe jo proporcionalisht me gjrobat e vendosura por njëkohësisht dënimi i tyre për shkeljet disiplinore;
- krijimi i një sistemi informatik që informon në çdo kohë;
- zotërimi i paisjeve teknike për të mbështetur efiçencën dhe efektivitetin e administratës tatimore në përgjithësi dhe kontrollit tatimor në veçanti (Ioan, 2011).

Në luftën kundër evazionit, theksohet rëndësia e kostos së kontrollit, reduktimi i saj duke optimizuar madhësinë e stafit ose duke zhvilluar një kontroll elektronik ka të njëjtën vlerë me madhësinë e penaliteteve të aplikuara (Brojba, Dumitru & Belciug, 2010).

1.3 QËLLIMI I STUDIMIT

Administrata tatimore është ndër institucionet më me rëndësi të një vendi. Realizimi i planit nga ana e administratës do të thotë më shumë të adhura për investime publike. Në këtë mënyrë kërkohet një vëmendje kushtuar menaxhimit të strukturave të brendshme të saj.

Qëllimi punimit është të japë një kontribut modest në drejtim të përmirësimit të politikave fiskale, përmirësimit të performancës tatimore dhe rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të tatimpaguesve. Duke patur parasysh që bizneset përballen çdo ditë me një legjislacion tatimor që ndryshon shpesh lind e nevojshme të evidentohen faktorët ndikues në nivelin e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore. Gjithashtu, studimi ka për qëllim të identifikojë elementët ndikues në eficiencën e administratës tatimore në drejtim të përmirësimit të situatës. Element i rëndësishëm i administratës tatimore është dhe kontrolli tatimor i cili ka kontakt të drejtëpërdrejtë me tatimpaguesit dhe ndikon në rritjen e të ardhurave të grumbulluara nga administrata tatimore dhe mbi të gjitha në edukimin dhe ndërgjegjësimin e tatimpaguesve. Nëpërmjet një rasti studimor të një Drejtorie Rajonale Tatimore do të shikohet efekti që ka kontrolli tatimor në të ardhurat e realizuara.

Qëllimi final i studimit është të studiohen problemet e politikës fiskale që influencojnë negativisht mbarëvajtjen e bizneseve e për rrjedhojë në nivelin e detyrimeve tatimore.

Për të kuptuar faktorët ndikues në cilësinë e kontrollit tatimor është e rëndësishme të grumbullohen opinione nga ana e tatimpaguesve por njëkohësisht edhe nga ana e inspektorëve të kontrollit.

Njëkohësisht studimi parashikon të vlerësojë ecurinë në vite të kontrollit tatimor dhe të administratës tatimore. Në këtë mënyrë do shikohet ndikimi i kontrollit tatimor në performancën e administratës tatimore. Në punim do të trajtohet performanca e kontrollit tatimor dhe do jepen sugjerime të një modeli eficient për tu zbatuar në të ardhmen. Në këtë aspekt do analizohen efektet që ka një kontroll jo eficient dhe mënyrat së si mund të përmirësohet në funksion të rritjes së dobishmërisë së tij.

Dy drejtimet kryesore ku përqendrohet analiza e punimit janë: së pari, analiza e situatës aktuale të politikës fiskale; dhe së dyti propozimi i një modeli të faktorëve që ndikojnë sjelljen e tatimpaguesve.

Zgjedhja e kësaj teme u orientua nga problematikat që ka sot administrata tatimore në realizimin e planit të të ardhurave tatimore. Arsytet kryesore janë:

Së pari: nisur nga rëndësia që ka grumbullimi i detyrimeve tatimore përbën interes të studiohen problematikat e politikës fiskale aktuale, faktorët që ndikojnë sjelljen e tatimpaguesve dhe ndikimi që ka kontrolli tatimor në performancën e administratës tatimore.

Së dyti, kontributi modest që mund t'i jepet administratës tatimore në lidhje me faktorët ndikues në rritjen e eficiencës së administratës. Ky studim mund të jetë i rëndësishëm për politikëbërësit, drejtuesit e administratës tatimore, inspektorët tatimor dhe vetë tatimpaguesit.

Së treti, ekzistenca e shumë pak studimeve në këtë fushë në Shqipëri pra, ky punim përbën një risi.

Së katërti, ekzistenca e të dhënave dhe burimeve të informacionit të sigurta dhe të besueshme të marra direkt nga administrata tatimore.

1.4 OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Objektivi kryesor i këtij studimi është krijimi i një kuadri për të studiuar problematikat e politikës fiskale që po ndjek vendi ynë. Fokusi do të jenë problematikat e tatimit mbi vlerën e shtuar, tatimit mbi të ardhurat, kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe kontrollit tatimor.

Objektiv tjetër i punimit është krijimi i një baze teorike për përshkrimin e sistemit tatimor në Shqipëri, legjislacionit aktual, faktorëve ndikues në evazionin fiskal, kontrollit tatimor dhe ndikimin e tij në performancën e administratës tatimore.

Në shtesë të objektivave të mësipërm do të jetë identifikimi i faktorëve ndikues në përqindjen e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore nga ana e tatimpaguesve dhe në efikasitetin e administratës tatimore.

1.5 MODELI KONCEPTUAL I STUDIMIT

Hartimi i një modeli konceptual për studimin ka një ndikim të rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit të kërkimit përfshirë këtu realizimin dhe prezantimin (Berman, 2013). Modeli i studimit paraqet në terma të përgjithshëm çfarë kërkohet të realizohet nga kërkimi. Ky punim, sipas figurës 1.1, synon të identifikojë problematikat e politikës fiskale kryesisht në lidhje me TVSH, TA, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe të kontribuojë në përmirësimin e tyre.




Figura 1.1 Modeli konceptual i parë i studimit

Punimi synon gjithashtu, sipas figurës 1.2, të evidentojë faktorët ndikues në efikasitetin e administratës tatimore duke u bazuar në një rast studimor.




Figura 1.2 Modeli konceptual i i dytë i studimit

1.6 PYETJET KËRKIMORE

Pyetjet kërkimore mbi bazen e të cilave është ngritur studimi janë:

- Cilët janë problematikat e kësaj politike fiskale që po ndjek qeveria?
- Si ndikon skema aktuale e parapagimit të TVSH-së tek biznesi?
- Si ndikon skema aktuale e parapagimit të kësteve të Tatim Fitimit?
- A është e drejtë që ligji kërkon TVSH-në nga biznesi akoma pa arkëtuar pagesen e mallrave të shitur? (përputhja e arkëtimit me pagesat)
- A kanë vështirësi bizneset për të paguar detyrimet fiskale?
- A ndikojnë detyrimet fiskale në rritjen e kredive të këqija?
- Politika e kontrollit tatimor, a është politikë e drejtë? Si ndikon tek bizneset?
- Si ndikojnë politikat tatimore në eficiencën e biznesit?
- Si ndikon kultura e biznesit në pagimin e detyrimeve tatimore?
- Cilët janë faktorët që ndikojnë eficiencën e administratës tatimore?
- Cilët janë faktorët që ndikojnë në nivelin e deklarimit të të ardhurave nga ana e biznesit?

1.7 METODOLOGJIA E STUDIMIT

Punimi konsiston në një kombinim të kërkimit primar dhe atij sekondar. Të dhënat sekondare janë marrë nga grumbullimi i informacionit nga Ministria e Financave, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, libra, artikuj shkencorë dhe faqet e internetit. Kërkimi primar bazohet në dy pyetësorët e ndërtuar kryesisht me shkallë Likert dhe pyetje të hapura. Për analizimin e të dhënave është përdorur analiza përshkruase, regressive me shumë variabla dhe rast studimor. Studimi përfshin qytetin e Durrësit dhe të Shkodrës dhe një rast studimor nga një Drejtori Rajonale Tatimore mbi eficiencën e administratës dhe kontrollin tatimor. Janë shpërndarë dy lloje pyetësorësh: një pyetësor drejtuar tatimpaguesve dhe një drejtuar punonjësve të një administrate tatimore. Pyetjet në lidhje me gjykimet mbi politikën fiskale i janë drejtuar tatimpaguesve dhe punonjësve të administratës tatimore për të marrë një gjykim sa më objektiv dhe për t'i ballafaquar opinionet me njëri tjetrin. Analizimi i të dhënave është realizuar me programin Eviews 7.

1.8 RËNDËSIA E STUDIMIT

Kontributi i parashikuar i këtij punimi nuk mbetet vetëm teorik por synon të zgjerohet duke siguruar një referencë të mirë për ndryshimet potenciale në natyrën e politikës fiskale në Shqipëri dhe në mënyrën e organizimit të administratës fiskale në përgjithësi. Ky studim i ofron politikëbërësve mundësi të kuptojnë problematikat aktuale të politikës fiskale që shqetësojnë bizneset në Shqipëri njëkohësisht të informohen në lidhje me orientimin e sjelljes së tatimpaguesve. Pavarësisht përpjekjeve të administratës tatimore problem shqetësues mbetet evazoni fiskal, informaliteti dhe efizienzja e ulët e administratës tatimore në Shqipëri kështu studimi jep mundësi të identifikohen faktorët ndikues në sjelljen tatimpaguesve dhe të punonjësve të administratës tatimore.

Së pari, nëpërmjet këtij punimi synohet të jepet një kontribut në literaturën mbi kontrollin tatimor dhe mbi efektet e tij në evazionin fiskal në Shqipëri. Ekziston një literaturë e gjerë mbi kontrollin tatimor dhe një sërë studimesh dhe analizash mbi efektet e tij, ndërsa në Shqipëri kjo fushë studimi është ende e re dhe e patrajtuar.

Së dyti, punimi synon të ndihmojë në zgjerimin e njohurive mbi faktorët që ndikojnë nivelin e deklarimit të të ardhurave nga ana e tatimpaguesve. Norma e evazionit fiskal në Shqipëri dhe analiza e kontrollit tatimor nuk janë reflektuar me studime të mirëfillta. Në këtë kuadër punimi ka si qëllim t'ju vijë në ndihmë hartuesve të politikave tatimore, në kushtet kur ekonomia shqiptare është e varur nga kontributi i të ardhurave tatimore në buxhet.

Së treti, punimi ka si qëllim të paraqesë një tablo të faktorëve që ndikojnë në efizienzjen e administratës tatimore.

Së katërti, punimi shërben si pikënisje për studime më të thelluara në fushën tatimore, inkurajon studiuesit e fushës për ta pasuruar më tej literaturën tatimore, të analizojnë problematikat dhe të sugjerojnë domosdoshmërinë e reformave të veçanta dhe përmirësimeve ligjore.

Së pesti, ky punim merr rëndësi praktike, duke qenë se vlerësimet për politiken fiskale aktuale dhe administrimi tatimor ndikojnë në nivelin e evazionit fiskal e për rrjedhojë në nivelin e të ardhurave tatimore.

1.9 KUFIZIMET E STUDIMIT

Përveç rëndësisë së përshkruar më lart të punimit, studimi ka edhe disa kufizime, të cilat ishin të pashmangshme gjatë realizimit të tij.

Së pari, pyetësi drejtuar tatimpaguesve është shpërndarë në qytetin e Shkodrës dhe të Durrësit. Në qoftë se studimi do të përfshinte edhe më shumë qytete të Shqipërisë atëherë kampioni do ishte më i madh, kjo do të ndikonte në arritje të rezultateve më të mira nga pikëpamja statistikore.

Së dyti, pyetësi drejtuar punonjësve të administratës tatimore është përqëndruar vetëm në qytetin e Shkodrës konkretisht në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër. Përfshirja e më shumë Drejtorive Rajonale Tatimore do të kishte kontribuar në një panoramë më të

plotë të treguesve të eficiencës dhe të opinionit të administratës në lidhje me politikën fiskale aktuale. Rasti studimor përfshin vetëm Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër.

Së treti, të dhënat në nivel drejtorie të përgjithshme përfshijnë një hark kohor prej pesë vitesh (2010-2014). Pamundësia për të siguruar informacion për vite të tjera e kufizoi studimin për vitet e përmendura.

Së katërti, një pjesë e pyetësorëve të shpërndarë nuk janë plotësuar ose janë plotësuar në mënyrë jo të rregullt gjë që ul numrin e pjesëmarrësve në studim kjo si pasojë e një interesi të ulët nga ana e bizneseve në plotësimin e pyetësorëve kështu pjesëmarrja në studim përbën një kufizim tjetër. Duhet marrë në konsideratë fakti i subjektivizmit në përgjigjet e dhëna nga ana e të anketuarëve.

1.10 STRUKTURIMI I PUNIMIT

Punim është i realizuar në pesë kapituj që përfshijnë përmbledhjen e literaturës, rezultatet e kërkimit primar dhe konkluzione dhe rekomandime.

Kapitulli I – Hyrja

Në kapitullin e parë bëhet një përshkrim i përgjithshëm i rëndësisë që ka evidentimi i problematikave të politikës fiskale aktuale dhe ndikimit të kontrollit tatimor në performancën e administratës tatimore. Hyrja përfshin gjithashtu qëllimin e studimit, objektivat, modelin konceptual, pyetjet kërkimore, metodologjinë, rëndësinë dhe kufizimet e studimit.

Kapitulli II – Shqyrtimi i literaturës

Kapitulli i shqyrtimit të literaturës do të përfshijë një përshkrim të përgjithshëm të sistemit tatimor në Shqipëri, kontrollit tatimor, faktorëve ndikues në sjelljen e tatimpaguesve dhe në nivelin e deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore. Në këtë kapitull do trajtohen dhe faktorët ndikues në eficiencën e administratës tatimore.

Kapitulli III – Metodologjia e ndjekur dhe instrumentat e përdorur

Në këtë kapitull do të përshkruhet mënyra e përdorur për ti kthyer përgjigje pyetjeve kërkimore. Kapitulli përfshin metodat e përdorura për zgjedhjen e kampionit, mënyrën e realizimit të matjeve, analizat e përdorura, testet e aplikuara si dhe programet e shfrytëzuara për përpunimin dhe paraqitjen e të dhënave.

Kapitulli IV – Analiza e rezultateve dhe gjetjet

Kapitulli përfshin rezultatet e përpunimit të pyetësorëve të grumbulluar, analizën e regresionit, përshkruese, testimin e hipotezave si dhe rezultatet e rastit studimor.

Kapitulli V – Konkluzione dhe rekomandime

Në këtë kapitull paraqiten konkluzionet dhe rekomandimet sipas çështjeve të ngritura për studim si dhe mundësitë për zgjerimin e mëtejshëm të studimit.

KAPITULLI 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 PARIMET E TATIMEVE

Jain, Khanna, Grover dhe Jain (2007) theksojnë se ekonomistë të ndryshëm kanë parashtruar parime të ndryshme në lidhje me ndërtimin e një sistemi tatimor të konsoliduar. Babai i ekonomisë moderne, Adam Smith, ka prezantuar katër parimet e një sistemi tatimor të shëndetshëm.

(1) Parimi i barazisë: *subjektet e secilit shtet duhet të kontribuojë në mbështetje të qeverisë sa më shumë të jetë e mundur, në përpjestim me aftësitë respektive, që do të thotë në përpjestim me të ardhurat që ato marrin në shtetin ku ndodhen.*

Sipas parimit të mësipërm subjektet puguajnë tatime në varësi të aftësisë të tyre, kjo nuk do të thotë që gjithë njerëzit duhet të paguajnë tatime në vlerë të barabartë. Për të pasurit, dobishmëria marxhinale e parasë është më e ulët sesa për të varfërit. Të pasurit duhet të paguajnë më shumë tatime sesa të varfërit. Barazia nënkupton barazinë në sakrificën që bëjnë secili.

(2) Parimi i sigurisë: *tatimi që çdo subjekt duhet të paguajë nevojitet të jetë i sigurtë, dhe jo arbitrar. Koha e pagesës, mënyra e pagesës, sasia që duhet të paguajë duhet të jetë e qartë dhe thjeshtë për çdo person.*

Individët duhet të kenë njohuri në lidhje sasinë e tatimit që është duke paguar. Gjithashtu, tatimpaguesi duhet të informohet në lidhje me kohën që duhet ta realizojë pagesën. Duhet të jepet informacion në lidhje me mënyrën e realizimit të pagesës, pra nëse do bëhet me një shumë të vetme apo me këste dhe vendin e realizimit të pagesës. Një individ duhet ta planifikojë paraprakisht së do të paguajë një tatim dhe në këtë mënyrë pagesa nuk është e vështirë.

(3) Parimi i përshtatshmërisë: *Çdo tatim duhet të vendoset në kohën dhe në mënyrën në të cilën është e përshtatshme për kontribuesin. Çdo tatim duhet të mblidhet në kohën dhe mënyrën në të cilën nuk ka vështirësi për tatimpaguesin ta paguajë atë. Në qoftëse një tatim mblidhet në kohën dhe në mënyrën e cila është e papërshtatshme për tatimpaguesin, edhe një sasi minimale e tatimit do të jetë një barrë për tatimpaguesin. Në qoftëse një tatim mblidhet në kohën dhe në mënyrën e cila është e përshtatshme për tatimpaguesin, tatimpaguesi nuk do t'i shmanget tatimit në një sasi të konsiderueshme.*

(4) Parimi i ekonomizimit: *kostot e mbledhjes së tatimeve duhet të minimizohen. Sistemi tatimor nuk duhet të jetë shumë i shtrenjtë. Çdo tatim duhet të vendoset në atë mënyrë që qeveria të mos ketë shumë shpenzime për mbledhjen dhe tatimpaguesi nuk duhet të shpenzojë shumë në pagesën e tij. Parimi i ekonomizimit mund të shikohet në disa këndvështrime: një tatim i lartë mbi të ardhurat nuk kënaq parimin e ekonomizimit por një tatim i lartë mbi lëndët narkotike dhe pijet alkoolike mund të justifikohet. Duhet të ketë një minimum shpenzimesh në mbledhjen e tatimeve dhe nuk duhet të ketë një ndikim të kundërt në prodhimin dhe dëshirën e njerëzve për kursim dhe investim.*

Megjithëse Adam Smith ka përshkruar katër parimet për ndërtimin e një sistemi tatimor më shumë se 200 vjet më përpara, që nga ajo kohë e deri sot aktivitetet ekonomike kanë pësuar ndryshime të rëndësishme. Disa nga parime shtesë të përmenduar nga ekonomistë të tjerë janë:

(1) Parimi i elasticitetit: sistemi tatimor duhet të jetë i ndërtuar në mënyrë të tillë që në rast nevojë qeveria të ulë apo të rrisë të ardhurat nga tatimet.

(2) Parimi i prodhimit: tatimet duhet të jenë pak në numër por të prodhojnë të ardhura të larta dhe tatimpaguesit nuk duhet të vuajnë shumë. Tatimet nuk duhet të kenë ndikim negativ tek tregtia dhe industria dhe në kapacitetin dhe dëshirën e njerëzve të punojnë, kursejnë dhe investojnë dhe duhet të ekzistojë mundësia për krijimin e të ardhurave të larta në të ardhmen.

(3) Parimi i varietetit: duhet të ekzistojë një sistem i shumëfishtë tatimi në vend të një sistemi tatimor të vetëm. Tatimet duhet të jenë të tipeve të ndryshme kështu që çdo qytetar i vendit përballon në një masë të caktuar barren e tatimit dhe duhet vendosur një balancë mes tatimeve direkte dhe indirekte.

(4) Parimi i thjeshtësisë: sistemi tatimor duhet të jetë i thjeshtë në mënyrë që të kuptohet dhe në këtë mënyrë ka më pak mundësi për evazion fiskal.

(5) Parimi i dëshirueshmërisë: tatimet që vendosen për herë të parë duhet shoqërohen me një justifikim. Tatimet nuk duhen të vendosen më një arsye të gabuar.

(6) Parimi i fleksibilitetit: një tatim duhet të jetë i aftë të ndryshojë lehtë.

(7) Parimi i popullaritetit: tatimet duhet të jenë popullor kështu që punonjësit e tatimeve nuk do të përballen me kundërshtinë e tatimpaguesve ndërsa mbledhin tatimet.

(8) Parimi Bouyancy: sistemi tatimor duhet të jetë i ndërtuar në atë mënyrë që të ardhurat e grumbulluara nga tatimet rriten njëkohësisht me rritjen e të ardhurave kombëtare.

(9) Parimi i koordinimit: qeveritë e nivelit qendror apo lokal vendosin tatime të ndryshme. Një tatim i njëjtë nuk duhet të vendoset nga pushteti qendror dhe lokal pasi do të krijonte probleme për tatimpaguesin.

2.2 KLASIFIKIMI I TATIMEVE

Tatimet vendosen nga qeveritë dhe janë disa llojesh. Sipas Jain, Khanna, Grover dhe Jain (2007), në mënyrë që të vlerësohet buxheti i qeverisë është thelbësore të njihet klasifikimi i tatimeve. Disa nga llojet kryesore të tatimeve janë:

- (1) tatimi i vetëm ose i shumëfishtë;
- (2) tatimet progresive, proporcionale, regresive dhe degresive;
- (3) tatimet ad valorem (sipas vlerës) ose specifike;
- (4) tatimet direkte dhe indirekte.

2.2.1 Tatimi i vetëm ose i shumëfishtë

Kur në një vend të caktuar aplikohet vetëm një tatim, sistemi tatimor i vendit quhet sistem tatimor i vetëm. Por në realitet aplikohen disa lloje tatimesh, ky sistem quhet sistem i shumëfishtë.

Tatimi vetëm nënkupton që vetëm një taksë duhet të aplikohet në një vend. Në qoftëse aplikohet tatimi mbi vlerën e shtuar atëherë nuk do të vendoset asnjë taksë tjetër. Ky tatim mund të jetë proporcional, progresiv, regresiv, direkt, indirekt ose të çdo lloji. Tatimi vetëm është tatimi që vendoset mbi vetëm një gjë, ose të ardhura ose shpenzime. Ky tip sistemi është i thjeshtë, nuk ka shpenzime administrimi dhe shpërndarja e barrës tatimore është e barabartë. Ky lloj sistemi nuk është aktualisht i aplikueshëm në ndonjë vend në botë sepse nuk është praktik dhe nuk ka aftësinë e arritjes së financave publike.

Tatimi shumëfishtë: ky sistem aplikon një gamë të gjërë tatimesh si tatimi mbi të adhurat personale, tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi shitjet etj. Ky sistem është i aplikueshëm

në gjithë vendet e botës, është fleksibël dhe praktik. Meqënëse është një sistem më kompleks është pak i vështirë të kuptohet nga të gjithë. Tatimet duhet të vendosen brenda limiteve kështu njerëzit nuk do përpiqen për t'iu shmangur dhe qeveria duhet të përpiqet që nepërmjet tatimit të mos frenojë prodhimin dhe kursimin në ekonomi. Tatimet duhet të ndihmojnë në shpërndarjen e të ardhurave dhe zhvillimin ekonomik.

2.2.2 Tatimi proporcional

Tatimi proporcional: ky tatim nënkupton që norma e tatimit nuk ndryshon me ndryshimin e të ardhurave. Sipas sistemit proporcional të gjithë paguajnë një pjesë të të ardhurave në formë tatimi. Një pjesë fikse e të ardhurave mbledhet si tatim nga gjithë njerëzit. Për shembull, në qoftëse tatimi është 5%, personi me të ardhura 100£ do të paguajë 5£. Në qoftë se personi ka të ardhura 1,000£ atëherë ai do të paguajë 50£. Tatimi vendoset në një normë fikse ndërkohë të ardhurat luhaten.




Figura 2.1 Tatimi proporcional

Burimi: Jain, Khanna, Grover & Jain (2007)

Në figuren e mësipërme boshti OX tregon bazën tatimore ndërsa boshti OY tregon normën tatimore. TT tregon tatimin proporcional, pavarësisht ndryshimit të bazës tatimore, norma e tatimit mbetet OT. Ky tatim nuk kontribuon në shpërndarjen e pasurisë në shoqëri. Ky sistem është i thjeshtë, i barabartë dhe shpërndarja e pasurisë nuk ndryshon. Fleksibiliteti është i ultë në këtë sistem, nuk gjeneron të ardhurat e nevojshme për qeverinë dhe nuk zvogëlon pabarazitë e pasurisë dhe të ardhurave.

2.2.3 Tatimi progresiv

Tatimi progresiv: ky tatim nënkupton që norma e tij rritet me rritjen e të ardhurave pra, sa më shumë të ardhura të ketë një person aq më i lartë është tatimi progresiv që ai paguan. Në qoftë se një person ka të ardhura 500£ ai paguan 10% tatim por nëse të ardhurat e tij rriten në 1,000£ ai paguan 15% për pasojë nëse e ardhura e tij shkon në 1,500£ tatimi që ai nënshtrohet është 20%.




Figura 2.2 Tatimi progresiv

Burimi: Jain, Khanna, Grover & Jain (2007)

Në figuren e mësipërme vija TT paraqet tatimin progresiv. Në një sistem tatimi progresiv, norma efektive e tatimit rritet sapo rriten të ardhurat kjo sepse një normë më e lartë tatimi vendoset mbi rritjen marxhinale të të ardhurave. Kjo nënkupton që kapaciteti rritet me rritjen e të ardhurave. Në të kundërt, norma e tatimit ulët sapo ka një ulje në të ardhurat personale. Sistemi progresiv i tatimit është i drejtë, fleksibël, barra fiskale shpërndahet më shumë tek të pasurit sesa tek të varfërit, mund të reduktohet pabarazia e të ardhurave dhe mund të sjellë të ardhura më të larta për qeverinë. Gjithashtu, ky sistem tatimor është ekonomik dhe ndihmon në kontrollin e inflacionit.

Anët negative të këtij sistemi janë: ndikon negativisht në formimin e kapitalit, norma e tatimit përcaktohet në mënyrë arbitrare, sipas këtij tatimi individët që punojnë më tepër penalizohen më shumë dhe ekziston një probabilitet më i lartë për evazion fiskal. Konkretisht sistemi progresiv ka këto efekte:

- (1) efekti në prodhim-norma të larta të tatimit progresiv sjellin reduktim të kursimit. Reduktimi i kursimit sjell rënie të investimeve dhe prodhimit. Norma maksimale e tatimeve duhet të jetë mes 25% dhe 30% të totalit të të ardhurave.
- (2) efekti në shpërndarje-normat e larta të tatimit të këtij sistemi mund të ndikojnë tek individët në zvogëlimin e dëshirës për punë dhe për rrjedhojë në rritjen ekonomike.

2.2.4 Tatimet direkte dhe indirekte

Sipas Rrumbullaku (2015) ky klasifikim i tatimeve ka të bëjë me mënyren si mblidhen tatimet. Tatimet direkte mblidhen nga tatimpaguesit që duhet ta përballojnë barren fiskale dhe zakonisht kanë një agjent të mbajtjes së tatimit në burim dhe nuk kanë kontakte me administratën tatimore. Tatimet indirekte nuk mblidhen direkt nga tatimpaguesit që u takon ta përballojnë tatimin, paguhen nga një person dhe administrohen nga një autoritet tjetër.

2.3 DREJTËSIA TATIMORE

Ekzistojnë disa pikëpamje në lidhje me drejtësinë e sistemeve tatimore. Megjithatë debatet në këtë fushë karakterizohen nga elementë subjektivë.

2.3.1 Drejtësia horizontale

Sipas Rrumbullaku (2015), drejtësia horizontale, në një sistem tatimor, i referohet situatës kur tatimpagues të njëjtë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Përkufizimi i mësipërm implikon dy çështje: në çfarë aspekti shihet barazia e tatimpaguesve dhe si trajtohen dy tatimpagues në të njëjten situatë.

Megjithatë, shpesh matjet (të ardhurat, shpenzimet dhe aftësia paguese) pasqyrojnë rezultatet e vendimeve të njerëzve dhe nuk janë me të vërtetë indikator të pozicionit real të tyre. Le të marrim në konsideratë dy tatimpagues, të cilët realizojnë 15£ për orë secili. Zoti D zgjedh të punojë 2,000 orë ndërsa zoti L zgjedh të punojë 2,500 orë çdo vit. Të ardhurat e D-së janë 30,000£ dhe të L-së janë 37,500£, në këtë mënyrë ato nuk janë në pozicione të barabarta. Nga ana tjetër, D dhe L janë të barabartë sepse kapacitetet fituese të tyre janë të njëjta (Rosen, 2003).

Feldstein (1976) sugjeroi dobinë si një alternativë tjetër e matjes së pozicionit të barabartë nëpërmjet të ardhurave. Dobia horizontale nënkupton se: nëse dy individë përjetojnë të njëjten shkallë dobie kur nuk taten ato duhet të jenë po njësoj mirë nëse taten dhe nëse njëri është më keq se tjetri para tatimit, ai duhet të jetë më keq edhe pas tatimit.

2.3.2 Drejtësia vertikale

Sipas AICPA (2007), drejtësia vertikale nënkupton që barra tatimore duhet të bazohet në aftësinë paguese të tatimpaguesve. Në këtë rast shfaqen tre probleme kryesore:

- përcaktimi i kategorive të tatimpaguesve që do paguajnë një tarifë më të lartë bazuar në një kriter të parapërcaktuar;
- zbatimi i kriterit;
- përcaktimi i masës se sa duhet të paguajë më shumë personi kur gjendet në kategorinë e personave që duhet të paguajnë më tepër (Rrumbullaku, 2015).

Janë propozuar tre kritere për të gjykuar nëse një person duhet të paguajë më tepër tatim. Zakonisht, vendet që kanë sisteme tatimore jo të komplikuar, tentojnë të taksojnë kryesisht aftësinë kontribuese, ndërsa vendet me sisteme tatimore komplekse përfshijnë më tepër indikator në vendosjen e detyrimeve tatimore. Kriteret e vlerësimit të propozuara janë:

- përcaktimi i nivelit më të lartë të mirëqënies;
- përcaktimi i një niveli aftësie kontribuese më të madhe;
- përcaktimi nëse siguron një përfitim të madh nga qeveria (Rrumbullaku, 2015).

Në Shqipëri, Ministria e Financave harton politiken tatimore duke marrë në konsideratë propozimet e ekspertëve dhe pastaj parlamenti apo këshilli i ministrave i miraton ato. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve së bashku me Drejtoritë Rajonale Tatimore merret me administrimin, pra me procesin e grumbullimit të tatimeve.

2.4 ADMINISTRATA TATIMORE NË SHQIPËRI

Administrata Tatimore ka si funksion të administrojë tatimet dhe taksat kombëtare sipas legjislacionit tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.




Figura 2.3 Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në Shqipëri

Burimi: Drejtoria e përgjithshme e tatimeve marrë nga www.tatime.gov.al

Administrata Tatimore ka si mision të inkurajojë dhe të arrijë shkallen më të lartë të zbatimit dhe respektimit vullnetar të detyrimeve tatimore dhe të sigurojë shkallë të lartë të besimit publik ndaj integritetit dhe efikasitetit të administratës tatimore.

Administrata Tatimore ka si detyrë të sigurojë zbatimin në mënyrë të saktë të legjislacionit tatimor, të përcaktojë dhe të sigurojë kuptimin dhe zbatimin e arsyeshëm të dispozitave të këtyre ligjeve, në funksion të ligjit “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjeve specifike tatimore dhe dispozitave përkatëse nënligjore, duke trajtuar në mënyrë të njëjtë dhe të paanëshme të gjithë tatimpaguesit.

Zbatimi i legjislacionit ka dy komponentë kryesor ndërgjegjësimin dhe edukimin e tatimpaguesve dhe popullatës për përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore, dhe kontrollin tatimor efikas. Plotësimi vullnetar i detyrimeve tatimore dhe zbatimi efikas i legjislacionit tatimor kërkon vendosjen e ekuilibrit të drejtë të burimeve të administratës tatimore ndërmjet edukimit dhe shërbimit ndaj tatimpaguesve nga njëra anë, dhe një kontroll efikas dhe masa shtrënguese efektive nga ana tjetër (Manuali i kontrollit tatimor, 2011).

Sipas planit strategjik, 2014-2017, administrata tatimore ka synim të vazhdojë të luftojë njëanshmërinë në përdorimin e masave shtrënguese për të eliminuar problemet dhe çdo të papritur në bashkëpunimin e saj me tatimpaguesit duke pasur parasysh:

- menaxhimin strategjik për të arritur misionin e saj organizativ, ndërkohë që menaxhon marrëdhënien me mjedisin ku ushtron veprimtarinë;
- vendimet dhe veprimet që kanë fokus hartimin dhe zbatimin e strategjive të planifikuara për të arritur objektivat e vendosur;
- procesin e analizimit aktual të mjedisit dhe identifikimin e problematikave të së ardhmes;
- azhornimin e administratës tatimore me ndryshimet me mjedisin.

2.4.1 Vizioni i administratës tatimore

Administrata tatimore tenton të jetë bashkëpunuese me komunitetin e biznesit dhe me qytetarët nëpërmjet administrimit efektiv dhe eficient të një politike tatimore të drejtë dhe të paanshme, me qëllim që tatimpaguesit t'i përmbushin me vullnet të lirë kërkesat dhe detyrimet që përmban legjislacionit tatimor (Planit Strategjik i AT, 2014-2017).

2.4.2 Misioni i administratës tatimore

Misioni i administratës tatimore, sipas planit strategjik të AT, 2014-2017, është:

- zbatimi me efektivitet dhe eficientë i legjislacionit tatimor;
- trajtimi i barabartë i tatimpaguesve në përmbushjen e detyrimeve tatimore;
- ofrimi i shërbimeve cilësore për tatimpaguesit;
- rritja e herëpashershme e aftësive profesionale të inspektorëve tatimorë dhe krijimi i një administrate tatimore profesionale dhe të motivuar;
- lehtësimi i tatimpaguesve në përmbushjen e detyrimeve tatimore.

2.4.3 Vlerat e administratës tatimore

Sipas planit strategjik të AT, 2014-2017, vlerat e administratës tatimore janë:

- *integriteti*, për t' i kryer detyrat me vërtetësi, ndershmëri dhe në mënyrë transparente;
- *përgjegjshmëria* për veprimet dhe rezultatet;
- *transparenca*, për të qenë e ndjeshme, e shpejtë, e drejtë dhe objektive në marrëdhëniet me tatimpaguesit dhe të interesuar të tjerë, duke forcuar besimin mes dy palëve;
- *profesionalizmi*, për t' i rritur përpjekjet në drejtim të përmirësimit të performancës dhe kompetencës me fokus arritjen e rezultateve më të mira;
- *krijimtaria*, për të nxitur ide, metoda, procese dhe praktika të reja;
- *bashkëpunimi*, për të bashkëpunuar sëbashku me tatimpaguesit dhe të interesuarit e tjerë për të arritur qëllimet e përbashkëta.

2.4.4 Objektivat e administratës tatimore

Objektivat e administratës tatimore janë:

- Mbledhja e të ardhurave të parashikuara nëpërmjet:
 1. implementimit efektiv dhe eficient të legjislacionit tatimor;
 2. realizimit dhe zbatimit të një programi “E-Taxation”;
 3. publikimit të legjislacionit tatimor, rregullave dhe procedurave në zbatim të tij;
 4. vetëvlerësimit dhe vetëdeklarimit të detyrimeve tatimore, ndjekjes së ndryshimeve në mjediset e biznesit, përshtatjes së sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës për të arritur efektivitetin dhe eficientë;
 5. rritjes së vazhdueshme të aftësive profesionale në mbledhjen e të ardhurave dhe zvogëlimin të evazionit tatimor.

- Identifikimi dhe zvogëlimi i mundësive të mospërbushjes së objektivave të administratës tatimore;
- Sigurimi i shërbimeve cilësore për tatimpaguesit;
- Përdorimi në mënyrë të paanshme i masave për plotësimin e kërkesave të legjislacionit tatimor (Planit Strategjik i AT, 2014-2017).

2.4.5 Qëllimet strategjike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2014 – 2017

1. Shërbim i përmirësuar dhe modern për tatimpaguesit në funksion të lehtësimit të përbushjes së detyrimeve ligjore tatimore. Treguesit e performancës të administratës lidhen me:

- Shërbim cilësor elektronik i avancuar për tatimpaguesit;
- Plotësimi i detyrimeve të legjislacionit tatimor me kosto më të ulëta për tatimpaguesit;
- Eficiencë e rritur e zyrtarëve të administratës tatimore, si rezultat i përdorimit të teknologjisë së re - “E-Taxation” të informacionit, që zyrtarët të analizojnë kontrollin e deklaratave tatimore;
- Ulje në mënyrë të konsiderueshme e mundësive të mospërbushjes së kërkesave të legjislacionit tatimor.

2. Përmirësimi i performancës tatimore bazuar në strategjinë e Modelin e RI të riskut të pajtueshmërisë me tatimet dhe taksat:

- Frenimi i evazionit dhe mashtrimit tatimor;
- Përdorimi i gjithë alternativave të mundshme për rritjen e pajtueshmërisë ligjore;
- Shërbime të mundshme për tatimpaguesit, që konsiderohen të përshtatshme për këtë qëllim;
- Përdorim i një Modeli të Ri Risku për të evidentuar taksapaguesit që kanë sjellje të njëjta. Rritja e vëmendjes tek tatimpaguesit që konstatohen me shkelje të mëdha;
- Zhvillimi i Modelit të Ri të Riskut në DPT mbështetur në:
 - Zhvillimin e modelit të bazuar në Program TI “E-Taxation”
 - Edukimim e grupeve të veçanta të tatimpaguesve dhe segmenteve të industrisë për të rritur pajtueshmërinë;

3. Zgjidhja efektive e problemit të mospërbushjes tatimore:

- Përmirësimi i kapaciteteve administrative;
- Përmirësimi i kapaciteteve administrative dhe procedurave në fushën e TVSH – së; (veçanërisht, lëshimi dhe kontrolli i faturës tatimore me TVSH);
- Përmirësimi i procedurave tatimore në drejtoritë rajonale tatimore;
- Përmirësimi i procedurave të kontrollit tatimor nëpërmjet analizës së riskut.

4. Përmirësimi i procedurave të kontrollit tatimor nëpërmjet:

- Modelit të Ri të Riskut për përzgjedhjen e tatimpaguesve që do t'i nënshtrohen kontrollit;
- Sistemit të teknologjisë së informacionit, “E- Taxation”.

Tatimpaguesit do të përzgjidhen për kontroll mbi bazën e shenjave të marra dhe përpunuara nëpërmjet Modelit të RI të Riskut dhe Sistemit “E-taxation”. Proçedurat e përmendura do të sigurojnë zbatimin e parimit të drejtësisë në procedurën e të tatuarit.

Përmbushja e detyrimeve tatimore dhe dorëzimi në kohë i deklaratave të sakta tatimore është baza e sistemit të vetëdeklarimit dhe për këtë qëllim administrata tatimore do të planifikojë riprojektimin e proceseve të saj për t’u fokusuar në përmirësimin e përqindjes së përmbushjes së legjislacionit tatimor nëpërmjet zbatimit të masave që synojnë identifikimin e fushave të riskut dhe parimet e menaxhimit të riskut, me qëllim që kapacitetet ekzistuese të kontrollit tatimor të përdoren në mënyrën më të arsyeshme të mundshme për të kontrolluar tatimpaguesit më me risk.

Administrata tatimore do të vazhdojë me projekte të kontrollit tatimor që synojnë:

- harmonizimin e procedurave në nivel të administratës tatimore;
- përzgjedhjen në mënyrë objektive të tatimpaguesve për kontroll;
- rritjen e efikasitetit të kontrollit tatimor me anë të rishikimit të burimeve njerëzore për kontrollin e atyre tatimpaguesve që klasifikohen me më shumë risk duke ndjekur rezultatet e analizës së riskut;
- përmirësimin e elementëve të riskut që evidentohen gjatë kontrolleve tatimore;
- prezantimin dhe përdorimin e mjeteve të kompjuterit për e-kontroll;
- monitorimin cilësor të rezultateve të kontrollit tatimor nëpërmjet zbatimeve të sistemit të informacionit të administratës tatimore;

5. Përmirësimi i performancës në lidhje me taksat e arkëtueshme dhe borxhet:

- Thjeshtimi i procedurave
- Përmirësimi i aftësive menaxhuese të burimeve njerëzore
- Politika e borxheve:
 - Përcaktimi detyrimeve të prapambetura - të pambledhshme – të parashkruara.
 - Rishikimi i rritjes së vlerësimeve kur tatimpaguesit nuk kanë paraqitur deklaratën e të ardhurave, kjo ka çuar në rritjen e borxhit të pambledhshëm.
 - Rihartimi skemës për parapagimin e tatimit mbi fitimin me qëllim dekurajimin e nënraportimit të fitimit në deklaratën vjetore.

6. Përmirësimi i sistemit të teknologjisë së informacionit të administratës tatimore:

- Modernizimi i sistemit të teknologjisë së informacionit, për shembull:
 - ulje e kohës së pagimit të taksave;
 - ulja e kostove administrative për administratën dhe tatimpaguesit;
 - shmangien e kontakteve të tatimpaguesit me administratën tatimore;
 - përmirësimi i të bërit biznes në Shqipëri.

7. Krijimi i një ndërfaqeje fikse midis sistemit tatimor dhe thesarit:

- Krijimi i një faqe direkte midis zyrave të tatimeve dhe sistemit të thesarit në mënyrë që Departamenti i Thesarit të njihet në bazë ditore, dhe jo vetëm njëherë në muaj me tatimet e mbledhura.

- Rimbursimi tvsh-së

8. Përgatitja për anëtarësimin në BE, duke përmbushur kërkesat që rrjedhin nga përmbushja e kushteve të Bashkimit Europian për të siguruar që informacioni i dhënë të jetë i përshtatshëm dhe i krahasueshëm me atë të vendeve të tjera kandidate potenciale (Planit strategjik i AT, 2014-2017).

2.5 TATIMET E RËNDËSISHME SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI

Në Shqipëri, të ardhurat tatimore grupohen në tre grupe kryesore: (a) tatime indirekte (TVSH, akciza, lojrat e fatit, të tjera tatime indirekte), tatime direkte (tatimi mbi fitimin, tatimet mbi të ardhurat personale, tatimi mbi kapitalin); (b) tatime dhe taksa vendore, si dhe (c) kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

2.5.1 Tatimi mbi vlerën e shtuar

Ideja e TVSH-së erdhi nga një biznesmen gjerman Siemens në vitin 1920. TVSH-ja u aplikua për herë të parë në Francë, në vitin 1954 (Minh Le, 2003). Ndërsa në vitin 1968 filloi aplikimi në shkallë të gjërë e të plotë i mekanizmit të TVSH-së. Sot është adoptuar nga më se 70 vende (përfshirë ato të komunitetit evropian), shumica e vendeve të Amerikës së Jugut, Afrika e Jugut, Izraeli, Korea e Jugut dhe Japonia.

Në Europë, TVSH-ja filloi të aplikohet nga data 17.05.1977 me hyrjen në fuqi të Direktivës 6. Kjo Direktivë sinkronizoi në nivel të secilit prej shteteve anëtare të Bashkimit Europian, çështjet bazë të TVSH-së që janë:

- vlera e tatueshme;
- momenti i furnizimit;
- fusha e aplikimit të TVSH-së;
- regjimi i kreditimit të TVSH-së;
- territori, vendi i furnizimit.

Sipas të dhënve të DPT-së, në Shqipëri, tatimi mbi vlerën e shtuar zëvendësoi tatimin mbi qarkullimin, tatim i cili taksonte një nivel qarkullimi të caktuar me shkallë tatimore prej 15%.

- TVSH-ja është aplikuar për herë të parë në muajin korrik të vitit 1996. Shkalla tatimore standarte ishte 12.5% dhe subjekte të tij ishin të gjithë tatimpaguesit që realizonin një qarkullim më të madh se 2 milion lekë për çdo vit kalendarik.
- Në tetor 1997, pas krizës piramidale, filloi aplikimi i shkallës tatimore standarte 20%.
- Në janar 2011- aplikohet shkalla e reduktuar e TVSH-së prej 10 për qind- furnizimi i barnave dhe i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i tatueshëm, me shkallën tatimore 10 për qind - ndryshuar me Ligj Nr. 10363, datë 16.12.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.181, dhjetor 2010.
- Në janar 1998, pragu i regjistrimit bëhet 5 milion lekë.
- Në 1 janar 2001, pragu i regjistrimit bëhet 8 milion lekë.

- Në janar 2010 hyn në fuqi kufiri i regjistrimit për TVSH-në i cili u ul përsëri në 5 milion lekë; (vendim nr.1058, datë 21.10.2009).
- Kufiri i regjistrimit për profesionet bëhet 2 milion lekë - VKM nr. 149 datë 03.03.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 33, datë 02.04.2010.
- Duke filluar nga 1 shkurti 2011- kufiri i regjistrimit për profesionet dhe hotelet bëhet zero lekë - ndryshuar me vendimin nr. 18 date 12.01.2011, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, datë 24.01.2011.

TVSH është një ndër tatimet më të rëndësishme në Shqipëri që kontribuon ndjeshëm në të ardhurat tatimore.




Figura 2.4 Ecuria e të ardhurave të grumbulluara nga TVSH

Burimi: Ministria e financave dhe përpunim i autores

Karakteristikat e TVSH-së:

- është një tatim mbi konsumin, pagesit e vërtetë të saj janë konsumatorët final të mallrave dhe shërbimeve;
- është një tatim real dhe i palëvizshëm kjo do të thotë që nuk është në funksion të të ardhurat të realizuara nga tatimpaguesi;
- është një tatim indirekt, jo i drejtpërdrejtë sepse pagimi i këtij tatimi bëhet nga “persona të tatueshëm”;
- është një tatim me pagesë të copëzuar kështu secili aktor i zinxhirit me hallkë nisje prodhuesin e parë dhe në vazhdim grosistin e parë apo të dytë dhe me mbarim shitësin e pakicës, ndërhyr për atë sa vlerë i shton pjesës së tij të aktivitetit, pa u ndikuar nga njëri tjetri;
- është vetëdeklarativ sepse mënyra e deklarimit dhe pagesës së TVSH-së mbështetet në parimin e vetëdeklarimit;
- është një tatim i përgjithshëm mbi mallrat dhe shërbimet;
- siguron një barazi taksimi në nivelin e konsumatorit final domethënë për çmim të barabartë ekziston tatim i barabartë;
- mbështetet në kompensimet në kufi.

Sipas ligjit Nr. 92/2014 datë 24.7.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", në Republikën e Shqipërisë, Neni 1, TVSH-ja është një tatim mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve, në raport me çmimin e tyre, që i ngarkohet në çdo fazë të prodhimit dhe procesit të shpërndarjes çmimit pa tatimin. Shkalla standarde e tatimit mbi vlerën e shtuar për

furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, e cila aplikohet si një përqindje e vlerës së tatueshme, është 20 për qind. Kur një pagesë nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht për shitjen e produkti/shërbimi dhe është shpallur si i pambledhshëm nga organet gjyqësore, lejohet zbritja e TVSH-së, për shumën e paarkëtuar të borxhit të keq. Administrata tatimore kryen procedurën e rimbursimit brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues. Bizneset kanë të drejtën e zbritjes së TVSH-së së karburantit të blerë që është përdorur për nevoja teknologjike në funksion të arritjes së qëllimit primar të biznesit. Vlera e tatueshme e mallrave të importuara identifikohet prej vlerës së përcaktuar në import nga autoriteti doganor, mbi bazën e legjislacionit doganor.

2.5.2 Tatimi mbi të ardhurat

Sipas ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 2.1 Normat e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi

E ardhura e tatueshme (në lekë/muaj)		Përqindje
Nga	Deri në (përfshirë)	
0	30,000	Zero për qind
30,001	130,000	+13 për qind të shumës mbi 30,000 lekë
130,001	Më tepër	13,000 lekë + 23 përqind të shumës mbi 130,000 lekë

Burimi: Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998

Siç shikohet nga grafiku i mëposhtëm, tatimi mbi të ardhurat personale ka ardhur në rritje.




Figura 2.5 Ecuria e të ardhurave të grumbulluara nga TAP

Burimi: Ministria e financave dhe përpunim i autores

Sipas ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, personat juridikë dhe ortakëritë dhe çdo person tjetër, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur ky është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, me përjashtim të rastit kur ky person është subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël i nënshtrohen tatimit mbi fitimin. Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin është 15%.

Tatimpaguesi parapaguan këstet tremujore të tatimit mbi fitimin (por mund të paguhen edhe çdo muaj), brenda datës 30 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 30 dhjetor.




Figura 2.6 Ecuria e të ardhurave të grumbulluara nga TF

Burimi: Ministria e financave dhe përpunim i autores

2.5.2.1 Shpenzimet e pazbritshme për efekte tatimore

Ndër shpenzimet që nuk njihen për efekte tatim fitimi sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat janë:

- a) interesat e paguara, të cilat tejkalojnë normën mesatare të interesit 12 mujor të kredisë për tregun bankar, sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë
- b) shpenzimet për përfaqësim dhe shpenzimet për pritje-përcjellje të cilat tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;
- c) shpenzimet e konsumit personal, të përcaktuara nga Ministri i Financave;
- d) shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit dhe shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit, e cila tejkalon masën 5 për qind të fitimit para tatimit;
- e) shpenzimet për dhurata;
- f) shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit, të faturuara nga persona të tretë, për të cilat nuk është paguar tatimi në burim, brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi.
- g) humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit, tej normave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim normativat për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit dhe transportimit etj, të njohura për qëllime fiskale;
- h) nëse gjatë periudhës tatimore, huaja dhe parapagimi tejkalojnë mesatarisht katër herë shumën e kapitaleve të veta, interesi i paguar për shumën e tejkaluar nuk njihet si shpenzim i zbritshëm me përjashtim për bankat dhe shoqëritë e sigurimeve dhe kompanitë e leasing-ut.
- (i) amortizimi për aktivet e patrupëzuara, llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind; Dy kategoritë e mëposhtme të aktiveve amortizohen me metodën e vlerës së mbetur, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje si më poshtë:
 - a) kompjuter, sisteme informacioni, produkte “software” dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me 25 për qind.
 - b) të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20 për qind.

Sipas ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, në rastin e nxjerrjeve jashtë përdorimit ose shkatërrimit të materialeve apo mallrave të cilat për arsye të ndryshme, si dëmtime, kalim i afatit të skadencës, etj., janë të papërdorshme/pa tregtueshme apo tregtohen më çmime të ulura, përfshirë uljen sezonale, shpenzimet përkatëse ose të ardhurat e reduktuara do të njihen për efekt fiskal vetëm nëse vërtetohen me proces-verbalin përkatës të mbajtur nga një komision të posaçëm vlerësimi, dhe subjekti ka njoftuar organin tatimor përkatës. Ky njoftim duhet të shoqërohet me një kopio të procesverbalit përkatës. Organi tatimor mund të dërgojë përfaqësuesin e vet që të jetë prezent në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit ose shkatërrimit të mallit, jo më vonë se 5 ditë nga data e njoftimit. Për hipermarketet ky afat është 24 orë. Proces-verbali i vlerësimit duhet të përmbajë të dhëna të plota mbi sasinë, vlerat, kohën e furnizimit, arsyet e zhvlerësimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit, duke i garantuar organeve tatimore mundësinë e verifikimit dhe kontrollit. Ligji nuk parashikon rastet e atyre bizneseve që në mënyrë të vazhdueshme nxjerrin jashtë përdorimit aktive biologjike.

2.5.3 Krahasimi i normave me vendet e rajonit dhe ecuria në Shqipëri

Siç vërehet nga tabela e mëposhtme Shqipëria ka nivelin më të lartë taksës (si përqindja ndaj fitimit) pas Serbisë.

Tabela 2.2 Krahasimi nivelit të normave tatimore me vendet e rajonit

Vendi/Lloji pagesës	Shqipëria	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia	Kosova	Bosnja dhe Hercegovina
Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	15%		5.5%	17.9%	5%	10.5%
Tatimi mbi Korporatat	15%	10%	9%	15%	10%	10%
Kontributi Sigurimeve Shëndetësore	1.7%		3.80%			
Taksa e Transferimit të Pronësisë	2%	3%		2.5%		
Taksa e Pasurisë	280 lek	8000 MKD	0.1-1%	0.4%	0.15%-1%	
Taksat e Bashkisë	180,000 lek	0.1%				
Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	2%					
Kontributi i Sigurimeve i Paguar nga Punëmarrësi	11.2%	27%	24%	19.9%	5%	31%
TVSH	20%	18%	19%	20%	16%	17%
Niveli Total i Taksës (% ndaj fitimit)	36.5%	12.9%	21.6%	39.7%	15.2%	23.3%

Burimi: Raporti Doing Business 2016




Figura 2.7 Krahasimi i normave me vendet e rajonit
Burimi: Raporti Doing Business 2016 dhe përpunim i autores

Në Shqipëri, të ardhurat tatimore kanë përgjithësisht një tendencë në rritje. Gjatë viteve 2012 dhe 2013 kanë qënë brenda të njëjtit nivel ndërsa viti 2014 ka pësuar një rritje të konsiderueshme krahasimisht me dy vitet më përpara.




Figura 2.8 Ecuria e të ardhurave tatimore në vite në
Burimi: Ministria e financave dhe përpunim i autores

Peshën më të madhe të të ardhurave e zë tatimi mbi vlerën shtuar, mbi 35% të të gjithë të ardhurave tatimore. Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore zënë rreth 15% të të ardhurave tatimore pastaj vjen akciza, taksa nacionale, tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatim fitimi (INSTAT).




Figura 2.9 Struktura e të ardhurave në Shqipëri
Burimi: Ministria e financave dhe përpunim i autores

Sipas të dhënave të INSTAT numri i tatimpaguesve ka ardhur në rritje gjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014. Për periudhën e shqyrtuar vetëm gjatë vitit 2012 ka pas një rënie të numrit të tatimpaguesve.




Figura 2.10 Numri i tatimpaguesve ndër vite

Burimi: INSTAT dhe përpunim i autores

Përgjithësisht, numrin më të madh të tatimpaguesve e zë Tirana pastaj Durrësi, Fieri, Shkodra dhe Korça (INSTAT).




Figura 2.11 Struktura e tatimpaguesve

Burimi: INSTAT dhe përpunim i autores

Sipas tabelës 2.3, krahasuar me 2015, thuajse të gjithë indikatorët janë në të njëjtat nivele. Norma totale e tatimit (si përqindje ndaj fitimit) është rritur me 5.1% krahasuar me 2015. Numri i pagesave në vit është relativisht i lartë krahasuar me vendet e tjera të rajonit (përveç Bosnjës dhe Hecegovinës) dhe me performuesin më të mirë në glob. Gjithashtu orët në vit që nevojiten janë të larta krahasimisht me vendet (përveç Bosnjës dhe Hecegovinës). Rënditja sipas tregtisë përtej kufijve ka qëndruar në të njëjtat nivele me vitin 2015 dhe lë pas vetëm Malin e Zi. Kostoja për eksport nuk ka ndryshuar në raport me 2015 dhe është një ndër më të lartat. Po ashtu, koha për eksport është më e larta në krahasim me vendet e rajonit. Gjithashtu, kostot dhe koha e importimit janë ndër më të lartat pas Malit të Zi.

Tabela 2.3 Indikator tatimor të rëndësishëm

Indikator	Shqipëria DB2016	Shqipëria DB2015	Bosnia dhe Hercegovina DB2016	Kroacia DB 2016	Greqi DB2016	Hungari DB 2016	Maqedoni, FYR DB2016	Mali i Zi DB2016	Performuesi Më i Mirë në Glob DB2016
Pagesat (numri në vit)	34	34	45	19	8	11	7	17	Hong Kong SAR, China (3)
Koha (orët në vit)	357	357	420	206	193	277	119	314	Luksemburg(55)
Norma Totale e Tatimit (si % e fitimit)	36.5	31.4	23.3	20	49.6	48.4	12.9	21.6	Irlandë (25.9)
Tregëtia Përtej Kufijve (rënditja)	37	37	28	1	27	1	26	42	Danimarka (1)
Tregëtia Përtej Kufijve (pikët DFT)	91.61	91.14	93.59	100	93.72	100	93.87	88.75	Danimarka (100)
Koha për Eksport: Përputhshmëria e Kufijve (orë)	18	24	5	0	24	0	9	8	15 ekonomi (0.00)
Kosto për Eksport: Përputhshmëria e Kufijve (dollar)	181	181	106	0	300	0	103	158	18 ekonomi (0.00)
Koha për Eksport: Përputhshmëria e Dokumentave (orë)	6	6	4	1	1	1	2	5	Jordania (0.00)
Kosto për Eksport: Përputhshmëria e Dokumentave (dollar)	57	57	67	0	30	0	45	67	20 ekonomi (0.00)
Koha e Importimit: Përputhshmëria e Kufijve (orë)	9	9	6	0	1	0	8	23	19 ekonomi (0.00)
Kosto e Importimit: Përputhshmëria e Kufijve (dollar)	101	101	87	0	0	0	150	306	28 ekonomi (0.00)
Koha e Importimit: Përputhshmëria e Dokumentave (orë)	8	8	8	1	1	1	3	10	21 ekonomi (1.00)
Kosto e Importimit: Përputhshmëria e Dokumentave (dollar)	56	56	57	0	0	0	50	100	30 ekonomi (0.00)

Burimi: Raporti Doing Business 2016

2.5.4 Sanksionet ligjore

Tabela e mëposhtme përmbledh sanksionet kryesore lidhur me shkeljet e ndryshme që tatimpaguesit mund të realizojnë. Në fundin e vitit 2015, sanksionet për kundravajtjet ligjore u rriten konsiderueshëm në vlerë por pas ankimimit të bizneseve një pjesë e këtyre dënimeve u shfuqizuan pasi u konsideruan si të papajtueshme me kushtetuten e Republikës së Shqipërisë.

Tabela 2.4 Shkeljet dhe sanksionet kryesore

	Shkeljet	Sanksionet
1	Mosrespektimi i detyrimit për regjistrim apo detyrimit për përditësimin e të dhënave	gjobë 10,000 lekë për organizatat jofitimprurëse dhe për tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe 15,000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin
2	Mosdeklarimi në afat	gjobë 10,000 lekë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar
3	Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit	gjobë 0.06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer
4	Plotësimi i pasakë i deklaratës tatimore	gjobë 0.06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer
5	Mosparaqitja në kohë e njoftimit për Transferim e Çmimit	gjobë 10,000 lekë për çdo muaj vonesë
6	Fshehja apo shmangia nga pagimi detyrimeve tatimore	gjobë 100% të diferencës së shumës së përlogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt
7	Agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agentët e taksave dhe agentët e tarifave	gjobë 50% të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhur apo të shmangur
8	Mosmbajtje e saktë e librave, regjistrave dhe dokumentacionit	10,000 lekë për biznesin e vogël dhe 50,000 lekë kur është klasifikuar si lloj tjetër biznesi
9	Mosdeklarim i punonjësve	gjobë 500,000 lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin gjobë 50,000 lekë për tatimpaguesit e tjerë
10	Pagesat ose arkëtimet me para në dorë mbi 150,000 lekë	gjobë 10 për qind të vlerës së secilit transaksion
11	Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore	dënohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit, që mbahej në ruajtje, përdorëj apo transportohej, i pashoqëruar me dokumente tatimore
12	Mosinstalimi i pajisjes fiskale ose sistemeve të monitorimit të qarkullimit	hera e parë: gjobë në masën 50,000 lekë; e dytë: konfiskim të të gjithë sasisë së mallit përsëritur: kallëzim penal (konsiderohet evazion)
13	Moslëshim i kuponit tatimor për të dokumentuar qarkullimin e mallrave apo të shërbimeve	hera e parë: gjobë në masën 200,000 lekë për TP subjekt TF dhe 50,000 për të tjerë e dytë: gjobë në masën 300,000 lekë për TP subjekt TF dhe 100,000 për të tjerë kallëzim penal (konsiderohet evazion)
14	Lëshimi i një kuponi tatimor/dëftese tatimore/biletë me vlerë të parashtypur, që nuk përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, për kuponin tatimor/dëftesën tatimore/biletën me vlerë të parashtypur	gjobë në masën 30,000 lekë
15	Lëshon kupon tatimor, ku ka shënuar një vlerë të ndryshme nga vlera e çmimit të afishuar	gjobë në masën 30,000 lekë
16	Nuk afishon në një vend të dukshëm një poster, që tregon detyrimin e blerësit të mallrave apo të përfituesit të shërbimit, për të kërkuar kupon tatimor	gjobë në masën 20,000 lekë
17	Nuk mban kontrollin e gjurmës së kuponit tatimor në mjedisin e ofrimit të mallrave apo të shërbimeve	gjobë në masën 30,000 lekë
18	Nuk mban dhe mirëmban në kushte pune pajisjet fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit	gjobë në masën 40,000 lekë
19	Nuk njofton menjëherë për defektin e ndodhur në pajisjen fiskale ose sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defeekteve	gjobë në masën 25,000 lekë
20	Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë të parashtypur, të prodhuara nga institucionet e autorizuar, të përdorura në sektorë të ndryshëm	gjobë 10,000 lekë për çdo biletë
21	Moslëshimi i faturës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH	gjobë 100 për qind të detyrimit tatimor, të padeklaruar ose të papaguar
22	Blerësi ose përfituesi i shërbimit, i cili gjatë kontrollit në distancat e parashikuara në udhëzimin e Ministrisë të Financave, nga vendi i shitjes apo ofrimit të shërbimit, nuk ka kupon tatimor	gjobë 1,000 lekë
23	Refuzimi për dhënie të informacionit të kërkuar nga administrata tatimore	gjobë 10,000 – 50,000 lekë për çdo shkelje
24	Tatimpaguesi, i cili, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pengon ushtrimin e të drejtave të administratës tatimore për kontrollin apo hetimin tatimor	gjobë 100,000 lekë për biznesin e vogël dhe 1,000,000 lekë për bizneset e tjera
25	Tatimpaguesi, që lëshon faturë tatimore të pasaktë e që rezultojn me ulje të detyrimit apo rritje të shumës për t'u rimbursuar	gjobë 50 për qind të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor
26	Tatimpaguesi, që lëshon një faturë tatimore me pasaktësi por që provohet se nuk ka efekt në llogaritjen dhe pagimin e detyrimit tatimor	gjobë 10,000 lekë
27	Tatimpaguesi, i cili nuk është subjekt i detyrimit për lëshimin e faturës me TVSH	gjobë të barabartë me 50 për qind të TVSH-së së dhënë në faturën tatimore të paautorizuar, si dhe me marrjen e 100 për qind të TVSH-së së faturuar padrejtësisht
28	Mosafishimi i çmimeve të shitjes	gjobë 35 000 lekë për tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogël dhe 65 000 lekë për tatimpaguesit e tjerë

Burimi: Ligj Nr.9920 datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

Sipas Crandall (2010) matja e performancës po bëhet gjithnjë e më shumë e rëndësishme në administratën publike dhe treguesit e matjes së performancës duhet të kenë karakteristika sasiore, cilësore dhe të përshtatshëm në kohë. Në funksion të performancës administrata tatimore duhet të: identifikojë matësat e performancës dhe specifikimin e detajeve të lidhura me to; të vendosë një pikë reference në mënyrë që të vlerësohet performanca e ardhshme; analizojë dhe raportojë rezultatet; dhe ndërtojë përgjegjësinë organizacionale për ndërtimin e sistemit të menaxhimit të performancës. Matja e performancës mund të bëhet në tre nivele: strategjik (vlerëson matjen e performancës në terma të misionit dhe strategjisë); operacional (mat efektivitetin në aspekte të veçanta të organizatës) dhe individual (vlerëson punonjësit e organizatës në lidhje me përpjekjet e tyre).

Tabela 2.5 përshkruan matësit kryesor bazuar në funksionet e administratës tatimore (indiktorët e matjes së performancës) të tillë si: përputhshmëria me deklarin dhe rregjistrimin, shërbimet ndaj tatimpaguesve dhe edukimi, plotësimi deklaratave dhe pagesa, mbledhja e borxheve, kontrolli dhe investigimi dhe apelimet. Për secilin nga funksionet jepen matësit e sasisë dhe matësit kohor dhe të cilësisë që i përshtaten funksionit respektiv.

Administrata tatimore duhet të fokusohet jo vetëm në matësa sasiore por duhet të marrë në konsideratë matësa cilësore. Përqëndrimi i vëmendjes vetëm në matësa sasiore i orienton drejtuesit në gjykime të gabuar dhe për rrjedhojë më vendime jo të drejta. Në përzgjedhjen e matësive duhet të merren në konsideratë edhe shkalla e zhvillimit të administratës tatimore.

Tabela 2.5 Indikatorë të matjes së performancës

Indikatorët Ilustrues të Performancës për Administrimin e Tatimeve		
Funksionet e Administrimit të Tatimeve	Matësit e Sasisë	Matësit kohor dhe të cilësisë
Përputhshmëria me deklarin dhe rregjistrimin	Numri i rregjistrimeve të reja Numri i jo-deklaruesve sipas tipeve të tatimeve	Koha mesatare për të realizuar rregjistrimet e reja Koha mesatare për të zgjidhur rastet e mosdeklarimeve Saktësia e rregjitrimeve të tatimpaguesve Vlerësimi i dënimeve për vonesat
Shërbimet ndaj tatimpaguesit dhe edukimi	Numri total i tatimpaguesve që janë ndihmuar telefon ballë për ballë Korrespondencë e shkruar e-mail klikimet në faqën e internetit Numri i vizitave këshilluese Numri i seminareve edukuese	Koha mesatare e pritjes e tatimpaguesit për shërbimin Koha mesatare e përgjigjes ndaj kërkesave të shkruara të tatimpaguesit Saktësia e përgjigjeve të siguruar Dobishmëria e vizitave dhe seminareve (e përcaktuar nga sondazhet)
Plotësimi deklaratare dhe pagesa	Numri i deklaratare të plotësuara, sipas tipit të tatimeve Numri i rimbursimeve të dhëna sipas tipit të tatimeve Përqindja e deklaratare të plotësuara elektronikisht Përqindja e deklaratare të plotësuara me dorë Numri i pagesave të përpunuara (elektronikisht apo manualisht) Vlera totale e pagesa të përpunuara	Koha mesatare e përpunimit Numri mesatar i ditëve për të dhënë një rimbursim Saktësia e përpunimit të deklaratare/norma e gabimit Saktësia e përpunimit të pagesave/norma e gabimit
Mbledhja e borxheve	Vlera totale e borxheve të mbledhura Numri total i rasteve të mbledhura të mbyllura Numri total i tatimpaguesve të kontaktuar Totali i burimeve të dedikuara Mbledhja mesatare vjetore në vit për person	Mosha mesatare e rasteve të mbledhura Përqindja e rasteve të zgjidhura brenda një muaji Cilësia e rasteve të mbledhura
Kontrolli dhe investigimet	Numri i kontrolleve të përfunduar sipas tipeve të tatimeve të thjeshtë krahasues tematik etj Detyrimi shtesë tatimor vlerësuar nga kontrolli, sipas tipeve të tatimeve Burimet totale të dedikuara Detyrimi shtesë tatimor vlerësuar për person Numri i investigimeve të përfunduar	Koha mesatare për të përfunduar një kontroll sipas tipeve të tatimeve Cilësia e kontrollit Koha mesatare për të përfunduar një investigim
Apelimet	Numri total i rasteve të apeluara të mbyllura Burimet totale të dedikuara Vlera e rregullimeve të apelimeve Numri i rasteve të trajtuara nga gjykata	Gjatësia mesatare e rasteve të apeluara Cilësia e rasteve të apeluara Shkalla arritjes së afateve ligjore

Burimi: Crandall, 2010



Figura 2.12 Nivelet e matjes së performancës

Burimi: Crandall, 2010

Në një studim të kryer në Nigeri nga Shagari (2014) në lidhje me përcaktuesit e efijencës së administratës tatimore në Nigeri rezultoi që ka një lidhje sinjifikative mes efijencës së administratës tatimore dhe: pavarësisë së bordit të të ardhurave të brendshme, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe transparencës ndaj publikut. Gjithashtu, nga studimi u theksua që nuk ka lidhje sinjifikative mes efijencës së administratës tatimore dhe praktikave të forta të auditit, motivimit, nxitjeve dhe korrupsionit të perceptuar.

Sipas të dhënave të IOTA-s² dhe Ministrisë së Financave dhe duke u bazuar në raportin shpenzime totale të administratës tatimore si përqindje të të ardhurave të mbledhura vërejmë gjatë viteve 2010 dhe 2011 ka qënë i njëjtë, në vitin 2012 ka rënë po ashtu edhe në vitin 2013 dhe në 2014 është rritur ndjeshëm si pasojë e investimeve të larta në fushën teknologjisë së informacionit. Krahasimisht me vendet e tjera të rajonit ky raport është relativisht i lartë. Po ashtu, kostot e punësimit kanë ardhur në rritje me përjashtim të vitit 2013. Shpenzimet e teknologjisë së informacionit gjatë vitit 2014 janë rritur pas investimeve të bëra për ndryshimin e sistemit.

Tabela 2.6 Tregues të Administratës Tatimore krahasuar me vendet e rajonit për vitet 2009 dhe 2010

	Shqipëria		Bullgaria *		Kroacia		Estonia		Gjeorgjia		Letoni		Litenshtaj		Lituan		Maqedonia FYR		Mal i Zi		Serbi	
	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010	2009	2010
Të ardhurat totale tatimore	1,148	1,115	6,878	6,130	15,458	15,393	4,076	4,046	2,017	2,307	5,600	5,183	513	567	4,754	4,447	1,712	1,453	838	845	10,907	10,675
Tatimet Direkte	447	452	2,021	1,813	3,504	2,931	411	385	674	748	1,318	1,266	337	358	1,804	1,509	221	210	265.8	136.1	1,721	1,631
Tatimet Indirekte	348	314	2,065	1,719	6,361	6,888	1,829	1,915	1,031	1,206	1,879	1,857	171	205	2,549	2,508	812	614	177.2	274.6	4,606	4,593
Sigurimet Shoqërore	353	350	2,585	2,483	5,449	5,318	1,795	1,698			1,893	1,647			93	34	679	629	345.9	385.4	3,900	3,840
Tatime të tjera			207	115	144	256	41	48	312	353	510	414	5	4	308	396			49.1	48.9	680	611
Shpenzimet totale për administratën tatimore	14	14	82	86	126	123	39	40	25	21	78	74	6	8	112	95	31	30	7	7	75	78
Kostot administrative	3	2			53	52	19	20	2	5	0.19	0.2	0.16	0.29	56	47.5	15.5	15	0.5	0.4	15.1	13.8
Kostot e punësimit	10	11	70	74	68	69	15	16	23	16	51.21	48.17	3.85	4.27	43.6	37.8	10.7	10.6	6.4	5.7	56.1	60.1
Shpenzimet për teknologjinë e informacionit	0	0			5	2	0	0			9.9	8.67	0.75	2.48	3.8	3.6	0.7	0.2	0.2	0.2	3.5	3.2
Kostot e tjera	0	0	12	13	0	0	4	0	0	0	18.21	17.24	0.79	0.9	8.6	6.1	4	4.3	0.4	0.4	0.7	0.7
Kosto mesatare e administratës tatimore për punonjës (EUR)*	8,920	8,690	11,234	11,209	28,073	27,789	20,178	20,329	7,017	4,986	17,374	17,786	101,000	138,000	15,234	13,250	12,410	11,304	12,440.2	11,733.3	11,723	12,353
Shpenzimet totale të administratës tatimore si përqindje e të ardhurave të mbledhura (%)**	1.2	1.2	1.2	1.4	0.8	0.8	0.5	0.5	1.2	0.9	1.4	1.4	1.5	1.4	1.2	1.1	0.9	1.0			0.7	0.7
Numri i punonjësve të administratës tatimore	1,537	1,595	7,335	7,708	4,493	4,409	955	974	3,249	3,329	4,461	4,176	47	51	3,676	3,585	1,249	1,327	596	565	6,430	6,301
Numri i tatimpaguesve	74,864	82,912	632,274	648,740	4,901,872	4,469,835	673,156	654,253	398,461	438,283	974,366	1,005,253	100,070	91,480	324,502	328,211	133,754	229,779	27,235	29,493	330,464	330,433
Numri i tatimpaguesve për punonjës	49	52	86	84	1,091	1,014	705	672	123	132	218	241	2,129	1,794	88	92	107	173	46	52	51	52

* Kostoja mesatare=(Kostot Administrative costs + Kostot e Punësimit + Shpenzimet e IT + Kostot e tjera) / Numri i punonjësve

** Është llogaritur bazuar në formulën = (Kostot Administrative + Kostot e Punësimit + Shpenzimet e IT + Kostot) x 100 / Total i të Ardhurave

Burimi: Intra-European Organisation of Tax Administrations (IOTA)

Tabela 2.7 Tregues të Administratës Tatimore në Shqipëri për periudhen 2010-2014

	2010	2011	2012	2013	2014
Numri i Punonjësve të Administratës Tatimore	1,595	1,598	1,596	1586	1586
Numri i Tatimpaguesve	103,038	109,039	106,837	111,083	112,537
Të Ardhurat (në milion lekë)	162,400	166,390	165,340	144,485	163,600
Tatime direkte (në milion lekë)	63,308	66,248	67,928	65,039	76,378
Tatime indirekte (në milion lekë)	50,148	48,734	43,932	24,259	26,346
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në milion lekë)	48,944	51,408	53,480	55,187	60,876
Shpenzimet Totale të Administratës Tatimore (në milion lekë)	1,940.4	1,983.8	2,016	1,430.374	2,595.992
Kostot e Punësimit (në milion lekë)	1,558.2	1,594.6	1,646.4	1,375.6	1,730
Shpenzimet e Teknologjisë së Informacionit (në milion lekë)	30.8	68.6	67.2	54.7744	467.512
Kostot e Tjera (në milion lekë)	351.4	320.6	302.4	0	398.48
Kostoja Mesatare e Administrimit Tatimor për Punonjës*	976,920	997,920	1,031,520	867,339	1,090,794
Shpenzimet Totale të Administratës Tatimore si Përqindje të të Ardhurave të Mbledhura**	0.0119	0.0119	0.0122	0.0099	0.0159
në %	1.19	1.19	1.22	0.99	1.59
*Kostoja Mesatare e AT për Punonjës = Kostot e Punësimit/Numri i Punonjësve					
** Shpenzimet Totale të AT si një përqindje e Të Ardhurave të Mbledhura= Shpenzimet Totale të Administratës Tatimore/Të ardhurat totale					

Burimi: Intra-European Organisation of Tax Administrations (IOTA), Ministra e Financave dhe përpunim i autores

2.6 KONTROLLI TATIMOR

2.6.1 Karakteristikat e kontrollit tatimor në Shqipëri

Sipas manualit të kontrollit tatimor (2011) synimi kryesor i administratës tatimore është rritja e nivelit të përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore, nepërmjet edukimit, ndërgjegjësimit dhe një shërbimi sa më eficient ndaj tatimpaguesve. Pra objektivi është që tatimpaguesit të ndihmohen për plotësimin e detyrimeve tatimore, por për të garantuar një gjë të tillë nevojiten edhe kontrollet tatimore. Arsyeja kryesore e kontrollit tatimor nuk është zbulimi dhe realizimi i të ardhurave, por zbulimi i problemeve, rregullimi i tyre për të ardhmen, edukimi i tatimpaguesve, dhe sidomos parandalimi i shmangieve tatimore dhe evazionit tatimor.

Objektivi primar i kontrollit është konsolidimi i nivelit aktual të të ardhurave të realizuara nga organet tatimore, duke bërë identifikimin e gabimeve në vlerësim dhe vjeljen e të ardhurave tatimore që janë pasojë e deklaratimit me të vogël, të stimulojë përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore, të parandalojë dhe të sigurojë dekurajimin e evazionit dhe të shmangies tatimore. Qëllimi i përgjithshëm i kontrollit tatimor është të ushtrojë kontroll te tatimpaguesi dhe të sigurojë që, duke identifikuar dhe pastaj shqyrtuar fushat e riskut, tatimpaguesi të nxjerrë në mënyrë të saktë detyrimin e tij tatimor.

Sipas manualit të kontrollit (2011) kontrollet tatimore janë:

- Kontrolle të plotë – këto janë kontrolle të plota që ndërmerren për të kontrolluar të gjitha aspektet e biznesit të tatimpaguesit për të gjitha periudhat kohore që nga kontrolli i plotë i fundit. Ky kontroll zbatohet sipas udhëzimeve të shpallura nga Sektori i Analizës së Riskut. Për shkak të kohës që kërkon ky tip kontrolli në

kryerjen e tij në deget e mëdha nuk është i shpeshtë. Megjithatë, këto krontrolle duhet të kryhen të paktën një herë në 3 vjet. Jo më shumë se 30 % e të gjitha kontrolleve të kryera mund të jenë kontrolle të plota.

- Vizita fiskale – këto janë kontrolle të shkurtra të kryera gjatë një periudhe të shkurtër kohore për të verifikuar saktësinë e deklaratave dhe pagesave, ato kryhen vetëm për një periudhe të përcaktuar tatimore dhe vetëm për një lloj tatimi. Në rastet kur nga këto vizita fiskale konstatohen probleme serioze për fshehje tatimi, kontrollori propozon kryerjen e një kontrolli të plotë në vend sipas procedurave të analizës së riskut.
 - Vetëm për një periudhe të përzgjedhur tatimore
 - Vetëm për një lloj tatimi të zgjedhur
- Verifikime në vend – është objekti i kontrollit dhe verifikimit të Sektorit të Verifikimit në Terren.

Kontrollit tatimor ka si objektivi të vlerësojë riskun e paraqitjes së detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesit më të vogla dhe të hartojë mekanizma për të vlerësuar atë risk. Para fillimit të kontrollit, kontrollori duhet të analizojë me vemendje deklaraten e fundit tatimore të tatimpaguesit duke kërkuar në të ndonjë çështje të paqartë, apo dyshuese. Kontrolluesi duhet të marrë në konsideratë rezultatet e kontrolleve të mëparshme dhe nëse gjenden pika të dobëta në kontrollin e mëparshëm duhet t'i komunikohet drejtuesve për të ndjekur procedurat ligjore të mëtejshme. Në planifikimin e kontrollit dhe gjatë realizimit të tij, kontrollori duhet të ketë parasysh disa objektiva për të cilat duhet të sigurohet gjatë ushtrimit të kontrolleve. Këto objektiva janë:

- Plotësimi – të gjithë bilancet dhe transaksionet që duhen përfshirë në deklaraten finaciare janë përfshirë në të.
- Momenti i regjistrimit - transaksionet regjistrohen në momentin e duhur.
- Vlerësimi – transaksionet janë llogaritur në përputhje me ligjet.
- Të drejtat dhe detyrat - aktivet e regjistruara i përkasin subjektit dhe pasivet e regjistruara janë detyrime të tij.
- Pasqyrimi i transaksioneve – teprica e llogarive është pasqyruar drejt.
- Saktësia - transaksionet e regjistruara dhe tepricat duhet të jenë matematikisht të sakta.
- Ekzistenca - aktivet dhe pasivet e regjistruara ekzistojnë realisht; transaksionet nuk janë të rreme.

Konsiderimi i çështjeve të mësipërme sëbashku me respektimin e procedurave ligjore të kontrollit tatimor dhe duke u fokusuar tek qëllimi i kontrollit arrihet të vlerësohet risku i fshehjes së detyrimeve tatimore.

2.6.2 Baza ligjore e kontrollit tatimor

Gjatë ushtrimit të kontrollit tatimor inspektori tatimor ka të drejtë për të kontrolluar dokumentacionin e biznesit dhe për të verifikuar në terren situatën. E gjithë procedura mbështet nga një bazë ligjore që i lejon inspektorët të realizojnë detyrën e tyre.

Tabela 2.8 Baza ligjore ku mbështetet kontrolli tatimor

Detyrimi i tatimpaguesit për të mbajtur regjistrime dhe për të dhënë informacion	
Për tatimin mbi të ardhurat që mbahet në pagë	Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat, Neni 10 (2) Udhëzimi për Tatimin mbi të Ardhurat, Pika 2.5 Ligji për Procedurat Tatimore, Neni 7 Ligji për Procedurat Tatimore, Neni 46 - 54 Udhëzimi i Ligjit për Procedurat Tatimore, Pikat 46-54
Për agjentët tatimorë	Ligji për Procedurat Tatimore, Neni 60
Për të gjithë subjektet	Ligji për Procedurat Tatimore, Neni 61
Për bankat	Ligji për TVSH, Neni 40, 46
Për TVSH	
Detyrimi për të bërë deklaratën	
Për individët	Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat, Neni 13 dhe Udhëzimi pika. 2.8
Për subjektet	Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat, Neni 29 dhe Udhëzimi pika. 3.12 Udhëzimi për Tatimin mbi të Ardhurat, pika. 2.6
Për tatimin mbi pasurinë	Udhëzimi për Tatimin mbi të Ardhurat, pika 2.7 Ligji i Procedurave Tatimore dhe Udhëzimi pika 64
Për lojrat e fatit	Ligji i TVSH Neni 37 dhe 39 dhe Udhëzimi pika 9
Për të gjithë subjektet	
Për TVSH	

E drejta e hyrjes në ambjentet e tatimpaguesit	
Për të gjithë subjektet	Ligji i Procedurave Tatimore, Neni 60
Për të gjithë subjektet	Udhëzimi i Procedurave Tatimore, Pika 60
Për Tatimin mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël (TAP BV)	Ligji për të Ardhurave Tatimore, Neni 37
Për TVSH	Ligji për TVSH, Neni 47
Për Biznesin e Vogël	Ligji për Sistemin e Taksave Lokale
E drejta për të kërkuar regjistrime, marrjen e kopjeve të regjistrimeve	
Për të gjithë subjektet	Ligji për Procedurave Tatimore, Neni 46/1 dhe Neni 63
E drejta e përgjithshme për të ushtruar kontroll	
Për të gjithë subjektet	Ligji i Procedurave Tatimore, Neni 80, 63 dhe Udhëzimi për Procedurat Tatimore pika 80. 5
E drejta për të bërë vlerësime	
Për të gjithë bizneset	Ligji i Procedurave Tatimore, Neni 68, 33 dhe Neni 36 Udhëzimi për Procedurat Tatimore, pika 2.2 pika 68

Burimi: Manuali i kontrollit tatimor, 2011

2.6.3 Detyrimet dhe të drejtat e tatimpaguesve

Ligji nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24 datë 2.9.2008, rregullojnë të drejtat e tatimpaguesit, të cilat duhet të respektohen nga administrata tatimore.

Inspektorët e kontrollit, gjatë ushtrimit të kontrollit, duhet të evidentojnë mirë të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesve, t’i respektojnë këto të drejta. E drejta për tu informuar, për tu asistuar dhe dëgjuar, e drejta e konfidencialitetit, e aksesit ndaj informacionit, e drejta për trajtim të barabartë, e drejta për apelim, etj, janë të drejtat themelore të tatimpaguesve në shoqëri. Të drejtat dhe procedurat e organeve tatimore për të kontrolluar, investiguar, vlerësuar, mbledhur me forcë, etj, detyrimet tatimore, duhet të shprehen qartë në manualët përkatëse tatimore në mënyrë që të mos keqinterpretohen nga inspektorët tatimorë.

E drejta për t’u informuar, asistuar dhe dëgjuar

Çdo tatimpagues ka të drejtë që pa shpërblim, me qëllim kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor, të marrë informacion dhe të asistohet nga administrata tatimore.

Tatimpaguesit kanë të drejtë të kenë informacion të vazhdueshëm mbi sistemet tatimore, mënyrën si funksionojnë ato dhe mënyrat se si llogariten detyrimet tatimore të tyre. Informacioni që i jepet tatimpaguesve duhet të jetë i tillë që ata të kuptojnë në kompleks

situatën e tyre tatimore. Tatimpaguesit duhet të informohen në çdo kohë gjatë kontrollit për gjetjet e kontrollit. Tatimpaguesit gjithashtu kanë të drejtën e një asistencë të arsyeshme nga autoritetet tatimore që ato të mund t'i përfitojnë të gjitha lehtësitë që i jep ligji. Çdo tatimpagues ka të drejtën e trajtimit të paanshëm, profesional dhe etik nga strukturat e administratës tatimore, për çështje, që kanë të bëjnë me kuptimin e legjislacionit tatimor, të dokumentacionit tatimor, mënyrës së marrjes së deklaratave tatimore, mënyrës së plotësimit të deklaratave tatimore si dhe për çdo problem tjetër që lidhet me detyrimet tatimore dhe procedurat për respektimin e kërkesave të legjislacionit tatimor. Tatimpaguesit duhet të trajtohen në mënyrë të sjellshme, efikase, me korrektësi dhe të ekzistojë mundësia e bashkëpunimit midis tatimpaguesit dhe administratës tatimore.

Tatimpaguesi, përpara marrjes së një vendimi administrativ për të dhe pasurinë e tij, ka të drejtën të dëgjohet nga administrata tatimore.

E drejta për konfidencialitetin e të dhënave

Punonjësit e administratës tatimore nuk kanë të drejtë të përdorin apo t'i japin palëve të treta informacionin e dhënë nga tatimpaguesit përveç rasteve kur ushtrimi i funksioneve zyrtare (ligji) e kërkon një gjë të tillë.

Çdo tatimpagues ka të drejtën e konfidencialitetit për të dhënat e veta të menaxhuara nga administrata tatimore. Informacioni që zotëron administrata tatimore për tatimpaguesit duhet të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në legjislacionin tatimor. E dhënë tatimore dhe financiare është çdo informacion, i cili jepet nga tatimpaguesi ose merret nga administrata tatimore, gjatë ushtrimit të funksioneve të deklarimit, përpunimit, mbledhjes, kontrollit, investigimit, etj. të detyrimeve tatimore tek tatimpaguesi ose palët e treta.

Tatimpaguesit kanë të drejtë të presin nga organet tatimore që këto të fundit të mos e cënojnë “privatësinë” e tyre, pa arsye të domosdoshme. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve aplikon masa disiplinore ndaj zyrtarëve tatimorë që keqpërdorin informacionin konfidencial tatimor. Tatimpaguesit duhet të kenë bindjen se informacionet e dhëna autoriteteve tatimore nuk duhet të keqpërdoren. Tatimpaguesit gjithashtu duhet të jenë të bindur se informacionet e tyre nuk i jepen konkurrentëve të tyre dhe se inspektorët tatimorë nuk i përdorin informacionet tatimore veçse për qëllimet e parashikuara nga ligji.

E drejta për kontrolle të arsyeshme

Tatimpaguesi ka të drejtë t'i bëhen kontrolle të arsyeshme, të cilat të kryhen në kohë të përshtatshme, në vendin e duhur dhe brenda standarteve të duhura.

Tatimpaguesve duhet ti jepet informacion para kryerjes së kontrollit dhe gjatë kryerjes së kontrollit, duke u ju sqaruar gabimet dhe rrugët për ndreqjen e tyre në të ardhmen.

E drejta për përfaqësim

Tatimpaguesi ka të drejtë të emërojë një përfaqësues, me prokurë, i cili përfaqëson atë në marrëdhëniet me administratën tatimore. Tatimpaguesi mund të marrë konsulentë apo ekspertë të pavarur të fushës gjatë kohës që është nën një proces kontrolli tatimor në mënyrë që të mbrojë veten nga transaksionet e realizuara.

E drejta për të kërkuar evidenca me shkrim apo në rrugë elektronike

Tatimpaguesi ka të drejtë të kërkojë nga administrata tatimore kopje për çdo dokument që ndodhet në dosjen e hapur për të, apo të kërkojë kopje të printuara të të dhënave elektronike,

të lidhura me të. Gjatë ushtrimit të një kontrolli tatimpaguesi ka të drejtë t'i bëhen të ditur apo të kërkojë kopio të formularëve të plotësuar nga kontrollori, proces-verbaleve apo dokumentave të tjera që kanë lidhje me kontrollin.

E drejta për t'u ankimuar

Tatimpaguesi ka të drejtën e apelimit dhe të sigurimit për një shqyrtim të pavarur objektiv administrativ të çështjeve, të lidhura me të. Raportet e kontrollit dhe njoftimet e vlerësimit të detyrimeve duhet ta shprehin qartë këtë mundësi si dhe afatet dhe procedurat që mund të ndjekin tatimpaguesi.

E drejta e sigurisë

Tatimpaguesit kanë të drejtën e një niveli sigurie për pasojat tatimore të veprimeve të tyre por gjithnjë siguria nuk është gjithmonë e realizueshme. Tatimpaguesit nuk është e mundur ta dinë gjithmonë përpara efektin e rregullave që janë në funksion të fakteve dhe rrethanave të një rasti specifik. Gjithashtu autoritetet tatimore mund të mos jenë të detyruara ti garantojnë siguri tatimpaguesit lidhur me zbatimin e dispozitave kundra abuzimeve që synojnë të devijojnë synimin e vërtetë të ligjit. Administrata tatimore duhet të ketë si synim që tatimpaguesit të jenë të aftë të parashikojnë pasojat tatimore të veprimtarisë së tyre të zakonshme personale dhe të biznesit. Gjithashtu, legjislacioni dhe ndryshimet në interpretimin administrativ të ligjeve tatimore nuk duhet të kenë efekt prapaveprues. Tatimpaguesit duhet të kenë mundësi të marrin njohuri mbi pasojat tatimore të një veprimi përpara se ta ndërmarrin atë.

2.6.4 Detyrimet e të drejtat e inspektorëve tatimor

Inspektorët kanë të drejtën e hyrjes në ambientet e bizneset dhe vazhdimin e kontrollit duke u bazuar në ligjet tatimore që janë në fuqi.

2.6.5 Procedurat teknike të detajuara për kryerjen e një kontrolli tatimor

Planifikimi i punës së inspektorit të kontrollit kalon në disa hapa dhe në këtë mënyrë realizohet dosja e tatimpaguesit. Hapat përfshijnë:

Hapi 1. Analizimi i subjektit, duke grumbulluar informacion në mënyrë që të njihet më mirë biznesi.

Hapi 2. Studimi paraprak analitik, duke vlerësuar dhe analizuar veprimtarinë e subjektit.

Hapi 3. Llogaritja e riskut për mosdeklarimin e saktë të deklaratave tatimore të subjektit.

Hapi 4. Analizimi i efektivitetit të kontrolleve të brendshme për të planifikuar strategjinë për kontroll sidomos për subjekte që kanë kontroll të brendshëm.

Hapi 5. Hartimi i strategjisë së kontrollit duke marrë në konsideratë informacionin e grumbulluar për biznesin dhe vlerësimet rreth riskut dhe efektivitetit të kontrollit të brendshëm.

Hapi 1 – analizimi i subjektit

Kuptimi i natyrës së biznesit ka si qëllim të identifikojë riskun e fshehjes së detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit. Inspektori shqyrton mbajtjen e kontabilitetit dhe bën

llogaritjet duke përdorur gjithë dokumentacionin e grumbulluar të subjektit. Në ndihmë të inspektorit vjen dhe vizita që realizon në terren tek tatimpaguesi. Inspektori identifikon një listë me pyetje që e ndihmojnë atë në kuptimin e veprimtarisë së biznesit dhe regjistrimeve kontabël por duke iu referuar edhe konkluzioneve të raport kontrolleve të mëparshëm. Disa elementë fillestar janë shumë të rëndësishëm për fillimin e suksesshëm të një kontrolli tatimor.

a) Njohja e biznesit

Pyetjet bazë që duan përgjigje janë:

- Cilët janë produktet apo shërbimet që tregon subjekti?
- Cilët janë furnitorët dhe çfarë ka blerë subjekti?
- Cilët janë degët e subjektit? Cilët janë përgjegjësitë e drejtuesve të degëve?
- Si realizohet procesi i prodhimit?
- A është një biznes sezonal?
- A tregtohen mallra me para në dorë?
- Cilat janë termat e tregtimit, për shitjet dhe blerjet?
- Cilët janë llojet e inventarëve dhe sa është vlera e tyre?
- Si realizohet shitja e mallrave tek klientët?
- A identifikohen klientët e ardhshëm?
- Cilët janë dokumentat që kërkohen nga drejtuesit: p.sh. libër (ditar) i takimeve, fatura për shpenzime dietash, ditari i punës, fletë hyrje dhe fletë dalje të mallrave, etj.?
- Cila është struktura organizative e subjektit?
- Cila është frekuenca e pagesave në kesh?

b) Njohja e sistemit kontabël

Për shqyrimin e hollësishëm të llogarive, inspektori evidenton se librat, faturat dhe të dhënat që mbahen nga subjekti. Në këtë mënyrë mund të gjykohet në lidhje me nivelin e riskut. Kur subjekti është i madh mund mbahen më shumë libra dhe të dhëna. Inspektori kontrollon të gjitha dokumentacionin e shitjeve që konsiton në kuponat e kasës dhe këto nuk janë të shumtë në numër. Gjithashtu, kontrollohen në mënyrë të detajuar edhe shpenzimet pasi ato mund mbivlerësohen pasi reduktojnë masen e detyrimeve tatimore. Subjekte e mëdha kanë transaksione të shumta të cilat kërkojnë verifikime të kujdesshme në lidhje me rregjistrimet e dyfishta në kontabilitet apo me saktësinë e tyre. Verifikimi kërkon kontrollin e regjistrave të tillë si:

- ditari i blerjeve
- ditari i shitjeve
- ditari i shpenzimeve
- borderotë

Këto dokumentacione përdoren për të regjistruar veprimet ditore të subjektit dhe nuk janë pjesë e sistemit të kontabilitetit të dyfishtë.

Librat e kontabilitetit të dyfishtë përfshijnë:

- Libri i gjendjes së arkës (edhe llogarinë bankare)
- Libri i shitjeve për llogaritë personale të klienteve
- Libri i blerjeve për llogaritë personale të furnizuesve

- Libri i madh për gjithë llogaritë - shpenzime, aktive, hua, etj.

Inspektori kontrollon saktësinë e regjistrimeve por edhe të llogarive që preken nga transaksionet.

Pas analizës së mësipërme të biznesit, inspektori ka krijuar ide për faktorët e jashtëm dhe faktorët e brendshëm që ndikojnë mbi biznesin, dhe burimet e informacionit që mund të përdorë për të përcaktuar pozicionin tatimor faktik të biznesit.

c) Konsiderata të ecurisë së biznesit

Pjesë e rëndësishme e analizës është pozicioni financiar i subjektit. Nëse subjekti ka shenja falimentimi, kontrollori duhet të kujdeset për të evidentuar çdo detyrim tatimor, dhe duke marrë masa për t'ia kërkuar kompanisë.

Hapi 2 - Studimi paraprak analitik

Inspektori shqyrton llogaritë financiare dhe sigurohet që nuk ka gabime ose probleme nëpërmjet një analize të thelluar. Studiohen lidhjet midis llogarive të ndryshme dhe shqytohen më pas diferencat e rezultuara nga analiza. Konkretisht analizohen:

- llogaritë e shitjeve dhe kostove të produkteve ose shërbimeve,
- zëra të indikatorëve financiare dhe jo-financiare,
- diferencat e subjektit me mesataren e industrisë ku operon për periudhën aktuale dhe për periudhat e tjera të kaluara.

Të gjithë llogaritë vjetore të vendosura në dispozicion për analizë krahasohen me deklaratat tatimore.

Hapi 3 - Llogaritja e riskut

Inspektori pas marrjes së njohurive nga subjekti ka identifikuar fushat që kërkojnë më shumë kujdes. E gjithë vëmendja përqendrohet tek fushat që kanë potencial për të shkaktuar humbje.

Hapi 4 - Analizimi i efektivitetit të kontrolleve të brendshme

Disa subjekte të mëdha kanë në strukturat e tyre organizative kontrolle të brendshme. Sa më i fortë të jetë kontrolli i brendshëm aq më i ultë është risku i subjektit. Sinjali i një kontrolli të brendshëm të dobët është arsye e mjaftueshme që kronrolli të jetë më i detajuar. Megjithatë edhe nëse kontrolli i brendshëm është i fortë, organet drejtuese të subjektit mund të krijojnë presion tek punonjësit për të gjetur mënyrat që çojnë në uljen e detyrimeve tatimor.

Hapi 5 - Hartimi i strategjisë së kontrollit

Pas identifikimit të riskut të subjektit përcaktohet strategjia e zhvillimit të mëtejshëm të kontrollit tatimor. Sa më i madh të jetë biznesi aq më i gjatë dhe i detajuar është planifikimi. Sipas një ankete të realizuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve³ (2015), gjatë periudhës gusht-shtator 2015 në 110 biznese, u evidentua si shqetësim numri i lartë i kontrolleve të ushtruara gjatë viteve 2013-2015. Nga të dhënat e grumbulluara ka rezultuar

³ Mandati i Këshillit të Investimeve (KI) është i përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Investimeve nr. 294, datë 08.04.2015. Qëllimi kryesor i KI është të lehtësojë dialogun midis përfaqësuesve të komunitetit të biznesit, organizatave ndërkombëtare, donatorëve dhe qeverisë për zhvillimin e një klime të favorshme, jo-diskriminuese dhe transparente për biznesin dhe investimet në Shqipëri.

se nuk ka patur ndonjë korrelacion sinjifikativ midis numrit të kontrolleve të realizuara nga administrata tatimore dhe rritjes së të ardhurave të grumbulluara, konkretisht koeficienti i korrelacionit 0.3 për tatimpaguesit e mëdhenj dhe -0.06 për tatimpaguesit e tjerë.

Sipas një studimi të kryer nga Forumi Kombëtar i Biznesit në periudhën Maj-Qershor 2014⁴ (2014), ka rezultuar që nuk ka një sjellje profesionale të inspektorëve tatimorë kundrejt bizneseve që janë duke u kontrolluar dhe ka një ndryshim mes trajtimit që i bëjnë inspektorët tatimor gjatë punës së tyre biznesit të vogël dhe atij të madh.

Duke u bazuar tek të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është mundur të sigurohet informacion për tre vite, por nga kontaktet me përfaqësues të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor është konstatuar se zbulimet nga kontrolli tatimor (detyrime dhe gjoba) nuk kalojnë 10% të totalit të të ardhurave të DPT-së. Detyrimet tatimore të zbuluara nga kontrolli tatimor janë afërsisht 5% e totalit të të ardhurave.

Tabela 2.9 Peshë e zbulimeve tatimore nga kontrolli ndaj të ardhurave të DPT-së

Zbulimi/Gjoba	Zbulimet nga Kontrolli Tatimor		
	2008	2009	2010
Shuma e tatimeve të zbuluar	2.9%	3.7%	6.0%
Gjoba	2.7%	2.1%	2.6%
Vlerësimet gjithsej	5.6%	5.8%	8.6%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

2.7 EVAZIONI FISKAL

Fjala taksë (nga latinishtja *taxo* që përkthehet “çmim”, “normë”, “tarifë”) është një detyrim financiar për tatimpaguesin që vendoset nga qeveria për të financuar shpenzimet e ndryshme publike.

Ndërkohë që evazion (nga latinishtja *evasionem* që përkthehet “veprimi i shpëtimit ose shmangies nga presioni i një argumenti, akuze, detyrimi ose pyetje) është shmangia joligjore e pagimit të tatimeve duke realizuar një deklaram të rremë të të ardhurave.

Ekonomia informale është një fenomen me shumë rëndësi në ekonominë e një vendi. Studimet e hershme tregojnë që madhësia e ekonomisë informale në SHBA u rrit gjatë viteve 1965-1989 (Tanzi, 1999; Mofsky, 1982); në fund të kësaj periudhe, të ardhurat e llogaritura të parregjistruara janë mes 20 dhe 30 përqind të të ardhurave të rregjistruara (Feige, 1989). Nga 1989-1994, e ardhura e paraportuar si një përqindje e Të Ardhurës Bruto të Rregulluar (ABR) luhet në mënyrë të konsiderueshme. Në varësi të metodës së përdorur, llogaritjet e hendekut AGI⁵ për 1994 janë mes vlerave 12-27 përqind (Feige, 1994; 1996; Ledbetter, 2004a, b, 2007). Në Mbretërinë e Bashkuar, llogaritjet e të ardhurave të parregjistruara janë në vlerat 2.5-15 përqind të GDP-së, me një tendencë rritëse në vitet 1970 dhe zbutje në vitet e vonshme të 1970 (O'Higgins, 1980). Në Gjermaninë Përendimore, të ardhurat e parregjistruara ishin llogaritur rreth 27 përqind e GNP-së në 1980, me parashikime të një tendence në rritje nga 1956-1970 dhe 1975-1980

4 Një rrjet jo-formal i Dhomave të Tregtisë dhe shoqatave të Biznesit në Shqipëri, i themeluar në kuadër të programit "Shqipëria: Ndërtimi i një dialogu efektiv Publik-Privat".

5 Zyra e Analizës Ekonomike (BEA) çdo vit publikon një krahasim mes matjes së të ardhurave personale nga ana e saj dhe matjes nga Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme i të ardhurave bruto të rregulluara.

(Langfeldt, 1989). Në Francë, e ardhura e paraportuar ishte llogaritur të jetë së paku 6.7 përqind e GPS-së në 1979 (Barthelemy, 1989).

2.7.1 Karakteristikat e ekonomisë informale

Edgar L. Feige (1989, 1994), Schneider (1994), Frey and Werner Pommerehne (1984), and Herald Lubell (1991) e përkufizojnë ekonominë informale si: i gjithë aktiviteti ekonomik që kontribuon në produktin e brendshëm bruto kombëtar të llogaritur zyrtarisht por faktikisht është i paregjistruar. Philip Smith (1994) e përkufizon ekonominë informale si: prodhimi i mallrave dhe shërbimeve i bazuar në treg, ligjërish ose jo që i shpëton llogaritjes zyrtare të GDP-së. Ekonomia informale ka ndikime të rëndësishme për financat publike, rritjen dhe realizimin e politikave (Çule & Fulton, 2007). Ekzistojnë një sërë faktorësh që nxisin firmat drejt ekonomisë informale: barra tatimore direkte ose indirekte; kompleksiteti dhe intensiteti i rregullimeve; korrupsioni burokratik; cilësia e shërbimeve publike dhe besimi tek qeveria (Tanzi, 1982, 1983; Feige, 1996; Schneider and Enste, 2000; Schneider, 2002, 2007).

Regresioni i shumëfishtë i të dhënave nga 18 shtete me ekonomi në tranzicion zbuloi se pabarazia në të ardhura është e korreluar konsiderueshëm me madhësinë e ekonomisë informale (Rosser & Ahmed, 2003). Ekonomia informale mund të jetë në shumë forma – p.sh aktivitetet jo ligjor, të ardhura të paraportuara (evazion fiskal) dhe sektori informal (Feige, 1990, 1996). Evazoni fiskal karakterizohet si një sjellje e qëllimshme jo ligjore ose si një sjellje që përfshin një dhunim direkt të ligjeve tatimore për t'iu shmangur pagesës së tatimeve. Nën-raportimi i qëllimshëm i të ardhurave dhe mbi-deklarimi i zbritjeve tatimore janë shembuj të evazionit tatimor (International Bureau of Fiscal Documentation (IBFD). 2001, 134). Riahi-Belkaoui (2004) shqyrtoi ndryshimet ndërkombëtare në sjelljen ligjore dhe i lidhi këto me përcaktuesit kryesor të përzgjedhur të moralit tatimor. Hipotezat që u hodhën për shqyrtim ishin:

H₁: Ligjet efektive të korrupsionit rezultojnë në sjellje tatimore në përputhje me ligjin;

H₂: Liria e lartë ekonomike rezulton në sjellje tatimore në përputhje me ligjin;

H₃: Roli i rëndësishëm i tregut të kapitalit rezulton në sjellje tatimore në përputhje me ligjin; dhe

H₄: Norma e lartë e krimit rezulton në sjellje tatimore në përputhje me ligjin.

U morën në shqyrtim 30 shtete për të vërtetuar ose hedhur poshtë hipotezat.

Tabela 2.10 Përputhshmëria me ligjet fiskale

Nr	Lista e Shteteve	Përputhshmëria me Ligjet Fiskale
1	Singapore	5.05
2	Zelanda Re	5
3	Australia	4.58
4	Mbretëria e Bashkuar	4.67
5	Hong Kong	4.56
6	Zvicër	4.49
7	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	4.47
8	Malajzi	4.34
9	Kili	4.2
10	Japoni	4.41
11	Norvegji	3.96
12	Francë	3.86
13	Kanada	3.77
14	Danimark	3.7
15	Austri	3.6
16	Finlandë	3.53
17	Gjermani	3.41
18	Tailandë	3.41
19	Filipine	1.83
20	Hollandë	3.4
21	Spanjë	3.29
22	Taivan	3.25
23	Indonezi	2.53
24	Meksikë	2.46
25	Argjentinë	2.41
26	Poloni	2.19
27	Portugali	2.18
28	Turqi	2.07
29	Suedi	1.91
30	Itali	1.77

Burimi: Riahi-Nelkaoui, 2004

Përputhshmëria me ligjet fiskale është matur nga një vlerësim i përputhshmërisë me ligjet fiskale bazuar në një shkallë nga 0 deri te 6 ku pikët e lartë tregojnë përputhshmëri të lartë. Rezultatet tregojnë që sjellja në përputhje me ligjet fiskale është e lartë në shtetet që karakterizohen nga liria e lartë ekonomike, rëndësia e tregut të kapitalit, ligjet konkurruese efektive dhe e ultë në shtetet me normë të lartë krimesh.

Njëkohësisht ecuria e ekonomisë informale në disa vende, si përqindje ndaj GDP-së, paraqitet nëpërmjet tabelave të mëposhtme sipas studimit të Schneider (2015).

Tabela 2.11 Madhësia e ekonomisë informale në 28 vendet e Bashkimit European gjatë viteve 2003 – 2015 (si % ndaj GDP-së)

Vendi/Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Austria	10.8	11.0	10.3	9.7	9.4	8.1	8.5	8.2	7.9	7.6	7.5	7.8	8.2
Belgjika	21.4	20.7	20.1	19.2	18.3	17.5	17.8	17.4	17.1	16.8	16.4	16.1	16.2
Bullgaria	35.9	35.3	34.4	34.0	32.7	32.1	32.5	32.6	32.3	31.9	31.2	31.0	30.6
Kroacia	32.3	32.3	31.5	31.2	30.4	29.6	30.1	29.8	29.5	29.0	28.4	28.0	27.7
Çekia	19.5	19.1	18.5	18.1	17.0	16.6	16.9	16.7	16.4	16.0	15.5	15.3	15.1
Danimarka	17.4	17.1	16.5	15.4	14.8	13.9	14.3	14.0	13.8	13.4	13.0	12.8	12.0
Estonia	30.7	30.8	30.2	29.6	29.5	29.0	29.6	29.3	28.6	28.2	27.6	27.1	26.2
Finlanda	17.6	17.2	16.6	15.3	14.5	13.8	14.2	14.0	13.7	13.3	13.0	12.9	12.4
Franca	14.7	14.3	13.8	12.4	11.8	11.1	11.6	11.3	11.0	10.8	9.9	10.8	12.3
Gjermania	17.1	16.1	15.4	15.0	14.7	14.2	14.6	13.9	13.2	12.9	12.4	12.2	12.2
Greqia	28.2	28.1	27.6	26.2	25.1	24.3	25.0	24.5	24.3	24.0	23.6	23.3	22.4
Hungaria	25.0	24.7	24.5	24.4	23.7	23.0	23.5	23.3	22.8	22.5	22.1	21.6	21.9
Irlanda	15.4	15.2	14.8	13.4	12.7	12.2	13.1	13.0	12.8	12.7	12.2	11.8	11.3
Italia	26.1	25.2	24.4	23.2	22.3	21.4	22.0	21.8	21.2	21.6	21.1	20.8	20.6
Letonia	30.4	30.0	29.5	29.0	27.5	26.5	27.1	27.3	26.5	26.1	25.5	24.7	23.6
Lituania	32.0	31.7	31.1	30.6	29.7	29.1	29.6	29.7	29.0	28.5	28.0	27.1	25.8
Luksenburg	9.8	9.8	9.9	10.0	9.4	8.5	8.8	8.4	8.2	8.2	8.0	8.1	8.3
Malta	26.7	26.7	26.9	27.2	26.4	25.8	25.9	26.0	25.8	25.3	24.3	24.0	24.3
Hollanda	12.7	12.5	12.0	10.9	10.1	9.6	10.2	10.0	9.8	9.5	9.1	9.2	9.0
Polonia	27.7	27.4	27.1	26.8	26.0	25.3	25.9	25.4	25.0	24.4	23.8	23.5	23.3
Portugalia	22.2	21.7	21.2	20.1	19.2	18.7	19.5	19.2	19.4	19.4	19.0	18.7	17.6
Rumania	33.6	32.5	32.2	31.4	30.2	29.4	29.4	29.8	29.6	29.1	28.4	28.1	28.0
Sllovenia	26.7	26.5	26.0	25.8	24.7	24.0	24.6	24.3	24.1	23.6	23.1	23.5	23.3
Qipro Jugore	28.7	28.3	28.1	27.9	26.5	26.0	26.5	26.2	26.0	25.6	25.2	25.7	24.8
Spanja	22.2	21.9	21.3	20.2	19.3	18.4	19.5	19.4	19.2	19.2	18.6	18.5	18.2
Sllovakia	18.4	18.2	17.6	17.3	16.8	16.0	16.8	16.4	16.0	15.5	15.0	14.6	14.1
Suedia	18.6	18.1	17.5	16.2	15.6	14.9	15.4	15.0	14.7	14.3	13.9	13.6	13.2
Mbretëria e Bashkuar	12.2	12.3	12.0	11.1	10.6	10.1	10.9	10.7	10.5	10.1	9.7	9.6	9.4
28 vendet e BE-së/Mesatarja (jo e ponderuar)	22.6	22.3	21.8	21.1	20.3	19.6	20.1	19.9	19.6	19.3	18.8	18.6	18.3

Burimi: Schneider (2015)

Tabela 2.12 Madhësia e ekonomisë informale të 3 shteteve europiane (jo anëtare të BE-së) gjatë viteve 2003 – 2015 (si % ndaj GDP-së)

Vendi/Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Norvegjia	18.6	18.2	17.6	16.1	15.4	14.7	15.3	15.1	14.8	14.2	13.6	13.1	13.0
Zvicra	9.5	9.4	9.0	8.5	8.2	7.9	8.3	8.1	7.8	7.6	7.1	6.9	6.5
Turqia	32.2	31.5	30.7	30.4	29.1	28.4	28.9	28.3	27.7	27.2	26.5	27.2	27.8
3 vende jo të BE-së/Mesatarja	20.1	19.7	19.1	18.3	17.6	17.0	17.5	17.2	16.8	16.3	15.7	15.7	15.8
Mesatarja jo e ponderuar e 31 vendeve Europiane	22.4	22.1	21.6	20.9	20.1	19.4	19.9	19.7	19.3	19.0	18.5	18.3	18.0

Burimi: Schneider (2015)

Tabela 2.13 Madhësia e ekonomisë informale të 5 shteteve jo europiane shumë të zhvilluara gjatë viteve 2003 – 2015 (si % ndaj GDP-së)

Vendi/Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Australia	13.70	13.20	12.60	11.40	11.70	10.60	10.90	10.30	10.10	9.80	9.40	10.20	10.30
Kanada	15.30	15.10	14.30	13.20	12.60	12.00	12.60	12.20	11.90	11.50	10.80	10.40	10.30
Japonia	11.00	10.70	10.30	9.40	9.00	8.80	9.50	9.20	9.00	8.80	8.10	8.20	8.40
Zelanda e Re	12.30	12.20	11.70	10.40	9.80	9.40	9.90	9.60	9.30	8.80	8.00	7.80	8.00
SHBA	8.50	8.40	8.20	7.50	7.20	7.00	7.60	7.20	7.00	7.00	6.60	6.30	5.90
Vende të tjera të OECD-së/Mesatarja jo e ponderuar	12.20	11.90	11.40	10.40	10.10	9.60	10.10	9.70	9.50	9.20	8.60	8.60	8.60

Burimi: Schneider (2015)

Tabela 2.14 Madhësia e ekonomisë informale të mesatareve të ndryshme jo të ponderuara gjatë viteve 2003 – 2015 (si % ndaj GDP-së)

Mesataret/Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
28 vendet e BE-së /Mesatarja (jo e ponderuar)	22.6	22.3	21.8	21.1	20.3	19.6	20.1	19.9	19.6	19.3	18.8	18.6	18.3
3 vende jo të BE-së/Mesatarja (jo e ponderuar)	20.1	19.7	19.1	18.3	17.6	17.0	17.5	17.2	16.8	16.3	15.7	15.7	15.8
5 vende të tjera të OECD-së/Mesatarja (jo e ponderuar)	12.2	11.9	11.4	10.4	10.1	9.6	10.1	9.7	9.5	9.18	8.6	8.6	8.6
Të gjithë 36 vendet/Mesatarja (jo e ponderuar)	21.0	20.7	20.2	19.4	18.7	18.0	18.5	18.3	18.0	17.6	17.1	17.0	16.7

Burimi: Schneider (2015)

Sipas BEEPS⁶ V, praktikat e konkurrentëve në sektorin informal ishin penguesit kryesor për firmat. Afërsisht 40% e të gjitha firmave përmenden që ato ndeshen me konkurrencen nga subjektet e paregjistruara ose aktivitetet e sektorëve tjerë informal, me një përqindje që varion nga 12.8% në Armeni deri në dy të tretat në Kosovë.

6 Business Environment and Enterprise Performance Survey (BEEPS) Shënim: BEEPS IV u realizua në vitet 2008-09. BEEPS V u realizua në 2013-2014 (2011-2012 në Rusi)




Figura 2.13 Ekonomia informale

Burimi: BEEPS IV and V

Sipas BEEPS V katër pengesat e firmave në Shqipëri janë: çështjet e energjisë, praktikat e konkurrentëve në sektorin informal; korrupsioni dhe administrimi tatimor. Në boshtin vertikal është ashpërsia, vlerat e larta nënkuptojnë një ambient jo i favorshëm i zhvillimit të biznesit.




Figura 2.14 Pengesat kryesore të zhvillimit të ekonomisë

Burimi: BEEPS IV and V

Korrupsioni është një ndër pengesat kryesore të përmirësimit të ambientit për zhvillimin e biznesit.




Figura 2.15 Krahassimi me vendet e Europës juglindore dhe BEEPS

Burimi: BEEPS IV and V

Megjithëse pak firma kanë aplikuar për leje lidhur me ndërtimin, rreth një e treta e firmave deklaruan se një dhuratë jozyrtare ose një pagese pritet ose kërkohet gjatë periudhës së aplikimit. Shqipëria është më lart se mesatarja e vendeve të Europës Juglindore prej 18.8%. Megjithëse, sipas figurës 2.15 pagesa jozyrtare e realizuar nga firmat për të siguruar një kontratë qeveritare ra nga 6.5% (të vlerës së kontratës) në BEEPS IV në 1.5% në BEEPS V është sipër mesatarës së vendeve të Europës Juglindore. Njëkohësisht, përqindja e firmave që nuk kanë bërë asnjëherë ndonjë pagesë jozyrtare është rritur në 52.7% e cila është serish pak poshtë mesatarës 56.2% (BEEPS V).

2.7.2 Faktorët ndikues në evazionin fiskal

Ekzistojnë disa elemente që ndikojnë nivelin e evazionit fiskal në një vend duke filluar nga kultura, norma tatimore, probabiliteti për kontroll dhe niveli i gjobave.

2.7.2.1 Kultura dhe evazoni fiskal

Hofstede (1980,25) e përkufizon kulturën si: “software i mendjes” e cila dallon anëtarët e një grupi nga një të një tjetri. Bazuar në qëndrimin e vëzhguar tek punonjësit e IBM në 66 vende gjatë viteve 1970, Hofstede (1980, 1983) zhvilloi një rezultat bazuar tek disa shtete lidhur me pesë dimensionet e kulturës për secilin shtet të vëzhguar: distanca e fuqisë, individualizmi, shmangia e pasigurisë, maskiliteti dhe orientimi afatgjatë.

- Distanca e fuqisë pasqyron shkallen sipas së cilës një kulturë beson se duhet të shpërndahet fuqia institucionale dhe organizative (të barabartë apo të pabarabartë) dhe se si duhet të shikohen vendimet e mbajtësve të autoritetit (të kundërshtueshme apo të pranueshme). Me fjalë të tjera, njerëzit në kultura me distancë të madhe të fuqisë janë më të qetë me një status më të lartë sesa kulturat me një distancë fuqie më të ulët. Një distancë e fuqisë e lartë tregon se është lejuar të rritet pabarazia e fuqisë dhe pasurisë brenda shtetit. Ndërsa një distancë e fuqisë e ulët tregon që

theksohet barazia dhe mundësia për secilin. Parashikuesit e distancës së fuqisë janë: (a) klima: e matur nga lartësitë gjeografike. Vendet që ndodhen në lartësi të mëdha mbi nivelin e detit (klime relativisht e ftohtë ose e ftohtë) tentojnë të kenë distancë të fuqisë të ulët (të matur me pikë); (b) popullsia: zakonisht sa më shumë popullsi brenda një kulture aq më e lartë distanca e fuqisë; (c) shpërndarja e pasurisë: sa më e pabarabartë shpërndarja e pasurisë brenda kulturës aq më e madhë distanca e fuqisë brenda kulturës. Pasojat e distancës së fuqisë: më të dallueshmet janë zakonet familjare, marrëdhëniet mes studentëve dhe mësuesve, të rinjve dhe të vjetërve, sistemet gjuhësore dhe praktikat organizative.

- Kolektivizmi përkundrejt individualizmit përshkruan shkallën në të cilën një kulturë beson ose ka besnikëri në vete ose tek grupi. Parashikuesit: (a) zhvillimi ekonomik: kulturat e pasura tentojnë të jenë individualiste ndërsa kulturat e varfëra tentojnë të jenë kolektivistë; (b) klima: kulturat më klimë më të ftohtë tentojnë të jenë më individualiste, ndërsa kulturat me klimë më të ngrohtë tentojnë të jenë më kolektivistë. Kulturat me distancë fuqie të lartë tentojnë të jenë kolektivistë ndërkohë kulturat me fuqi të ulët tentojnë të jenë individualiste. Pasojat: kulturat kolektivistë tentojnë të jenë të orientuara nga grupi, imponojnë një distancë të madhe psikologjike mes anëtareve të grupit dhe atyre jashtë grupit dhe anëtarët e grupit priten të kenë besnikëri të pakushtëzuar ndaj grupit.
- Feminizmi kundër maskilizmit: ky dimension fokusohet në mënyrën se si një vend shpërndan rolet sociale të dy gjinive. Një vlerësim i lartë i maskilizmit tregon që një vend i kushton më shumë rëndësi arritjes, heroizmit, sigurisë dhe suksesit material. Një vlerësim i ultë i maskilizmit tregon që një vend thekson më shumë marrëdhëniet, modestinë, kujdesjen për të varfërit dhe cilësinë e jetës. Parashikuesi: (a) klima: kulturat maskiliste tentojnë të jetojnë në vende më të ngrohta afër ekuatorit dhe kulturat feministe në vende të ftohta larg nga ekuatori. Pasojat: kulturat maskiliste besojnë se burrat duhet të ofrojnë siguri dhe gratë të jenë të mbrojtura. Rolet e gjinive janë qartësisht të dallueshme dhe pabarazia shikohet si e dobishme. E kundërta është e vërtetë për kulturat feministe.
- Shmangia e pasigurisë: i referohet madhësisë në të cilën një kulturë ndihet e kërcënuar nga dyshimi, situatat e pasigurta dhe përpiqet ti evitojë ato duke ndërtuar më shumë struktura. Një shmangie e pasigurisë e lartë tregon që një vend ka një tolerancë të ulët ndaj pasigurisë dhe dyshimit. Kjo krijon një vend të orientuar nga rregullat i cili institucionalizon ligjet dhe rregullimet për të zvogëluar masen e pasigurisë. Një shmangie e pasigurisë e ulët tregon që një vend nuk e shqetëson pasiguria dhe dyshimi, ka më shumë tolerancë për opinione të kundërta. Kjo reflekton një vend që është më pak i orientuar nga rregulli dhe që është më i gatshëm të pranojë ndryshimet dhe të marrë përsipër më shumë risk. Parashikuesit: nuk ka parashikues të saktë. Kulturat me shmangie të pasigurisë së lartë tentojnë të jenë kultura që kanë filluar të modernizohen dhe janë karakterizuar nga një ndryshim i lartë. Ndërsa, kulturat më një shkallë pasigurie të ulët tentojnë të jenë më të qëndrueshme.
- Orientimi afatshkurtër kundrejt afatgjatë: i referohet promocionit selektiv të një bashkësie etike specifike. Ky dimension i referohet më shumë vendeve Aziatike dhe ishte rezultat i një studimi me punonjësit dhe menaxherët Kinez.

Hofstede (1980) theksoi dimensionet kulturore të cilat ishin distanca e fuqisë, individualizmi, shmangia e pasigurisë dhe maskiliteti. Distanca e fuqisë fokusohet në shkallen e barazisë (ose pabarazisë) mes njerëzve në një vend. Në vendet me distancë të fuqisë të lartë, pabarazitë e fuqisë dhe pasurisë lejohet të zhvillohen. Sistemi i tatimeve në këto vende ka gjasa të jetë i pabarabartë dhe të mbrojë pasurinë, kështu që diferenca e lartë e të ardhurave e këtyre vendeve rritet më tej nga sistemi tatimor. Në këtë mënyrë, njerëzit tentojnë të perceptojnë sistemin tatimor si të pandershëm, dhe kërkojnë të shmangin të ardhurat tatimore. Në vendet me distancë të fuqisë të ulët, pabarazitë e autoriteteve dhe pasurisë nuk lejohen të zhvillohen. Nga këto mund të themi se: me të tjera të pandryshuara, sa më e lartë distanca e fuqisë, aq më i lartë evazoni fiskal në një vend.

Individualizmi fokusohet në shkallën në të cilën një vend fuqizon arritjet personale ose kolektive dhe marrëdhëniet ndërpersonale. Në vendet me individualizëm të lartë, të njëjtat standarte vlerash duhet ti aplikohen secilit anëtar të shoqërisë (Hofstede, 1980). Sistemi tatimor në këto vende ka gjasa të jetë i barabartë dhe të përmbush parimin e aftësisë paguese sepse ligjet tatimore i aplikohen njerëzve në të njëjten mënyrë dhe barra tatimore shpërndahet në mënyrë të barabartë (Sandford, 2000). Në vendet me individualizëm të ulët, standartet e vlerave ndryshojnë mes grupeve të ndryshme (Hofstede, 1980). Kështu, sistemi tatimor në këto vende ka gjasa të jetë i pabarabartë dhe të dhunojë parimin e aftësisë paguese sepse ligjet tatimore i aplikohen njerëzve në mënyra të ndryshme kështu që barra tatimore shpërndahet në mënyrë të padrejtë (Surrey & McDaniel, 1985,89). Nga këto mund të themi se: me të tjera të pandryshuara, sa më i lartë individualizmi, aq më i ulët niveli i evazionit fiskal në një vend.

Shmangia e pasigurisë fokusohet në nivelin e tolerancës për pasigurinë dhe dyshimin brenda një vendi. Në vendet më shmangie të lartë të pasigurisë, ekziston një tolerancë e ulët për pasigurinë dhe dyshimin. Sistemi tatimor në këto vende ka gjasa të jetë kompleks sepse ekziston nevoja e shumë ligjeve dhe rregullimeve për të ulur pasigurinë dhe dyshimin. Kështu, njerëzit e konsiderojnë kompleks sistemin tatimor dhe i shmangen tatimeve (Richardson, 2008). Në vendet me shmangie të ulët të pasigurisë, tregohet më pak shqetësim ndaj pasigurisë dhe dyshimit (Hofstede, 1980). Sistemi tatimor në këto vende ka gjasa të jetë i thjeshtë kështu që ka më pak nevojë për ligje dhe rregullime për rrjedhojë njerëzit tentojnë ta shikojnë sistemin tatimor më të thjeshtë dhe pajtohen me ligjet tatimore (Long & Swingen, 1988). Nga këto mund të themi se: me të tjera të pandryshuara, sa më i lartë niveli i shmangies së pasigurisë, aq më i lartë niveli i evazionit fiskal në një vend.

Maskilizmi fokusohet në shkallen në të cilën një vend fuqizon modelin tradicional mashkullor të arritjes, kontrollit dhe fuqisë të mashkullit. Husted (1999) thekson që në vendet me maskilitet të lartë ka gjasa që të ketë korrupsion më të lartë për arsye të arritjes së suksesit material. Në këto vende evazoni do jetë më i lartë. Të kundërtën mendon Hofstede (2001) i cili zbuloi se vendet me maskilitet të lartë kanë më pak tolerancë sidomos me ato që nuk zbatojnë ligjin. Nga këto mund të themi se: me të tjera të pandryshueshme, ekziston një marrëdhënie mes maskilitetit dhe nivelit të evazionit fiskal në një vend.

Përforcimi ligjor bazuar në rregullin e ligjin siguron një themel të rëndësishëm në parandalimin e korrupsionit dhe evazionit fiskal. Studimet e vendeve të ndryshme theksojnë se rregullimi ligjor i dobët dhe arbitrar inkurajon korrupsionin (Schneider &

Enste, 2000). Nga këto mund të themi se: me të tjera të pandryshueshme, sa më i madh rregullimi ligjor (bazuar në rregullin e ligjin), aq më i ulët niveli i evazionit në një vend.

Shumë studime e përcaktojnë besimin në qeveri si përcaktues të rëndësishëm të evazionit fiskal. Në qoftëse individët besojnë që qeveria do të veprojë sipas interesave të tyre dhe që procedurat janë të drejta ka gjasa që ato të bashkëpunojnë më shumë në pagimin e tatimeve. Studimi nga Slemrod (2003) mbështeti marrëdhënien negative mes besimit në qeveri dhe evazionit fiskal. Nga këto mund të themi se: me të tjera të pandryshueshme, sa më i lartë besimi tek qeveria, aq më i ulët niveli i evazionit në një vend.

Besimet socializojnë njerëzit në atë mënyrë që të kufizojnë sjelljet devijuese. Studimet empirike tregojnë që ekziston një marrëdhënie negative mes besimit dhe evazionit fiskal. Nga këto mund të themi se: me të tjera të pandryshueshme, sa më i lartë besimi aq më i ulët niveli i evazionit në një vend.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar ekonomia në tranzicion është një ekonomi që po përjeton kalimin nga një ekonomi e centralizuar drejt një ekonomie tregu.

Përbërësit kryesor të procesit të tranzicionit janë:

- *Liberalizimi*: procesi i lejit të vendosjes së çmimit nga tregu i lirë dhe zvogëlimi i barrierave tregtare që ndërpret kontaktet me ekonominë botërore.
- *Stabilizimi Makroekonomik*: fillimisht procesi përmes të cilit inflacioni vendoset nën kontroll dhe ulet me kalimin e kohës. Ky proces kërkon disiplinë në politiken fiskale dhe monetare dhe përmirësim të qëndrueshëm drejt bilancit të pagesave.
- *Ristrukturimi dhe privatizimi*: procesi i krijimit të një sektori financiar të suksesshëm dhe reformimi i sipërmarrjeve në këto ekonomi për t'i shndërruar ato në biznese që prodhojnë mallra që mund të shiten në treg të lirë dhe transferimi i pronësisë në duart e privatit.
- *Reformat ligjore dhe institucionale*: Këto nevojiten për të ripërcaktuar rolin e shtetit në këto ekonomi, për të ndërtuar rregullin e ligjit, dhe për të prezantuar politikat e konkurrencës së duhur.

Sipas Sandmo (2004): le të jetë W e ardhura bruto e tatimpaguesit. Ekziston një normë tatimi proporcional mbi të ardhura t. E ardhura e fshehur (shmangur) është E , kështu e ardhura e raportuar është $W-E$. Në qoftë se evazoni fiskal nuk është zbuluar nga autoritetet tatimore, e ardhura tatimore është:

$$Y = W - t(W - E) = (1 - t)W + tE$$

Në qoftë se zbulohet që tatimpaguesi ka nënraportuar të ardhurat, ai do të paguajë një normë dënimi të tatimit, θ , mbi sasinë e fshehur, kështu e ardhura neto në këtë rast është:

$$Z = (1 - t)W + tE - \theta E = (1 - t)W - (\theta - t)E$$

Tatimpaguesi është konceptuar si një kundërshtues risku dhe si një maksimizues racional i dobishmërisë së pritshme. Tatimpaguesi ballafaqohet me një audit me probabilitet p , kështu dobishmëria e pritshme është:

$$V = (1-p)U(Y)+pU(Z)$$

Meqë tatimpaguesi supozohet të jetë kundërshtues i riskut, U duhet të jetë rritëse dhe konkave. Tatimpaguesi zgjedh sa të ardhura të fsheh (E) në mënyrë që të maksimizojnë dobishmërinë e pritshme.

- ✓ Një rritje e normës së auditimit zvogëlon evazionin.
- ✓ Një rritje në normën e dënimit zvogëlon evazionin.
- ✓ Në qoftëse tatimpaguesi ka zvogëluar kundërshtimin e riskut E rritet në W.
- ✓ Një rritje në normën e tatimit rrit evazionin (Yitzhaki model).

Sandmo (2004) shtoi një shpjegim në lidhje me modelin ekzistues: meqë tatimpaguesi e parashikon vetë normën e auditit ose probabilitetin e auditimit, në fakt është një probabilitet subjektiv. Mund të ndodh që tatimpaguesi, në mënyrë sistematike, të mbi-vlerësojë probabilitetin e auditimit. Sandmo (2004) theksoi, gjithashtu, që njerëzit i shmangen evazionit fiskal si pasojë e konsideratave sociale dhe morale, dhe jo vetëm kundërshtimit të riskut.

Kështu u propozua një tjetër model që prezantoi një term tjetër jodobishmëri “ndërgjegje e keqe-bad conscience”:

$$V = (1-p)U(Y)+pU(Z)-B(E)$$

ku B(E) është termi jodobishmëri. Prezenca e këtij faktori ka efektin e dëshiruar në uljen e masës së evazionit duke konsideruar parametrat e tjerë të barabartë. Andreoni, Erard dhe Feinstein (1998) identifikoi tre faktorë të rëndësishëm moral dhe social që lidhen me nivelin e evazionit fiskal: rregullat morale dhe ndjenjat; perceptimi i tatimpaguesit për ndershmërinë e sistemit tatimor dhe barren tatimore; dhe shkallen e kënaqësisë që tatimpaguesit kanë në lidhje me autoritetet publike.

- ✓ Tatimpaguesit me ndjenja morale të forta do t'i shmangen më pak tatimeve;
- ✓ Evazoni është më i lartë në sistemet tatimore që perceptohen më pak të ndershme;
- ✓ Evazoni është më i lartë në qoftëse tatimpaguesit janë më pak të kënaqur nga shërbimet dhe mallrat publike.

Këto variabla shtesë i bashkangjiten modelit:

M: matës indirekt i standarteve morale

F: matës indirekt i perceptimit të ndershmërisë së sistemit tatimor

S: matës indirekt i kënaqësisë me mallrat dhe shërbimet publike

Siç është përshkruar më sipër:

- ✓ E zvogëlohet nga M
- ✓ E zvogëlohet nga F
- ✓ E zvogëlohet nga S

Bloomquist (2003) vëzhgoi edhe një faktor tjetër; pabarazinë e të ardhurave. Rezultatet empirike të tij evidentojnë se përputhshmëria me tatimet është e lartë mes tatimpaguesve të klasës së mesme dhe zvogëlohet në klasat e tjera, shumë të varfëra dhe shumë të pasura. Kjo shpjegohet me faktin që nga njëra anë theksohet tatimi tek të ardhurat e ulëta (dëshira relative për të shmangur është e lartë ndërsa tatimpaguesit me të ardhurat të ulëta mund të

ndiejnë që situata e tyre është e padrejtë) dhe në anën tjetër një pabarazi e perceptuar e tatimpaguesve me të ardhura të larta, të cilët e ndiejnë që po paguajnë më shumë në “sistem” sesa po marrin në terma të shërbimeve publike.

Një shpjegim i tretë mund të parashtrohet dhe njihet si supozimi Holzner. Konkretisht: supozohet se dënimi për evazionin nuk është një ndarje e thjeshtë e madhësisë së të ardhurave të shmangura ose madhësisë së tatimit të shmangur, por në fakt barazon një shumë fikse (relativisht e lartë) plus një pjesë të të ardhurave të shmangura ose tatimit të shmangur dhe njëkohësisht supozohet se autoritetet nuk imponojnë gjoka ose ripagesa të borxhit e cila do ti shkaktojë tatimpaguesve rënie poshtë pragut të varfërisë absolute. Kjo sjell këto raste:

- ✓ ato tatimpagues me të ardhura më të ulëta janë më pak kundërshtues të riskut se mesatarja e tatimpaguesve meqë ato kanë më pak për të humbur në terma relative se sa tatimpaguesi mesatar, por më shumë për të marrë në terma relative (kështu vlerësimi i riskut është asimetrik);
- ✓ ato tatimpagues me të ardhura më të larta janë, gjithashtu, më pak kundërshtues të riskut se mesatarja e tatimpaguesve meqë ato janë në gjendje të paguajnë shumën e vetme si gjokë, ndërsa pjesa variabël e gjokës supozohet të mos jetë e tepruar, kështu, ato kanë më pak për të humbur në terma relative.
- ✓ ato tatimpagues që janë në ose afër mesatares së të ardhurave kanë potencialisht shumë për të humbur në terma relative sepse të ardhurat janë mjaftueshmërisht të larta për të imponuar pagesën e plotë të gjokës, por jo aq të larta sa për të qenë të pandikuar duke rezultuar në një dështim në fuqinë blerëse.

Sipas “Shadow Economy as a Higher Order Construct inside European Governance” ekzistojnë disa variabla si niveli i pasurisë, sistemi rregullator dhe rregullimet e biznesit që ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ekonomia informale. Ekziston një korrelacion pozitiv mes ekonomisë informale dhe sistemit tatimor. Sistemi rregullator ka një impakt të rëndësishëm në ekonominë informale dhe një rregullim në sistemin e biznesit zvogëlon nivelin e ekonomisë informale në një mënyrë të konsiderueshme. Rritja e pasurisë zvogëlon ekonominë informale megjithëse ky variabël nuk është direkt në kontrollin e qeverisë. Niveli i pasurisë përfshin GDP për frymë dhe koeficientin Gini; sistemi tatimor përfshin normën e tatimit, totalin e pagesës së tatimeve, ndikimin e taksës dhe kontrollin, sistemi rregullator përfshin besimin e publikut, indeksin e çimitit të konsumatorit, të drejtën e pronës, lirinë financiare dhe transparencën qeveritare; rregullimi i biznesit përfshin lirinë e biznesit, detyrimet ndaj qeverisë, lirinë e investimeve dhe statusin e bizneseve.

Esposito Vinzi et al. (2010) ka paraqitur këtë skemë që lidhet me faktorët ndikues në ekonominë informale.




Figura 2.16 Faktorët ndikues në ekonominë informale

Burimi: Esposito Vinzi et al. (2010)

Sipas Aldred, Cullen, Martin dhe Parboteeah (2010), vendet me prirje individualiste kanë shtysë të fortë për sukses dhe zgjedhin të devijojnë nga rrugët ligjore. Shoqëritë me orientime humaniste do të ushqejnë sjellje që zvogëlojnë sjelljet jo ligjore ose evazionin fiskal. Kulturat me orientime të arritjeve të ulëta dhe vlerësim të ulët karakterizohen nga mungesa e mundësive dhe ambicieve për sukses dhe kjo inkurajon firmat të përfshihen në sjellje deviate si evazoni fiskal.

Zakonisht faktorët kryesor që ndikojnë nivelin e evazionit fiskal janë:

- Tradicional (tatimet, kontrolli dhe vlera e gjobave të vendosura);
- Institucional (besimi, korrupsioni dhe përputhshmëria e kostove);
- Socio-kultural (mosha, gjinia, edukimi, normat sociale dhe karakteristika të tjera);
- Makroekonomik (GDP, norma e papunësisë dhe inflacionit); dhe
- Karakteristikat e firmës (madhësia, pronësia dhe sektori).

2.7.2.2 Norma tatimore dhe evazoni fiskal

Clotfelter (1983) shqyrtoi lidhjen mes normës marzhinale të tatimit⁷ dhe evazionit fiskal. Rezultatet e punimit tregojnë që norma marzhinale e tatimit ka një ndikim të rëndësishëm tek niveli i evazionit fiskal në një vend. Punimi sjell evidenca ekonometrike që vërtetojnë se evazoni fiskal ka ndjeshmëri ndaj normës marzhinale tatimore. Lidhja mes evazionit fiskal dhe normës marzhinale tatimore është pozitive dhe koeficienti i korrelacionit varion nga 0.5 deri në 0.3. Rezultat e punimit theksojnë se përveç normës tatimore duhet të merren në konsideratë edhe detyrimet, thjeshtësia e sistemit tatimor dhe informacioni i disponueshëm si mjete shumë të rëndësishëm që ndikojnë nivelin e evazionit fiskal në një vend.

Sipas Allingham dhe Sandmo (1972) nuk ka një marrëdhënie të qartë mes evazionit fiskal dhe normës marzhinale tatimore. Rezultatet e studimit janë të errëta në lidhje me dy variablat: normë interesi dhe evazion fiskal, pra nuk rezulton një lidhje e qartë.

⁷ I referohet normës së tatimit që një individ duhet të paguajë për një dollar shtesë të të ardhurave.

Pommerehne and Weck-Hannemann (1996) prezantuan një analizë empirike të sjelljes tatimore jo në përputhje me ligjin në Zvicër. Në studim u moren të dhëna nga statistikat tatimore për 25 Kantone⁸ për tre vite të ndryshme. Nga punimi rezultoi se ekziston një lidhje e fortë pozitive mes normës marxhinale tatimore dhe evazionit tatimor.

Alm, McClelland dhe Schulze (1991) analizuan arsyen pse njerëzit paguajnë tatimet. Rezultatet eksperimentale sugjerojnë se sjellja ligjore ndodh sepse individë të caktuar e mbivlerësojnë probabilitetin e ulët të kontrollit. Njerëzit paguajnë tatimet jo sepse janë të ndërgjegjësuar se evazoni është një fenomen i gabuar por sepse ato vlerësojnë të mirat publike që gjenerohen nga pagimi i tatimeve. Në eksperiment u shqyrtua efekti i ndryshimit të politikës tatimore përfshirë ndryshimin në normën tatimore (10%, 30%, dhe 50%). Rezultati i studimit tregoi që kur norma tatimore rritet evazoni fiskal rritet.

Caroll (1998) shqyrtoi reagimin e tatimpaguesve në lidhje me rritjen e normës tatimore. Punimi mori në analizë një panel me tatimpagues dhe që përfshin periudhën kur u miratua ligji, në vitin 1990 dhe 1993, për të evidentuar masen e ndryshimit të të ardhurave të deklaruara në përgjigje të ndryshimit të normës tatimore. Nga studimi u arrit në konkluzion se rritja në normën tatimore në të dy vitet e shqyrtuara solli të ardhura më të ulëta të raportuara nga tatimpaguesit. Punimi tregon që norma tatimore mbi të ardhurat, e rritur sipas ligjit të vitit 1993, reduktoi të ardhurat e mbledhura më së shumti me 39% ose më së pakti me 13%.

Mason dhe Calvin (1978) realizuan një sondazh që përfshinte 800 të rritur nga Oregon të cilët një nga katër pranuan që kryenin evazion. Përqindja më e lartë e evazionit u evidentua në personat me moshë të re, me të ardhura të ulëta, meshkuj të cilët besonin se mundësia e kapjes nga autoritet tatimore ishte e ulët. Gjithashtu, punimi arriti në konkluzion se ekziston një marrëdhënie pozitive mes normës tatimore dhe nivelit të evazionit fiskal.

Pommerehne and Frey (1992) në studimin e tyre prezantuan moralin tatimor në modelin noeklasik standart të evazionit fiskal. Arsyeja kryesore është përmirësimi i performancës së modelit i cili nuk ishte në gjendje të shpjegonte mirë sjelljen ligjore në mënyrë empirike. Rezultatet theksuan një lidhje pozitive mes normës tatimore dhe evazionit fiskal.

Fisman dhe Wei (2004) analizuan nivelin e evazionit fiskal si përgjigje ndaj normës tatimore në Kinë. Konkluzioni i studimit ishte që një pikë përqindje rritje në normën tatimore shoqërohet me tre pikë përqind rritje në nivelin e evazionit fiskal.

Chiarini, Marzano dhe Schneider (2008) realizuan një studim nëpërmjet të cilit u shqyrtuan karakteristikat afatgjatë të evazionit fiskal dhe lidhjen me detyrimin tatimor duke përdorur si bazë seri zyrtare kohore të TVSH-së së shmangur në Itali. Studimi u fokusua në tre çështje të cilat ishin të paanalizuara më parë. *Së pari*, duke përdorur matësa të ndryshëm të aktivitetit ekonomik si variabla referencë në llogaritjen e detyrimeve mesatare fiskale, është shqyrtuar madhësia dhe dinamika e mbingarkesës me origjinë tek evazoni fiskal. *Së dyti*, duke përdorur teknikat e kointegritimit, është përcaktuar në vlerë elasticiteti mes evazionit fiskal dhe normës mesatare tatimore në Itali. *Së treti*, është diskutuar në lidhje me marrëdhënien ngarkesë tatimore dhe evazion fiskal, për të identifikuar nëse ka ndonjë evidencë të një “rrethi vicious” mes tyre. Gjatë periudhës së marrë në shqyrtim është evidentuar një “hendek” i vazhdueshëm ku norma tatimore efektive⁹ është më e lartë se norma tatimore e dukshme¹⁰. Karakteristikat statistike të këtij “hendeku” sqarojnë që

8 Termi në anglisht Cantons; njësi administrative në Zvicër.

9 Është raporti të ardhurave me GDP.

10 Është raporti i të ardhurave me GDP neto.

luhatet rreth një vlere fikse prej 11% me efekte afat-shkurtra nga ç'rregullime të jashtme. Në këtë mënyrë, tatimpaguesit përdorin një strategji të evazionit fiskal me qëllim mbajtjen e këtij “hendeku” në ekuilibër, madhësia e të cilit mund të lidhet më çështjet e kundërshtimit të riskut. Duke u bazuar në të dhënat e periudhës 1980-2004 rezultoi që ekziston një marrëdhënie pozitive mes evazionit dhe normës tatimore. Gjithashtu, pavarësisht faktit që evazoni fiskal zë vend të dukshëm në ekonominë italiane, nuk u evidentua ndonjë rreth vicioz me shtrëgim fiskal.

Feinstein (1991) prezantoi një analizë ekonometrike të evazionit fiskal në të ardhura dhe zbulimit të tij bazuar në të dhënat në nivel individual të marrë nga Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme dhe Programi i Matjes së Përputhshmërisë së Tatimpaguesit. Modeli i ndërtuar në punim konsiston në dy ekuacione: i pari mat masen e evazionit dhe i dyti pjesën e evazionit fiskal që zbulohet. Analiza empirike zbulon ndikimin e të ardhurave, normës marzhinale tatimore dhe karakteristikave të ndryshme socioekonomike tek sjellja evazioniste. Punimi pasqyroj një lidhje negative mes normës tatimore edhe evazionit fiskal. Baldry (1987) realizoi një eksperiment i cili përsëriti procedurat e vlerësimit të tatimit mbi të ardhurat dhe kishte si qëllim të testoj dy parashikimet e teorisë së evazionit fiskal: çdo individ do të tentojë të realizojë evazion në qoftë se përfitimet e pritshme janë pozitive, dhe që një ndryshim në normën tatimore marzhinale nuk do të influencojë madhësinë e evazionit fiskal. Përfundimet e eksperimentit ishin se norma tatimore nuk kishte ndikim tek evazoni fiskal.

Gorodnichenko, Martinez-Vazquez dhe Peter (2008) shqyrtuan efektin e reformës së tatimit të sheshtë në 2001 në Rusi. Autorët përdoren mospërputhjen mes shpenzimeve të shtëpisë dhe të ardhurave të raportuara si një tregues i evazionit fiskal me të dhëna nga një panel shpenzimesh shtëpiake për periudhën 1998-2004. Nga studimi u konstatua një ndryshim i madh dhe i rëndësishëm në evazionin fiskal që shoqëroi reformën e taksës së sheshtë. Punimi arriti në disa konkluzione të rëndësishme për financën publike. *Së pari*, siguroi një evidencë bindëse të lidhjes pozitive mes normës tatimore dhe evazionit fiskal. *Së dyti*, ofroi një metodologji empirike për llogaritjen (vlerësimin) e evazionit fiskal. *Së treti*, zhvilloi një strukturë të zbatueshme për të vlerësuar ineficiencën ekonomike nga tatimi mbi të ardhurat personale në prani të evazionit fiskal bazuar në ndryshimet në konsum si rezultat i ndryshimit në tatime.

Një rritje në normën tatimore solli një ulje të të ardhurave të vetëdeklaruar në Kanada në vitin 1988 kur ndryshoi norma marzhinale tatimore (Sillamaa dhe Veall, 2000).

Nur-tegin (2008) realizoi një vlerësim empirik të një numri përcaktuesish të evazionit fiskal. Analiza përfshin normën tatimore, probabilitetin për zbulim nga autoritetet, besimin në qeveri, kostot e sjelljes ligjore dhe korrupsionin. Janë analizuar të dhënat e sondazhit në nivel biznesi. Në studim janë përfshirë 4,538 firma nga 23 ekonomi në tranzicion. Ndër rezultatet interesante të punimit ishte se shkalla e evazionit fiskal në biznese nuk ka gjasa të zvogëlohet duke ulur normën tatimore.

2.7.2.3 Probabiliteti për kontroll

Një tjetër faktor që ndikon tek evazoni fiskal është mundësia e zbulimit nga autoritetet tatimore të sjelljes jo-ligjore të tatimpaguesit. Zakonisht, një rritje në probabilitetin e kontrollit tatimor e bën vendimmarjen për të realizuar evazion më me risk. Duke supozuar që tatimpaguesi është kundërshtues i riskut, një rritje e numrit të kontrolleve zvogëlon evazionin fiskal.

Ekzistojnë edhe disa studime kontradiktore ti tillë si me rritjen e numrit të kontrolleve rritet sjellja evazioniste, pra lidhje pozitive mes evazionit fiskal dhe numrit të kontrolleve (Milltone, 2006).

Sipas studimit të bërë nga Engida dhe Baisa (2014), ekzistojnë disa faktorë që ndikojnë sjelljen e tatimpaguesve në Etiopi (Mekelle). Faktorët që u konsideruan të rëndësishëm të merreshin në shqyrtim ishin: probabiliteti për kontroll, perceptimet e shpenzimeve qeveritare, perceptimet e barazisë dhe drejtësisë, dënimet, kufizimet financiare, ndryshimet në politikat aktuale qeveritare, ndikimi i grupeve të referencës, roli i autoriteteve tatimore dhe njohuritë mbi tatimet. Nga gjetjet kërkimore rezultuan se faktorët me ndikim më të rëndësishëm ishin probabiliteti për tu kontrolluar (lidhje pozitive), kufizimet financiare (lidhje negative) dhe ndryshimet në politikën aktuale qeveritare (lidhje negative). Probabiliteti për tu kontrolluar rezultoi faktori kryesor shpjegues në përcaktimin e sjelljes së tatimpaguesve i ndjekur pas nga ndryshimet në politiken qeveritare dhe kufizimet financiare. Nga studimi rezultoi se tatimpaguesit të cilët kanë kufizime thelbësore financiare dhe përjetojnë ndryshime në politiken qeveritare tentojnë të jenë më pak të bindur ndaj ligjit (lidhje negative). Rezultatet sugjerojnë që variablat e tjerë si perceptimi mbi shpenzimet qeveritare, perceptimi mbi barazinë dhe drejtësinë, dënimet, roli i autoriteteve tatimore dhe njohuritë mbi tatimet nuk kishin ndikim të rëndësishëm në sjelljen e tatimpaguesve në kohën e realizimit të studimit.

Crane dhe Nourzad (1986) analizuan efektin e inflacionit mbi evazionin fiskal total në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në harkun kohor prej 1947-1981. Nga studimi u arrit në përfundim se evazoni fiskal si në terma absolute dhe relative është i lidhur pozitivisht me normën e inflacionit. Gjithashtu rezultoi se evazoni fiskal rritet me rritjen e normës marxhinale tatimore por bie me rritjen e probabilitetit për zbulim dhe normës së dënimit. Evazoni fiskal është rritur në terma absolut por ka rënë në terma relative kur e ardhura reale e vërtetë është rritur. Një përqind rritje në normën e inflacionit rezulton në 0.14% rritje në të ardhurat e paraportuara, në këtë mënyrë autoritet tatimore duhet të shtojnë përpjekjet gjatë periudhave inflacioniste.

Pommerehne dhe Weck (1996) realizuan një analizë empirike të sjelljes jo ligjore të tatimit mbi të ardhurat në Zvicër bazuar në një model standart të evazionit fiskal. Sjellja jo ligjore evidentohet të jetë e lidhur pozitivisht me normën marxhinale tatimore dhe negativisht me probabilitetin për kontroll.

Nuk u shfaqen evidenca të një efekti të madh të normës së dënimit. Modeli i zgjeruar i punimit sugjeron që sjellja jo ligjore është e lidhur pozitivisht me inflacionin, gjithashtu sjellja jo ligjore nuk është e shpeshtë kur tatimpaguesit kanë kontroll direkt tek buxhetet qeveritare.

Palil, Hamid dhe Hanafiah (2013) studiuan përcaktuesit e sjelljes jo ligjore në Malajzi. U morën në shqyrtim katër përcaktues të sjelljes ligjore (përputhshmërisë fiskale): probabiliteti për tu kontrolluar, perceptimi në lidhje me shpenzimet qeveritare, norma tatimore dhe roli i autoritetit tatimor. Nga sondazhi i realizuar prej 1,073 anketuesish, rezultatet evidentojnë faktin që të katër përcaktuesit janë të rëndësishëm dhe kanë një impakt të konsiderueshëm në sjelljen ligjore (përputhshmëri ndaj tatimeve). Këto faktorë supozohet të kenë ndikim në sjelljen ligjore edhe në shtete të tjera të cilat kanë të njëjtat karakteristika kulturore, politike dhe ekonomike si vendi i marrë në shqyrtim.

Tabela 2.15 Faktorët ndikues të marrë në studimin e evazionit në Malajzi

Variablat	Simboli	Përshkrimi
Përputhshmëria në lidhje me tatimet (variabël i varur)	PT	Pikët totale rrjedhin nga 26 pyetjet e pyetësorit. Pikët totale minimale për çdo anketues janë 26 (1 pikë shumëzuar me 26 pyetje, ku 1=sjellje jo ligjore) dhe pikët totale maksimale janë 130 (5 herë 26 pyetje, ku 5=sjellje në përputhje me ligjin).
Probabiliteti për tu kontrolluar (E1)	PROBKONTR	Probabiliteti i tatimpaguesit për tu kontrolluar ose investiguar nga autoritet tatimore. Minimumi i pikëve është 1 (sjellje jo ligjore) dhe maksimumi është 15 (sjellje në përputhje me ligjin).
Perceptimi i shpenzimeve qeveritare (E2)	SHPENZQEV	Perceptimi i tatimpaguesit se si qeveria shpenzon paratë e tatimpaguesve ose rishpërdan tatimet e mbledhura. Minimumi i pikëve është 1 (sjellje jo ligjore) dhe maksimumi është 15 (sjellje në përputhje me ligjin).
Norma Tatimore (E3)	NORMA	Perceptimi i tatimpaguesit ndaj normës tatimore. Minimumi i pikëve është 1 (sjellje jo ligjore) dhe maksimumi është 15 (sjellje në përputhje me ligjin).
Roli i Autoriteteve Tatimore (E4)	ROLI	Roli i autoriteteve tatimore në administrimin e sistemit tatimor (eficiencia, rimbursimet, përgjigjet ndaj ankesave, shërbimi ndaj tatimpaguesve, etj). Minimumi i pikëve është 1 (sjellje jo ligjore) dhe maksimumi është 15 (sjellje në përputhje me ligjin).

Burimi: Palil, Hamid dhe Hanafiah (2013)

Tabela 2.16 Rezultatet e përpunimit statistikor të studimit për Malajzinë

Matrica e Korrelacionit të Pearson për Variablat e Varur (PT) dhe të Pavarura						
		1	2	3	4	5
1	PT	1.000				
2	PROBKONTR	0.551	1.000			
3	SHPENZQEV	0.358	-0.022	1.000		
4	ROLI	0.394	-0.014	0.411	1.000	
5	NORMA	-0.594	0.390	-0.035	0.036	1.000

Burimi: Palil, Hamid dhe Hanafiah (2013)

Falsetta, Schafer, dhe Tsakumis (2010) studiuhan se si ndikojnë probabiliteti për kontroll dhe konflikti i interesit në gjykimin e njerëzve për kryerje të evazionit fiskal. Rezultatet e studimit tregojnë që konflikti i interesit zbut influencën e probabilitetit për kontroll në vendimmarrjen e tatimpaguesit për të realizuar evazion apo jo. Probabiliteti për kontroll ndikon sjelljen e tatimpaguesit kur konflikti i interesit është i ulët. Në rastin kur konflikti i interesit është i lartë, përputhshmëria e tatimpaguesit me ligjin është e ulët pavarësisht probabilitetit për kontroll. Studimi nxjerr në pah edhe një rezultat tjetër të rëndësishëm që tatimpaguesve duhet t'i shpjegohet pse po taten dhe si ato do të përfitojnë nga shpenzimet qeveritare prej të ardhurave nga tatimet e mbledhura. Në këtë mënyrë qeveria ndërgjegjëson tatimpaguesit në lidhje shpërndarjen efiçiente të të ardhurave të mbledhura nga tatimet.

Spicer dhe Hero (1985) shqyrtojnë orientimet që përdor tatimpaguesi kur merr vendime në lidhje me kryerjen e evazionit apo jo. Niveli personal i evazionit të tatimpaguesit është i lidhur pozitivisht me atë çfarë tatimpaguesi percepton si nivel të evazionit të realizuar nga

të tjerët. Tatimpaguesit të cilët janë audituar më parë ka gjasa të vlerësojnë probabilitetin për kontroll më të lartë dhe kështu të ulin nivelin e tyre të evazionit.

2.7.2.4 Norma e dënimit (gjobës)

Zakonisht norma e dënimit (gjobës) dhe norma e kontrollit shikohen si zëvendësues. Allingham dhe Sandmo (1972) nxoren si konkluzion se një rritje në normën e dënimit rrit sjelljen e tatimpaguesve në përputhje me ligjin aq sa është ndryshimi në ndikimin e probabilitetit të kontrollit domethënë të bërit e evazionit fiskal më të kushtueshëm.

Witte and Woodbury (1985) në studimin e tyre arriten në përfundimin se ekziston një lidhje negative e rëndësishme mes ashpërsisë së dënimeve dhe evazionit fiskal.

Crane dhe Nourzad (1986) arriten në konkluzion se evazoni fiskal ulet në terma absolut apo relativ me rritjen e normës së dënimeve (gjobave).

Fjeldstad dhe Semboja (2001) shqyrtuan faktorët që ndikojnë në sjelljen ligjore ndaj tatimeve në Tanzani. Objektivi kryesor i studimit ishte të zbulojë sjelljen vendimmarrëse të tatimpaguesve. Për të eliminuar problemet e kujtesës u morën në konsideratë vetëm dy vite 1995 dhe 1996. Ato ngriten pesë hipoteza: H₁. Sjellja në përputhje me ligjin ka gjasa të jetë prezent tek tatimpaguesit që kanë të ardhura më të larta; H₂. Sjellja në përputhje me ligjin ka gjasa të jetë prezent kur probabiliteti i ndjekjes penale është i lartë; H₃. Sjellja në përputhje me ligjin ka gjasa të jetë prezent kur sanksionet kundër evazionit fiskal perceptohen të jenë të ashpra; H₄. Një tatimpagues ka gjasa t'i bindet ligjit kur ai percepton që marrëdhënia me shtetin është e ndershme; H₅. Sa më pak shkelës të ligjit të njohë një tatimpagues, aq më shumë ka gjasa ti bindet vetë ligjit.

Për t'i kthyer përgjigje hipotezave të mësipërme u realizua një sondazh në rajone të ndryshme në Tanzani. Rezultatet e sondazhit tregojnë që sjellja ligjore është pozitivisht e lidhur me faktorët si aftësia për të paguar, probabiliteti i perceptuar për tu ndjekur penalisht dhe numri i shkelësve të ligjit të njohur personalisht nga tatimpaguesi. Barra e rëndë tatimore, ngacmimet e tatimpaguesve dhe pakënaqësia me shërbimet publike ka gjasa të rrisin rezistencën tatimore dhe mund të shpjegojnë përhapjen e evazionit fiskal.

Friedland, Maital dhe Rutenberg (1978), në një kontekst të një stimulim loje, vëzhguan sjelljen kundrejt evazionit fiskal të 15 subjekteve. Nga studimi rezultoi se gjobat e larta tentojnë të jenë pengese më efektive kundër evazionit se sa kontrollet e shpeshta. Vendimi për të nënvlerësuar të ardhurat influencohet nga faktorë të ndryshëm më shumë se sa nga madhësia e nënraportimit. Gjithashtu, sjellja jo ligjore varion sipas individëve.

KAPITULLI 3. METODOLOGJIA

Sipas Kothari (2004), kërkimi shkencor ka si qëllim ti kthej përgjigje pyetjeve të ndryshme që ngrihen duke përdorur metoda shkencore. Kohët e fundit, roli i kërkimit në fusha të ndryshme ka ardhur duke u rritur.

Metodologjia krijon besueshmëri për rezultatet dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për lexuesit në mënyrë që të vlerësojë rezultatet (Cargill dhe O'Connor, 2009). Kapitulli shpjegon metodat që janë përdorur për kthimin e përgjigjeve të pyetjeve kërkimore të ngritura në fillim të studimit dhe gjithashtu përshin mënyren e përzgjedhjes së mostres, mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Duke u bazuar tek qëllimet e kërkimit, projektet kërkimore mund të grupohen në tre tipe: (a) kërkim zbulues ndërmerret për të shqyrtuar shtrirjen e një problemi, fenomeni apo sjellje; të krijoj disa ide fillestare rreth fenomenit dhe të testoj realizueshmërinë e marrjes përsipër të një studimi më të thelluar lidhur me fenomenin; (b) kërkim përshkrues i adresohet realizimit të vëzhgimeve të kujdesshme dhe dokumentacionit të detajuar të një fenomeni për të cilin interesohemi, pra lidhet me përgjigjen e pyetjeve “çfarë”, “ku” dhe “kur”; (c) kërkim shpjegues bën përpjekje të japë shpjegime të fenomenit të vëzhguar, problemeve ose sjelljeve, pra lidhet me përgjigjen e pyetjeve “pse” dhe “si” (Bhattacharjee, 2012). Në këtë punim janë përdorur tre tipet e kërkimit.

Objektivi i studimit është të evidentojë problematikat e kësaj politike fiskale që po ndiqet në Shqipëri, të analizojë faktorë që ndikojnë në sjelljen e tatimpaguesve, të shqyrtojë nëse kontrolli tatimor ka ndikim në të ardhurat e realizuara nga administrata tatimore dhe të vërtetojë nëse faktorë specifikë ndikojnë eficiencën e administratës tatimore.

3.1 VARIABLAT E MARRË NË STUDIM

Për realizimin e studimit janë ndërtuar dy pyetësorë. Pyetësori i parë është drejtuar tatimpaguesve për të evidentuar faktorët ndikues në përqindjen e deklarimit për efekte tatimore dhe problematikat e politikës fiskale. Pyetësori i dytë i drejtohet punonjësve të administratës tatimore për të ballafaquar opinionet e tatimpaguesve në lidhje me politiken fiskale dhe për të evidentuar faktorët ndikues në eficiencën e administratës tatimore.

Variablat e marrë në konsideratë në një studim mund të jenë të varur, të pavarur, zbutës, ndërmjetësues ose variabla kontrolli. Variablat që shpjegojnë variablat e tjerë quhet variabla të pavarur, ato që shpjegohen nga variabla të tjerë janë variabla të varur, ato që shpjegohen nga variablat e pavarur ndërkohë që shpjegojnë variablat e varur quhet ndërmjetësues dhe ato variabla që ndikojnë lidhjen mes variablave të varur dhe të pavarur quhen variabla zbutës. Në një studim mund të jenë dhe variabla të tjerë të jashtëm, që quhen variabla kontrolli, që nuk janë të lidhur më shpjegimin e një variabli të varur, por mund të ketë ndikim tek variabli i varur (Bhattacharjee, 2012).

Në lidhje me modelin e parë të shqyrtuar:

- variabli pavarur i marrë në studim është përqindja e deklarimit të të ardhurave nga ana e tatimpaguesve dhe është e shprehur në përqindje (nga totali 100% i të ardhurave të realizuara).

- variablat e varur të marrë në konsideratë janë: norma tatimore (TF, TAP, TVSH dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore), numri i kontrolleve, penalitet e vendosura nga kontrolli tatimor, besimi në qeveri, madhësia e bizneseve, statusi ligjor,

aftësia paguese e bizneseve dhe aftësitë e inspektorit të kontrollit tatimor. Shumica e variablave (përveç numrit të kontrolleve, madhësisë së biznesit dhe statusit ligjor) janë pohime të shprehura në shkallën Likert nga 1-shumë dakord deri në 5- nuk jam aspak dakord.

Pyetjet e ndërtuara me shkallë Likert tentojnë të pasqyrojnë opinionet e të anketuarëve lidhur me një pohim.

Në lidhje me modelin e dytë të shqyrtuar:

- variabli varur i marrë në studim është efienca e administratës tatimore,
- variablat e pavarur të përfshirë në model janë objektiviteti i administratës tatimore, sistemi informatik i administratës tatimore, cilësia e kontrollit tatimor, transparenca kundrejt tatimpaguesve, trajtimi i punonjësve dhe kultura e tatimpaguesve. Pyetjet në formën e pohimeve janë ndërtuar duke u bazuar në shkallën Likert. Ndërtimi pyetësorit është bazuar në një studim të kryer në Nigeri nga Shagari (2014).

Është e rëndësishme që përpara së pyetësoni ti shpërndahet mostres së përzgjedhur për studim të bëhet paratestimi i tij. Paratestimi jep mundësinë që të analizohen edhe një herë pyetjet: nëse ato kuptohen, janë të rënditura në mënyrën e duhur apo nëse duhen hequr apo shtuar ndonjë pyetje. Para-testimi u realizua përpara shpërndarjes së pyetësorit tek anketuesit. Pyetësoni drejtuar tatimpaguesve iu shpërnda një kontabilisti të miratuar dhe një administratori të një biznesi ndërsa pyetësoni drejtuar punonjëse iu shpërnda dy punonjësve me experiencë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër. Të dy pyetësorët iu dhanë për shqyrtim një pedagogu të lëndës së Metodave Cilësore.

Mbas një periudhe një javore u mblodhën sugjerimet në lidhje me pyetësorët. Nga sugjerimet e bëra rezultoi se disa pyetje duhej të hiqeshin pasi e rëndonin së tepërmi pyetësonin dhe disa pyetje duhej të shkruheshin në një mënyrë më të qartë pasi gjuha e përdorur ishte tepër teknike. Duke marrë në konsideratë sugjerimet e fazës së paratestimit u rindërtuan pyetësorët.

Përveç të dhënave primare për realizimin e studimit janë marrë dhe të dhëna dytësore. Këto të dhëna janë përdorur kryesisht për analizen e rastit studimor. Burimi i këtyre të dhënave janë kryesisht: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Financave, Instituti i Statistikave, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

3. 2 PËRZGJEDHJA E KAMPIONIT

Përcaktimi i madhësisë së kampionit është një komponent shumë i rëndësishëm për studimin. Pyetësoni i parë është shpërndarë në një kampion prej 105 biznesesh në qytetin e Shkodrës dhe të Durrësit. Nga 150 pyetësorë të shpërndarë u grumbulluan dhe ishin të plotësuar saktë vetëm 105 prej tyre pra, 70% e tyre.

Nga popullsia e bizneseve aktive në qarkun e Durrësit dhe të Shkodrës prej 15,024 biznese (INSTAT), me nivel besimi 95% dhe me interval besimi 10% na rezulton që kampioni të jetë 95 biznese. Shpërndarja e pyetësorëve u realizua brenda një periudhe dy mujore konkretisht dhjetor 2015 dhe janar 2016. Duke u bazuar në formulën e mëposhtme është përllogaritur kampioni studimit.

$$SS = \frac{Z^2 \cdot (p) \cdot (1-p)}{c^2}$$

$$SS = \frac{SS}{1 + \frac{SS-1}{pop}}$$

Ku:

Z = vlera Z (p.sh 1.96 për 95% nivel besimi)

p = përqindja e një zgjedhjeje e shprehur me presje

c = interval besimit e shprehur p.sh .01 = ±1

pop=popullsia

3.3 PËRPUNIMI STATISTIKOR I TË DHËNAVE TË GRUMBULLUARA

Analiza përshkruese siguron një përmbledhje të shkurtër të të dhënave të grumbulluara. Për pyetësin e parë analiza përshkruese është përdorur për të evidentuar problematikat e politikës fiskale aktuale në lidhje me TVSH-në (qëndrueshmëria e bazës ligjore, rimbursimi, llogaritja e TVSH-së në doganë dhe parapagimi); TA (qëndrueshmëria, parapagesa, shpenzimet e panjohura, përcaktimi i kësteve dhe gjobat për parapagimet); Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore (qëndrueshmëria e bazës ligjore, pagat e referencës dhe norma e kontributeve); Kontrolli Tatimor (interpretimi ligjor, gjobat dhe strategjia e përzgjedhjes për kontroll); Politika fiskale (niveli i besimit në qeveri, konkurrenca e pandershme dhe ndikimi në efikasitetin e biznesit). Për pyetësin e dytë analiza përshkruese është përdorur për të pasqyruar mendimin e administratës tatimore në lidhje me politiken fiskale të ndjekur. Gjithashtu, analiza eidenton problemet në lidhje me efikasitetin, objektivitetin, sistemin informatik të administratës tatimore, cilësinë e kontrollit tatimor, transparencën kundrejt tatimpaguesve, trajtimin e punonjësve dhe kulturen e tatimpaguesve.

3.3.1 Analizë regressive me shumë variabla

Regresioni i shumëfishtë është vetëm një zgjerim i analizës së thjeshtë të regresionit; megjithëse, nëse ne zgjerojmë modelin nga një variabël të pavarur në dy ose më shumë, shfaqen disa fakte të reja. Supozimet në lidhje me modelin janë:

- Gabimet individuale të modelit, ϵ , janë statistikisht të pavarur nga njëri tjetri, dhe këto vlera paraqesin një kampion të rastit nga popullimi i gabimeve të mundshme për secilen vlerë të x.
- Për një vlerë të dhënë të x mund të ekzistojnë disa vlera të y, dhe kështu mund të ekzistojnë shumë vlera të mundshme për ϵ . Për më tepër, shpërndarja e mundshme e gabimeve të modelit për çdo vlerë të x është shpërndarje normale.
- Shpërndarjet e vlerave të mundshme të ϵ kanë varianca të njëjta në secilin vlerë të x.
- Mesataret e variabit të varur, y, për gjitha vlerat specifike të x, mund të lidhen me një vijë që quhet modeli i regresionit të popullimit (Groebner, Shannon, Fry, Smith, 2011).

Modeli i të ardhurave të deklaruara për efekte tatimore paraqitet si më poshtë:

$$Y = \alpha_0 + \alpha_1 NT + \alpha_2 NK + \alpha_3 GJK + \alpha_4 BQ + \alpha_5 MB + \alpha_6 SL + \alpha_7 AP + \alpha_8 AI + \varepsilon$$

Y: Deklarimi i Të Ardhurave për Efekte Tatimore

NT: Norma Tatimore (TVSH, TF, TAP, Kontribute)

NK: Numri i Kontrolleve

GJK: Gjobat nga Kontrolli Tatimor

BQ: Besimi në Qeveri

MF: Madhësia e Bizneseve

SL: Statusi Ligjor

AP: Aftësia Paguese e Bizneseve

AI: Aftësitë e Inspektorit Kontrollit

Modeli i efijencës së administratës tatimore paraqitet si më poshtë:

$$Y = \alpha_0 + \alpha_1 PA + \alpha_2 SI + \alpha_3 CK + \alpha_4 TT + \alpha_5 TP + \alpha_6 KT + \varepsilon$$

Y: Efijencia e Administratës Tatimore

PA: Pavarësia e Administratës Tatimore (objektiviteti dhe burokracia)

SI: Sistemi Informatik

CK: Cilësia e Kontrollit Tatimor

TT: Transparenca kundrejt Tatimpaguesve

TP: Trajtimi i Punonjësve

KT: Kultura e Tatimpaguesve

Për modelet e regresionit janë realizuar testet e mëposhtme:

- testi normalitetit
- testi White i heteroskedasticitetit
- testi Breusch – Godfrey Serial Correlation LM
- testi Ramsey Reset

3.3.2 Regresion kuantil për modelin e parë

Regresioni kuantil është një tip analize regresioni. Në një ekuacion regresioni linear, koeficientet e regresionit paraqesin rritjen në variablin e varur si rezultat i rritjes me një njësi në variablin e pavarur që e shoqëron atë koeficient. Regresioni kuantil pasqyron lidhjen mes një grupi variablash të pavarur dhe kuantileve specifike të variablit të varur. Parametri i regresionit kuantil vlerëson ndryshimin në një kuantil specifik të një variabli të varur si rezultat i ndryshimit me një njësi në variablin e pavarur (Despa, 2012). Ky model jep vlerat e pritshme për shembull të medianës së pjesës së variablit të varur në funksion të nivelit të vlerësimit për variablat e pavarur.

Për modelin e parë është realizuar një model regresioni kuantil për të parashikuar medianen e pritshme të përqindjes së deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore nga ana e tatimpaguesve.

3.3.3 Rast studimor i kontrollit tatimor

Një rast studimor është një kërkim empirik që shqyrton një fenomen të caktuar veçanërisht kur kufiri mes fenomenit dhe kontekstit nuk është i qartë (Yin, 1994). Rasti studimor përdor të dhëna të shumta duke përfshirë dy ose më shumë nga: vëzhgime direkte të detajuara, intervista dhe dokumente të ndryshme (Rowley, 2002).

Në rastin studimor të marrë në konsideratë është trajtuar një Drejtori Rajonale Tatimore dhe është vëzhguar çfarë ndikimi ka kontrolli tatimor në të ardhurat e realizuara nga kjo drejtori për vitet 2010-2014.

3.3.4 Përpunimi i të dhënave

Përpunimi i të dhënave është realizuar me Eviews 7, një paketë statistikore e përdorur për analiza ekonometrike. Eviews është një program i përshtatshëm për analizimin e të dhënave, interpretimin e rezultateve dhe nxjerrjen e konkluzioneve. Fushat ku Eviews përdoret fuqishëm janë:

- parashikimi i shitjeve
- analiza e kostos dhe parashikimi
- analiza financiare
- parashikimi makroekonomik
- simulimi
- analiza e të dhënave shkencore dhe vlerësimi

Përdorimi i Eviews mundësoi lehtësi në përpunimin, kuptimin dhe interpretimin e rezultateve.

KAPITULLI 4. ANALIZA E REZULTATEVE DHE GJETJET

4.1 PYETJET KËRKIMORE TË PUNIMIT

Pyetjet kërkimore të studimit janë:

1. Cilët janë problematikat e kësaj politike fiskale që po ndjek qeveria?
2. Si ndikon skema aktuale e parapagimit të tatimit mbi vlerën e shtuar tek biznesi?
3. Si ndikon skema aktuale e parapagimit të kësteve të tatim fitimit?
4. A është e drejtë që ligji kërkon tatimin mbi vlerën e shtuar nga biznesi akoma pa arkëtuar pagesen e mallrave të shitur? (përputhja e arkëtimit me pagesat)
5. A kanë vështirësi bizneset për të paguar detyrimet fiskale?
6. A ndikojnë detyrimet fiskale në rritjen e kredive të këqija?
7. Politika e kontrollit tatimor, a është politikë e drejtë? Si ndikon tek bizneset?
8. Si ndikojnë politikat tatimore në eficienten e biznesit?
9. Si ndikon kultura e biznesit në pagimin e detyrimeve tatimore?
10. Cilët janë faktorët që ndikojnë eficienten e administratës tatimore?
11. Cilët janë faktorët që ndikojnë në nivelin e deklarimit të të ardhurave nga ana e biznesit?

4.2 MODELET E NDËRTUARA

Janë ndërtuar dy modele, i pari lidhet me nivelin e deklarimit (në dy versione) dhe i dyti në lidhje me eficienten e administratës tatimore.

4.2.1 Modeli: Përqindja e Deklarimit të të Ardhurave për Efekte Tatimore

Hipotezat e ndërtuara në lidhje me modelin e parë janë si më poshtë:

H₁: Ekziston një lidhje negative mes nivelit të normës tatimore dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.

H₂: Ekziston një lidhje pozitive mes numrit të kontrolleve dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.

H₃: Ekziston një lidhje pozitive mes nivelit të gjobave nga kontrolli tatimor dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.

H₄: Ekziston një lidhje pozitive mes nivelit të besimit në qeveri dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.

H₅: Ekziston një lidhje pozitive mes madhësisë së biznesit dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.

H₆: Bizneset me pronësi të huaj kanë një nivel më të lartë të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.

H₇: Ekziston një lidhje pozitive mes aftësisë paguese të biznesit dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.

H₈: Ekziston një lidhje pozitive mes nivelit të aftësive të inspektorit dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.

Për realizimin e punimit janë shpërndarë 150 pyetësor ku janë mbledhur vetëm 105 prej tyre. Modeli i përqindjes së deklaramit të të ardhurave për efekte tatimore është si më poshtë:

$$Y = \alpha_0 + \alpha_1 NT + \alpha_2 NK + \alpha_3 GJK + \alpha_4 BQ + \alpha_5 MF + \alpha_6 SL + \alpha_7 AP + \alpha_8 AI + \varepsilon$$

Variabli varur:

Y: Përqindja e Deklarimit të të Ardhurave për Efekte Tatimore

Variabli pavarur:

NT: Norma Tatimore (TVSH, TF, TAP, Kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore)

NK: Numri i Kontrolleve

GJK: Gjobat nga Kontrolli Tatimor

BQ: Besimi në Qeveri

MF: Madhësia e Firmave

SL: Statusi Ligjor

AP: Aftësia e Biznesit për të Paguar

AI: Niveli i Aftësive Profesionale të Inspektorit

Nga përpunimi statistikor me programin Eview 7 i të dhënave të grumbulluara nga pyetësorët e shpërndarë rezultoi:

Tabela 4.1 Rezultatet e analizës së regresionit për modelin të parë

Dependent Variable: Y

Method: Least Squares

Sample: 1 105

Included observations: 105

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	129.4750	13.38298	9.674600	0.0000
XHIRO	0.051732	0.019581	2.641932	0.0096
TF	-3.937639	1.585876	-2.482943	0.0147
TAP	-8.987413	2.098632	-4.282511	0.0000
Aft. Insp	-5.366760	2.413969	-2.223210	0.0285
Aftësia Pag.	-4.293262	2.451176	-1.751511	0.0830
R-squared	0.317718	Mean dependent var		76.81905
Adjusted R-squared	0.283260	S.D. dependent var		22.50674
S.E. of regression	19.05432	Akaike info criterion		8.787910
Sum squared resid	35943.66	Schwarz criterion		8.939565
Log likelihood	-455.3653	F-statistic		9.220278
Durbin-Watson stat	1.732278	Prob(F-statistic)		0

Burimi: Të dhëna primare

Ekuacioni i regresionit rezulton si më poshtë:

Përqindja e deklaramit të të ardhurave për efekte tatimore = 129.4749598 + 0.05173172769*XHIRO - 3.937639254*TF - 8.987413468*TAP - 5.36676033*Aftësia Insp. - 4.293262155*Aftësia Pag.

Nëse Xhiro rritet, përqindja e deklaramit për efekte tatimore rritet për rrjedhojë fshehja e të ardhurave ulet. Pra, nëse Xhiro rritet me një shkallë në vlerësim variabli i varur rritet me 0.05 pikë përqindje.

Nëse vlerësimi se Norma e Tatim Fitimit konsiderohet e lartë rritet, përqindja e deklaramit për efekte tatimore ulet dhe fshehja e të ardhurave rritet. Nëse vlerësimi për normen e Tatimit mbi Fitimin rritet me një shkallë (pra, sa më pak të larta të konsiderohen) përqindja e deklaramit për efekte tatimore ulet me 3.94 pikë përqindje.

Nëse vlerësimi se Norma e Tatimit mbi të Ardhurat Personale janë të larta rritet (domethënë konsiderohet të jo të larta sepse shkalla Likert është ndërtuar nga shumë dakord deri në nuk jam aspak dakord), përqindja e deklaramit për efekte tatimore ulet dhe fshehja e të ardhurave rritet.

Nëse vlerësimi për Normen e Tatimit mbi të Ardhurat Personale rritet me një shkallë (pra, sa më pak të larta të konsiderohen) përqindja e deklaramit për efekte tatimore ulet me 8.99 pikë përqindje.

Nëse vlerësimi për Aftësitë Profesionale të Inspektorit janë të mjaftueshme rritet (pra, aftësitë e inspektorit janë të pamjaftueshme) përqindja e deklaramit për efekte tatimore ulet dhe fshehja e të ardhurave rritet.

Nëse vlerësimi për Aftësitë Profesionale të Inspektorit rritet me një shkallë (pra, konsiderohen jo të mjaftueshme) përqindja e deklaramit për efekte tatimore ulet me 5.37 pikë përqindje.

Nëse vlerësimi për Gjendjen e Biznesit të paguajë në kohë detyrimet rritet (pra, biznesi nuk është në gjendje të paguajë në kohë detyrimet tatimore) përqindja e deklaramit për efekte tatimore ulet dhe fshehja e të ardhurave rritet.

Nëse vlerësimi për Gjendjen e Biznesit të paguajë në kohë detyrimet rritet me një shkallë (pra, biznesi nuk është në gjendje të paguajë në kohë detyrimet tatimore) përqindja e deklaramit për efekte tatimore ulet me 4.29 pikë përqindje.

Faktorët e tjerë si: numri i kontrolleve, gjobat, besimi në qeveri, statusi ligjor etj kanë rezultuar si të parëndësishëm nga analiza.

Koeficienti i përcaktueshmërisë (R^2) tregon që 32% e ndryshimeve që pëson përqindja e deklaramit të të ardhurave për efekte tatimore shpjegohet nga faktorët e përzgjedhur si të rëndësishëm. Pjesa tjetër shpjegohet nga faktorë të tjerë që nuk janë marrë në konsideratë në studim.

Secili nga probabilitetet e variablave të pavarur janë më të ultë se 0.05 (niveli i rëndësisë) përveç variablit të Aftësisë Paguese të Biznesit i cili merret në konsideratë duke u krahasuar me nivelin e rëndësisë 0.1. Ky variabël është pjesërisht i rëndësishëm.

Përveç testimit të secilit variabël, testojmë edhe rëndësinë e përgjithshme të regresionit të shumëfishtë duke përdorur testin F. Probabiliteti i statistikës F është 0.000000 shumë e vogël pra mundësia që të pranohet hipoteza alternative është e papërfillshme. Si përfundim mund të themi që modeli është i rëndësishëm.




Figura 4.1 Testi i normalitetit për modelin e parë

Burimi: Të dhëna primare

H_0 : Mbetjet kanë shpërndarje normale (Termi i gabimit e shpërndahet normalisht)

H_1 : Mbetjet nuk kanë shpërndarje normale (Termi i gabimit e nuk shpërndahet normalisht)

Statistika Jarque-Bera është 25.46297 dhe vlera korresponduese e p është 0.000003. Meqë vlera e p (0.000003) < 0.05 atëherë hidhet poshtë hipoteza bazë. Sipas Green, (2003), normaliteti shikohet shpesh kusht i regresionit i panevojshëm dhe i papërshtatshëm.

Testi i heteroskedasticitetit

Një nga supozimet e analizës ekonometrike regressive është që dispersioni i termit të gabimit për çdo vërtetim është konstant. Kjo, e thënë më ndryshe, është kushti i dispersionit të njëjtë ose homoskedasticiteti. Mosplotësimi i kushtit të homoskedasticitetit quhet heteroskedasticitet. Testi White është ose test për heteroskedasticitetin ose për gabimet e specifikimit ose për të dyja. Në situatat kur me testin White hipoteza bazë mbi mungesën e heteroskedasticitetit bie poshtë, kjo nuk do të thotë patjetër që kemi heteroskedasticitet, por mund të kemi edhe gabime specifikimi të modelit, ose të dyja bashkë (Osmani, 2013). Për këtë test mund të ngrihen hipotezat e më poshtme:

H_0 : Heteroskedasticiteti mungon

H_1 : Heteroskedasticiteti nuk mungon

Tabela 4.2 Testi i heteroskedasticitetit për modelin e parë

White Heteroskedasticity Test:			
F-statistic	1.598396	Probability	0.118968
Obs*R-squared	15.25964	Probability	0.122879

Test Equation:

Dependent Variable: RESID^2

Method: Least Squares

Sample: 1 105

Included observations: 105

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	113.6532	1074.732	0.105750	0.9160
XHIRO	3.454989	2.225177	1.552681	0.1239
XHIRO^2	-0.012481	0.007126	-1.751507	0.0831
TF	150.2251	271.2716	0.553781	0.5810
TF^2	-45.19774	47.26251	-0.956313	0.3414
TAP	-3.189198	264.1568	-0.012073	0.9904
TAP^2	31.42564	49.93483	0.629333	0.5307
Aft. Insp	-856.3319	462.9853	-1.849587	0.0675
Aft. Insp^2	132.5620	69.85271	1.897736	0.0608
Aftësia Pag.	759.2132	469.3120	1.617715	0.1091
Aftësia Pag.^2	-107.4699	69.52931	-1.545678	0.1255
R-squared	0.145330	Mean dependent var	342.3205	
Adjusted R-squared	0.054408	S.D. dependent var	673.9171	
S.E. of regression	655.3276	Akaike info criterion	15.90701	
Sum squared resid	40368704	Schwarz criterion	16.18504	
Log likelihood	-824.1178	F-statistic	1.598396	
Durbin-Watson stat	1.967297	Prob(F-statistic)	0.118968	

Burimi: Të dhëna primare

Meqë vlera e p (0.122879) > 0.05, atëherë hipoteza bazë mbi mungesen e heteroskedasticitetit nuk hidhet poshtë.

Autokorrelacioni

Autokorrelacioni në kontekstin e modelit të regresionit është vartësia e termave të gabimit nga njëri-tjetri. Ai përbën një shkelje të supozimeve bazë të modelit regresiv, pikërisht kushtin sipas të cilit termat e mbetjes ose gabimit nuk duhen të jenë të koreluar midis tyre. Metoda Breusch Godfrey përdoret për të zbuluar korrelacionin serial të rendit të lartë, ose testi LM për autokorrelacion të rendeve të larta (Osmani, 2013).

$$E(e_i, e_j) = 0 \text{ për } i \neq j$$

Për këtë test mund të ngrihen hipotezat e më poshtme:

H_0 : Autokorrelacioni mungon

H_1 : Autokorrelacioni nuk mungon

Tabela 4.3 Testi i korrelacionit serial për modelin e parë

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:

F-statistic	1.129729	Probability	0.327335
Obs*R-squared	2.390130	Probability	0.302684

Test Equation:

Dependent Variable: RESID

Method: Least Squares

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	3.657136	13.60628	0.268783	0.7887
XHIRO	-0.000802	0.019563	-0.041015	0.9674
TF	0.243422	1.594658	0.152648	0.8790
TAP	-0.261991	2.103181	-0.124569	0.9011
Aft. Insp	-0.658445	2.450645	-0.268682	0.7887
Aftësia Pag.	-0.510992	2.481720	-0.205902	0.8373
RESID(-1)	0.118167	0.103166	1.145404	0.2549
RESID(-2)	0.086936	0.102784	0.845808	0.3997
R-squared	0.022763	Mean dependent var	-2.24E-14	
Adjusted R-squared	-0.047759	S.D. dependent var	18.59065	
S.E. of regression	19.02940	Akaike info criterion	8.802979	
Sum squared resid	35125.47	Schwarz criterion	9.005186	
Log likelihood	-454.1564	F-statistic	0.322780	
Durbin-Watson stat	1.972725	Prob(F-statistic)	0.942026	

Burimi: Të dhëna primare

Meqë vlera e p (0.302684) > 0.05 , atëherë hipoteza bazë mbi mungesen e autokorrelacionit nuk hidhet poshtë.

Testi i Stabilitetit

Testi i stabilitetit sqaron problemin e specifikimit të modelit ekonometrik. Testi RESET konsiston në vlerësimin e modelit ndihmës RESET (model i pakufizuar).

Testi RESET¹¹ përdoret edhe kur midis termit të gabimit dhe ndonjë regresori X ka korrelacion. Ky korrelacion mund të ndodhë për shkak të matjes me gabim të variablilit X , simultanitetit, pranisë në model të termave me vonesë dinamike, autokorrelacionit në termin e gabimit etj. Testi RESET thotë se modeli linear është një model i specifikuar mirë.

11 Regression Specification Error Test

Tabela 4.4 Testi i stabilitetit për modelin e parë

Ramsey RESET Test:			
F-statistic	1.430082	Probability	0.244289
Log likelihood ratio	3.051286	Probability	0.217481

Test Equation:

Dependent Variable: Y

Method: Least Squares

Sample: 1 105

Included observations: 105

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	315.6209	544.7727	0.579363	0.5637
XHIRO	0.169134	0.264133	0.640339	0.5235
TF	-11.48222	20.06558	-0.572235	0.5685
TAP	-26.58060	45.46871	-0.584591	0.5602
Aft. Insp	-16.50367	27.70258	-0.595745	0.5527
Aftësia Pag	-13.37562	22.10985	-0.604962	0.5466
FITTED^2	-0.012839	0.072808	-0.176338	0.8604
FITTED^3	-5.98E-06	0.000341	-0.017570	0.9860
R-squared	0.337260	Mean dependent var		76.81905
Adjusted R-squared	0.289434	S.D. dependent var		22.50674
S.E. of regression	18.97208	Akaike info criterion		8.796946
Sum squared resid	34914.17	Schwarz criterion		8.999152
Log likelihood	-453.8396	F-statistic		7.051729
Durbin-Watson stat	1.639232	Prob(F-statistic)		0.000001

Burimi: Të dhëna primare

Meqë vlera e p (0.217481) > 0.05 , atëherë modeli linear është një model i specifikuar mirë.

4.2.1.1 Përqindja e Deklarimit të të Ardhurave për Efekte Tatimore, versioni dytë

Në lidhje me versionin e dytë të modelit të parë, është ndërtuar duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët e tjerë përveç atyre të cilësuar paraprakisht dhe kanë rezultuar se numri i kontrolleve dhe teknikat e kontrollit ndikojnë në përqindjen e deklarimit për efekte tatimore nga ana e tatimpaguesve. Me rritjen e numrit të kontrolleve ulet përqindja e deklarimit për efekte tatimore të të ardhurave dhe me përmirësimin e teknikave të kontrollit rritet përqindja e deklarimit për efekte tatimore të të ardhurave.

Tabela 4.5 Rezultatet e analizës së regresionit për versionin e dytë të modelit të parë

Dependent Variable: Y
Method: Least Squares
Sample: 1 105
Included observations: 105

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	120.9362	14.27105	8.474231	0.0000
Xhiro	7.832868	2.296041	3.411467	0.0009
TF	-6.465572	1.990581	-3.248083	0.0016
TAP	-5.699523	1.906112	-2.990130	0.0035
Numri Kontrolleve	-5.012097	1.991140	-2.517200	0.0135
Teknikat e Kontrollit	3.481659	1.599945	2.176112	0.0320
Aftësia Paguese	-6.819574	2.013738	-3.386525	0.0010
Aftësitë e Inspektorit	-4.350504	2.180885	-1.994834	0.0489
R-squared	0.359195	Mean dependent var		77.77143
Adjusted R-squared	0.312951	S.D. dependent var		20.14909
S.E. of regression	16.70126	Akaike info criterion		8.541977
Sum squared resid	27056.41	Schwarz criterion		8.744184
Log likelihood	-440.4538	Hannan-Quinn criter.		8.623915
F-statistic	7.767432	Durbin-Watson stat		1.414113
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: Të dhëna primare

Përqindja e deklaramit të të ardhurave për efekte tatimore = $120.94 + 7.83 \cdot \text{XHIRO} - 6.47 \cdot \text{TF} - 5.7 \cdot \text{TAP} - 5.01 \cdot \text{Numri Kontrolli} + 3.48 \cdot \text{Tek. Kontroll} - 6.82 \cdot \text{Aft. Pag.} - 4.35 \cdot \text{Aftësia Insp.}$

Ku: Y= përqindja e deklaramit për efekte tatimore




Figura 4.2 Testi i normalitetit për versionin e dytë të modelit të parë

Burimi: Të dhëna primare

H_0 : Mbetjet kanë shpërndarje normale (Termi i gabimit e shpërndahet normalisht)

H_1 : Mbetjet nuk kanë shpërndarje normale (Termi i gabimit e nuk shpërndahet normalisht)

Statistika Jarque-Bera është 0.54 dhe vlera korresponduese e p është 0.765183. Meqë vlera e p (0.765183) > 0.05 atëherë nuk hidhet poshtë hipoteza bazë.

Tabela 4.6 Testi heteroskedasticitetit për versionin e dytë të modelit të parë

Heteroskedasticity Test: White

F-statistic	0.119876	Prob. F(7,97)	0.9968
Obs*R-squared	0.900546	Prob. Chi-Square(7)	0.9963
Scaled explained SS	0.726797	Prob. Chi-Square(7)	0.9981

Test Equation:

Dependent Variable: RESID^2

Method: Least Squares

Sample: 1 105

Included observations: 105

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	298.7977	149.0751	2.004344	0.0478
Xhiro^2	-4.714260	9.271530	-0.508466	0.6123
TF^2	-2.380024	8.585866	-0.277202	0.7822
TAP^2	0.861493	7.650686	0.112603	0.9106
Numri Kontrollleve^2	0.763447	6.841418	0.111592	0.9114
Teknikat e Kontrollit^2	3.223968	5.616878	0.573979	0.5673
Aftësia Paguese^2	-3.291433	6.606748	-0.498193	0.6195
Aftësitë e Inspektorit^2	-0.126551	7.366008	-0.017180	0.9863
R-squared	0.008577	Mean dependent var		257.6801
Adjusted R-squared	-0.062969	S.D. dependent var		356.0778
S.E. of regression	367.1177	Akaike info criterion		14.72237
Sum squared resid	13073215	Schwarz criterion		14.92458
Log likelihood	-764.9246	Hannan-Quinn criter.		14.80431
F-statistic	0.119876	Durbin-Watson stat		1.906868
Prob(F-statistic)	0.996819			

Burimi: Të dhëna primare

Meqë vlera e p (0.9963) > 0.05, atëherë hipoteza bazë mbi mungesen e heteroskedacitetit nuk hidhet poshtë.

Testi Korrelacionit Serial

Meqë vlera e p (0.7925) > 0.05, atëherë hipoteza bazë mbi mungesen e autokorrelacionit nuk hidhet poshtë.

Tabela 4.7 Testi korrelacionit serial për versionin e dytë të modelit të parë

F-statistic	0.208871	Prob. F(2,93)	0.8119
Obs*R-squared	0.465063	Prob. Chi-Square(2)	0.7925

Test Equation:
Dependent Variable: RESID
Method: Least Squares
Sample: 2 105
Included observations: 104

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-0.677969	16.19613	-0.041860	0.9667
Xhiro	-0.251393	2.341994	-0.107341	0.9147
TF	-0.114415	1.945263	-0.058817	0.9532
TAP	0.114420	1.841228	0.062143	0.9506
Numri Kontrollleve	0.028972	1.960570	0.014777	0.9882
Teknikat e Kontrollit	-0.100664	1.569435	-0.064140	0.9490
Aftësia Paguese	-0.152408	1.946313	-0.078306	0.9378
Aftësitë e Inspektorit	-0.038641	2.135136	-0.018098	0.9856
Y(-1)	0.027486	0.133631	0.205685	0.8375
RESID(-1)	-0.057199	0.170258	-0.335952	0.7377
RESID(-2)	0.049290	0.111915	0.440422	0.6607
R-squared	0.004472	Mean dependent var		4.25E-15
Adjusted R-squared	-0.102574	S.D. dependent var		15.22119
S.E. of regression	15.98279	Akaike info criterion		8.480649
Sum squared resid	23756.81	Schwarz criterion		8.760344
Log likelihood	-429.9938	Hannan-Quinn criter.		8.593962
F-statistic	0.041774	Durbin-Watson stat		1.985277
Prob(F-statistic)	0.999997			

Burimi: Të dhëna primare

Tabela 4.8 Testi stabilitetit për versionin e dytë të modelit të parë

Ramsey RESET Test

	Value	df	Probability
t-statistic	1.552306	96	0.1239
F-statistic	2.409655	(1, 96)	0.1239
Likelihood ratio	2.603026	1	0.1067

Test Equation:
Dependent Variable: Y
Method: Least Squares
Sample: 1 105
Included observations: 105

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	259.1943	90.18617	2.873992	0.0050
Xhiro	21.10669	8.849659	2.385029	0.0190
TF	-16.68250	6.872070	-2.427579	0.0171
TAP	-15.15826	6.380441	-2.375738	0.0195
Numri Kontrollleve	-13.18591	5.624441	-2.344395	0.0211
Teknikat e Kontrollit	9.806418	4.373112	2.242434	0.0272
Aftësia Paguese	-18.63379	7.868965	-2.368011	0.0199
Aftësitë e Inspektorit	-11.80652	5.268658	-2.240898	0.0273
FITTED^2	-0.010999	0.007086	-1.552306	0.1239
R-squared	0.374885	Mean dependent var		77.77143
Adjusted R-squared	0.322793	S.D. dependent var		20.14909
S.E. of regression	16.58121	Akaike info criterion		8.536234
Sum squared resid	26393.91	Schwarz criterion		8.763716
Log likelihood	-439.1523	Hannan-Quinn criter.		8.628414
F-statistic	7.196480	Durbin-Watson stat		1.426958
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: Të dhëna primare

Meqë vlera e p (0.1239) > 0.05 , atëherë modeli linear është një model i specifikuar mirë.

Nga analiza e mësipërme mund të rezultojmë në verifikimin apo hedhjen poshtë të hipotezave të ngritura.

Tabela 4.9 Hedhja poshtë/vërtetimi i hipotezave

Hipotezat	Vërtetohet/Hidhet poshtë
H_1 : Ekziston një lidhje negative mes nivelit të normës tatimore dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.	Hidhet poshtë
H_2 : Ekziston një lidhje pozitive mes numrit të kontrolleve dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.	Hidhet poshtë
H_3 : Ekziston një lidhje pozitive mes nivelit të gjobave nga kontrolli tatimor dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.	Rezulton i parëndësishëm si variabël
H_4 : Ekziston një lidhje pozitive mes nivelit të besimit në qeveri dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.	Rezulton i parëndësishëm si variabël
H_5 : Ekziston një lidhje pozitive mes madhësisë së biznesit dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.	Vërtetohet
H_6 : Bizneset me pronësi të huaj kanë një nivel më të lartë të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.	Rezulton i parëndësishëm si variabël
H_7 : Ekziston një lidhje pozitive mes aftësisë paguese të biznesit dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.	Vërtetohet
H_8 : Ekziston një lidhje pozitive mes aftësive të inspektorit dhe nivelit të deklarimit të të ardhurave të biznesit për efekte tatimore.	Vërtetohet

Burimi: Të dhëna primare

4.2.2 Modeli: Faktorët ndikues në efijencën e administratës tatimore

Hipotezat e punimit për modelin e dytë paraqiten si më poshtë:

H_1 : Ekziston një lidhje negative mes Burokracisë të Administratës Tatimore dhe nivelit të Efijencës së Administratës Tatimore.

H_2 : Ekziston një lidhje pozitive mes Sistemit Informatik dhe nivelit të Efijencës së Administratës Tatimore.

H_3 : Ekziston një lidhje pozitive mes Cilësisë së Kontrollit Tatimor dhe nivelit të Efijencës së Administratës Tatimore.

H_4 : Ekziston një lidhje pozitive mes Transparencës kundrejt Tatimpaguesve dhe nivelit të Efijencës së Administratës Tatimore.

H_5 : Ekziston një lidhje pozitive mes Trajtimit të Punonjësve dhe nivelit të Efijencës së Administratës Tatimore.

H_6 : Ekziston një lidhje pozitive mes Kulturës së Tatimpaguesit dhe nivelit të Efijencës së Administratës Tatimore.

Tabela 4.10 Rezultatet e analizës së regresionit për modelin e dytë

Dependent Variable: EFF
 Method: Least Squares
 Sample: 1 50
 Included observations: 50

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	1.432871	0.531261	2.697116	0.0097
KT	0.448211	0.160355	2.795116	0.0075
TP	0.345256	0.133455	2.587050	0.0129
BURO	-0.226767	0.106746	-2.124366	0.0390
R-squared	0.330296	Mean dependent var		3.506667
Adjusted R-squared	0.286620	S.D. dependent var		0.811594
S.E. of regression	0.685487	Akaike info criterion		2.159245
Sum squared resid	21.61507	Schwarz criterion		2.312206
Log likelihood	-49.98112	F-statistic		7.562357
Durbin-Watson stat	1.340848	Prob(F-statistic)		0.000325

Burimi: Të dhëna primare

Efiçienca në kuptimin e mësipërm varet nga Burokracia, nga Kultura e Tatimpaguesve dhe nga Trajtimi i Punonjësve.

Efiçienca e AT= $1.43+0.45*KT+0.35*TP-0.23*Burokracia$

Me përmirësimin e kushteve të punës të punonjësve, rritet dhe efiçienca e administratës tatimore. Me rritjen e një shkalle në vlerësimin e përmirësimin e kushteve të punës të punonjësve efiçienca rritet me 0.35 shkallë vlerësimi.

Me rritjen e kulturës së tatimpaguesve rritet dhe efiçienca e administratës tatimore. Me rritjen e një shkalle në vlerësimin e kulturës së tatimpaguesve efiçienca rritet me 0.45 shkallë vlerësimi.

Me rritjen e burokracisë ulët efiçienca e administratës tatimore. Me rritjen e një shkalle në vlerësimin e burokracisë efiçienca ulët me 0.23 shkallë vlerësimi.

Faktorët e tjerë (si transparenca kundrejt tatimpaguesve, sistemi informatik, cilësia e kontrollit tatimor dhe objektiviteti) kanë rezultuar të parëndësishëm në analizë.

Tabela 4.11 Testi heteroskedasticitetit për modelin e dytë

White Heteroskedasticity Test:			
F-statistic	2.108263	Probability	0.07
Obs*R-squared	11.36538	Probability	0.077719

Burimi: Të dhëna primare

Meqë vlera e p (0.077719) > 0.05, atëherë hipoteza bazë mbi mungesën e heteroskedasticitetit nuk hidhet poshtë.

Tabela 4.12 Testi stabilitetit për modelin e dytë

Ramsey RESET Test:			
F-statistic	0.231224	Probability	0.794520
Log likelihood ratio	0.522767	Probability	0.769986

Burimi: Të dhëna primare

Meqë vlera e p (0.79452) > 0.05 , atëherë modeli linear është një model i specifikuar mirë.




Figura 4.3 Testi i normaliteti për modelin e dytë

Burimi: Të dhëna primare

Statistika Jarque-Bera është 1.207 dhe vlera korresponduese e p është 0.547. Meqë vlera e p (0.547) > 0.05 atëherë hipoteza mbi shpërndarjen normale të termit të gabimit nuk hidhet poshtë.

Tabela 4.13 Testi korrelacionit serial për modelin e dytë

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:			
F-statistic	2.75	Probability	0.074723
Obs*R-squared	5.56	Probability	0.062005

Burimi: Të dhëna primare

Meqë vlera e p (0.062005) > 0.05 , atëherë hipoteza bazë mbi mungesën e autokorrelacionit nuk hidhet poshtë.

4.2.3 Koment probabilitar për nivelin e deklaramit

Në lidhje me modelin e parë është bërë një koment probabilitar dhe paraqitet si më poshtë:

Tabela 4.14 Komenti probabilitar për nivelin e deklarimit

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
Const	1.25905	0.0945094	13.3219	<0.00001	***
TAP	-0.0872921	0.0213289	-4.0927	0.00009	***
Aftësia Pagueuse	-0.0447696	0.014011	-3.1953	0.00187	***
Xhiro	0.000531587	0.000138011	3.8518	0.00021	***
TF	-0.0361596	0.0109786	-3.2936	0.00137	***
Aftësitë e Inspektorit	-0.0419938	0.0189573	-2.2152	0.02904	**

Burimi: Të dhëna primare

Nëse xhiro rritet nga një kategori në tjetren probabiliteti për deklarim në përputhje me ligjin rritet me 0.053%. Nëse vlerësimi se aftësitë e inspektorit janë të mjaftueshme rritet (pra, ulet aftësia) probabiliteti për përputhshmëri të deklarimit për efekte fiskale ulet me 4.20%. Nëse vlerësimi se normat tatimore janë të larta rritet (pra, me konsiderimin sa më të ulëta të normave tatimore) probabiliteti për përputhshmëri të deklarimit të të ardhurave ulet me 3.6% (TF) dhe 8.7% (TAP).

Nëse vlerësimi se biznesi është në gjendje të paguajë në kohë detyrimet rritet (pra, ulet aftësia paguese) probabiliteti për përputhshmëri të deklarimit për efekte fiskale ulet me 4.5%.

Tabela 4.15 Komenti probabilitar për nivelin e deklarimit

Sum squared resid	481.3225		S.E. of regression	2.204959
R-squared	0.462094		Adjusted R-squared	0.434927
F(5, 99)	17.00938		P-value(F)	4.14e-12
Log-likelihood	-228.9238		Akaike criterion	469.8477
Schwarz criterion	485.7714		Hannan-Quinn	476.3003

Statistics based on the original data:

Mean dependent var	0.768190		S.D. dependent var	0.225067
Sum squared resid	3.609871		S.E. of regression	0.190954

Burimi: Të dhëna primare

4.2.4 Regresioni kuantil për deklarimin e të ardhurave për efekte tatimore

Në shtesë të regresionit të shumëfishtë, në lidhje me modelin e parë është bërë një regresion kuantil dhe paraqitet si më poshtë:

Tabela 4.16 Regresioni kuantil

Quantile estimates, using observations 1-105

Dependent variable: Y

Asymptotic standard errors assuming IID errors

	tau	coefficient	std. error	t-ratio

const	0.050	0.838978	0.0573417	14.6312
	0.250	1.34499	0.123056	10.9299
	0.500	1.27905	0.0828357	15.4408
	0.750	1.39643	0.155842	8.96052
	0.950	1.00000	7.68357e-010	1.30148e+009
TAP	0.050	-0.147551	0.00899195	-16.4092
	0.250	-0.127349	0.0192969	-6.59944
	0.500	-0.0901114	0.0129898	-6.93711
	0.750	-0.0704524	0.0244381	-2.88289
	0.950	-3.76230e-010	1.20489e-010	-3.12253
AP	0.050	-0.00295699	0.0105025	-0.281551
	0.250	-0.0515658	0.0225385	-2.28789
	0.500	-0.0524106	0.0151719	-3.45445
	0.750	-0.0270341	0.0285435	-0.947120
	0.950	-2.27714e-010	1.40729e-010	-1.61810
Xhiro	0.050	0.000531661	8.38982e-005	6.33697
	0.250	0.000542797	0.000180047	3.01475
	0.500	0.000762463	0.000121199	6.29099
	0.750	0.000372370	0.000228017	1.63308
	0.950	6.33765e-012	1.12421e-012	5.63745
TF	0.050	0.0176523	0.00679495	2.59786
	0.250	-0.0242171	0.0145821	-1.66074
	0.500	-0.0376188	0.00981599	-3.83240
	0.750	-0.0497487	0.0184672	-2.69389
	0.950	-9.36933e-010	9.10499e-011	-10.2903
AI	0.050	-0.0519415	0.0103431	-5.02186
	0.250	-0.0804802	0.0221964	-3.62582
	0.500	-0.0475073	0.0149416	-3.17954
	0.750	-0.0580897	0.0281102	-2.06650
	0.950	-5.98029e-010	1.38593e-010	-4.31499

Median depend. var 0.800000 S.D. dependent var 0.225067

Burimi: Të dhëna primare

Përqindja e deklaramit për efekte tatimore = $1.29 - 0.0899 \cdot \text{TAP} - 0.0429 \cdot \text{AP} + 0.000517 \cdot \text{Xhiro} - 0.0394 \cdot \text{TF} - 0.0537 \cdot \text{AI}$
 (0.134) (0.0210) (0.0245) (0.000196) (0.0159) (0.0241)

Është marrë në konsideratë modeli medianës:

Përqindja e deklaramit për efekte tatimore të të ardhurave = $1.2791 - 0.0901 \cdot \text{TAP} - 0.0524 \cdot \text{Aft. Pag} + 0.0008 \cdot \text{Xhiro} - 0.0376 \cdot \text{TF} - 0.0475 \cdot \text{Aft. Insp.}$

Ky model jep vlerat e pritshme të medianës së pjesës së të ardhurave që deklarohen në funksion të nivelit të vlerësimit për TAP, AP, Xhiro, TF dhe AI.

Nëse variablat do të kishin vlerësimet 2, 2, 10, 2, 2, mediana e Y, pra mediana e % së të ardhurave të deklaruara për efekt tatimi do të pritej të ishte 83%, ose fshehja e të ardhurave $100-83=17\%$.

Koeficientet pranë çdo variabli tregojnë shtesën marxhinale të medianës së Y, pra sa pritet të shtohet mediana e Y nëse variabli përkatës shtohet me një. Për shembull, nëse vlerësimi për TAP do të shkonte nga 1 në 2, pritet që mediana e Y të pakësohet me 0.0901 me kusht që variablat e tjerë të mbahen të pandryshuar. Pra rritja e vlerësimit për TAP e pakëson medianën e Y, pjesës së deklaruar, dhe anasjelltas rrit fshehjen me 0.0901.

4.2.5 Analiza e variancës për efektin e statusit ligjor dhe degës mbi evazionin

Tabela 4.17 Analiza e variancës për efektin e statusit ligjor dhe degës mbi evazionin

Analysis of Variance for Y - Type III Sums of Squares

Source	Sum of Squares	Df	Mean Square	F-Ratio	P-Value
MAIN EFFECTS					
A:Dega	0.903407	14	0.064529	1.38	0.1820
B:Statusi	0.158513	3	0.0528377	1.13	0.3426
RESIDUAL	4.07812	87	0.046875		
TOTAL (CORRECTED)	5.26816	104			

Burimi: Të dhëna primare

Dallimet midis kompanive me status të ndryshëm lidhur me përqindjen e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore nuk janë sinjifikante.

Dallimet midis kompanive të degëve të ndryshme lidhur me përqindjen e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore nuk janë sinjifikante.

4.3 ANALIZA PËRSHKRUESE

4.3.1 Analiza përshkuese për pyetësin ndaj tatimpaguesve

Analiza përshkuese ka si qëllim të përmbledhë përgjigjet e pyetjeve drejtuar tatimpaguesve në lidhje me problematikat e politikës fiskale.

4.3.1.1 Përmbledhje për tatimin mbi vlerën e shtuar

Përsa i përket TVSH-së mendimet kryesore të tatimpaguesve jepen më poshtë:

Në lidhje me bazën ligjore të TVSH-së rezulton të jetë më shumë një opinion që baza ligjore nuk është e qëndrueshme.

Paradhënia e TVSH-së rëndon mesatarisht gjendjen financiare të biznesit.

Nga opiniononi i tatimpaguesve konstatohet se shkalla tatimore e TVSH-së është e lartë.

Pavarësisht përmirësimeve ligjore të fundit, procedura e rimbursimit të TVSH-së nuk respekton të drejtat e tatimpaguesit.

TVSH-ja e llogaritur mbi bazën e referencave doganore nuk është e drejtë.

Në rastin e borxhit të keq, tatimpaguesit nuk janë dakord që njohja e TVSH-së nga organet tatimore të bëhet vetëm kur është shpallur si i pambledhshëm nga organet gjyqësore.

Norma e kreditimit të TVSH-së për naften nuk është e mjaftueshme.

Vendosja e një norme tatimore të ndryshme për kategori të ndryshme produktesh dhe shërbimesh është më e pranueshme (për shembull: për ushqimet 5%, për mallrat e luksit 30 % etj) për tatimpaguesit.

Pagesa e TVSH-së në doganë në momentin e importit të mallit nuk është e drejtë (pra, akoma pa e shitur mallin).

Përfshirja nga TVSH-ja i makinerive dhe pajisjeve që importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve dhe që importimi kryhet nga vetë tatimpaguesit, pa nënkontraktim, me vlerë mbi 50,000,000 (pesëdhjetë milionë) është pjesërisht e drejtë.




Figura 4.4 Problematikat për TVSH

Burimi: Të dhëna primare

4.3.1.2 Përmbledhje për tatimin mbi të ardhurat

Përsa i përket TA-së opinionet kryesore të tatimpaguesve jepen më poshtë:

Baza ligjore e Tatimit mbi Të Ardhurat (si për tatimin mbi të ardhurat personale ashtu dhe për tatim fitimin) nuk është e qëndrueshme.

Norma e aplikuar e Tatim Fitimit për biznesin konsiderohet e lartë për tatimpaguesit.

Norma e Tatim Fitimit duhet të jetë e diferencuar bazuar në industri të ndryshme ku bën pjesë biznesi.

Nga opinionet e mbledhura vërehet se norma e aplikuar e Tatimit mbi të Ardhurat Personale gjykohet si e lartë.

Sistemi progresiv i Tatimit të të Ardhurave Personale konsiderohet jo i drejtë për situatën aktuale që ndodhet vendi ynë.

Pagesa në avancë e Tatim Fitimit rëndon gjendjen financiare të biznesit.

Për të paguar këstin e Tatim Fitimit biznesi nuk i drejtohet bankave për të marrë kredi.

Një pjesë e shpenzimeve nuk njihen për efekte tatimore. Shpenzimet që nuk njihet nga organet tatimore për efekt Tatim Fitimi të tilla si:

- a. normat për firot ligjore nuk janë të arsyeshme.
- b. normat për shpenzimet e interesit, (për huatë bankare) nuk janë të arsyeshme.
- c. normat e amortizimit nuk janë të arsyeshme.
- d. shpenzimet për aktivet biologjike nuk janë të arsyeshme.

Konsiderimi i kësteve të Tatim Fitimit si borxh ndaj shtetit nuk është e pranueshme.

Përcaktimi i kësteve të Tatim Fitimit për bizneset e reja është arbitrare, gjë që penalizon shumë biznese që fillojnë aktivitetin për herë të parë.

Aplikimi i gjobave për parapagimet e kësteve të Tatim Fitimit nuk është e drejtë.

Tatim i mbajtur në burim për pagesat e qerave nuk është i pranueshëm (15%).

Aplikimi i çmimeve të referencës për qeratë e ndërtesave dëmton mesatarisht biznesin.

Tatim i mbajtur në burim për dividendët nuk është i arsyeshëm (15%).




Figura 4.5 Problematikat për TA

Burimi: Të dhëna primare

4.3.1.3 Përmbledhje për kontributet

Përsa i përket kontributeve mendimet e përgjithshme të tatimpaguesve jepen më poshtë:

Baza ligjore e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore është e qëndrueshme.

Norma e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore është mesatarisht e arsyeshme.

Norma e kontributeve të Sigurimeve Shëndetësore është e arsyeshme.

Në situatën e vendit tonë, aplikimi i pagave të referencës nuk është i pranueshëm.

Ndryshimet e herëpashershme në pagën minimale nuk kanë ndikim të konsiderueshëm tek bizneset.

Detyrimi për të paguar kontributet (për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore) për punonjësit më kohë të pjesshme jo më pak se niveli i pagës minimale (pavarësisht pagës) nuk është i drejtë.




Figura 4.6 Problematikat për Kontributet

Burimi: Të dhëna primare

4.3.1.4 Përmbledhje për kontrollin tatimor

Për kontrollin tatimor mendimet paraqiten si më poshtë:

Aftësitë profesionale të inspektorit tatimor janë mesatarisht të mjaftueshme.

Interpretimi i ligjit nga inspektorët tatimor është pjesërisht i saktë.

Inspektorët tatimor bashkëpunojnë me bizneset për të nxjerrë detyrimet tatimor në shkëmbim të rryshfetit.

Mes inspektorëve tatimor dhe biznesit krijohen marrëdhënie personale.

Nga opinionet e mbledhura arrihet në konkluzion se nuk respektohen me përpikmëri të plotë procedurat e kontrollit tatimor sipas ligjit në fuqi.

Strategjia e kontrollit tatimor nuk është e bazuar në risk.

Teknikat e përzgjedhura për të realizuar kontrollin pengojnë pjesërisht aktivitetin e përditshëm të biznesit.

Dënimet në rast mosrespektimi të legjislacionit janë të larta, kjo theksohet sidomos për fundin e vitit 2015.

Pagesa e detyrimeve të vlerësuara nga kontrolli ose vendosja e garancisë bankare si kusht për fillimin e apelimit nuk është e drejtë.

Arsyeja kryesore e kontrollit tatimor nuk është zbulimi i të metave, ndreqja e tyre për të ardhmen dhe edukimi i tatimpaguesve.

Nga përgjigjet e mbledhura konstatohet se kontrollin tatimor kanë synim të penalizojnë bizneset.




Figura 4.7 Problematikat për Kontrollet Tatimore

Burimi: Të dhëna primare

4.3.1.5 Përmbledhje për politiken fiskale

Në lidhje me politiken fiskale ekzistojnë këto mendime:

Biznesi është mesatarisht në gjendje të paguajë në kohë detyrimet tatimore por bizneset me përgjegjësi të kufizuar e kanë më të vështirë të paguajnë në kohë detyrimet.

Në përgjithësi ekziston opioni se politika fiskale që po ndiqet në Shqipëri nuk është e drejtë. Niveli i besimit në qeveri për kthyeshmërinë e pagesave të tatimeve dhe taksave në formën e të mirave dhe shërbimeve publike për komunitetin është i ulët.

Ecuria e përfitueshmërisë së biznesit vitin e fundit nuk është e kënaqshme.

Konkurrenca e pandershme është një problem shqetësues për biznesin.

Politika fiskale e vitit të fundit ka ndikuar negativisht në efikasitetin e biznesit. Nga tatimpaguesit e anketuar rezulton se përqindja mesatare e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore është 78%.




Figura 4.8 Problematikat për Politiken Fiskale

Burimi: Të dhëna primare

4.3.2 Analiza përshkruese për pyetësin ndaj punonjësve

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e rezultateve nga analiza përshkruese për pyetësin drejtuar punonjësve të administratës tatimore.

4.3.2.1 Përmbledhje për anketuesit

Nga të gjithë të anketuarit 59% ishin meshkuj dhe 41% femra.




Figura 4.9 Struktura e mostres sipas gjinisë

Burimi: Të dhëna primare

Pjesa më e madhe e të anketuarve ishin deri në 30 vjeç dhe 30 deri në 40 vjeç.




Figura 4.10 Struktura e mostres sipas moshës

Burimi: Të dhëna primare

Shumica e të anketuarve ishin me arsim pas universitar.




Figura 4.11 Struktura e mostres sipas arsimit

Burimi: Të dhëna primare

4.3.2.2 Përmbledhje për pëgjigjet e punonjësve tatimor në lidhje me politiken fiskale

Më poshtë paraqiten opinionet që kanë punonjësit e administratës tatimore për politiken fiskale:

Baza ligjore fiskale në Shqipëri nuk është e qëndrueshme.

Shkalla tatimore e TVSH-së nuk është e arsyeshme.

Punonjësit janë të mendimit se shkalla tatimore e Tatimit mbi Të Ardhurat dhe Tatimit mbi Fitimin nuk janë të arsyeshme.

Sistemi progresiv i Tatimit mbi Të Ardhurat nuk është i përshtatshëm për situatën aktuale në Shqipëri.

Norma e Kontributeve Shoqërore dhe Shëndetësore (për punëmarrësin dhe për punëdhënësin) është mesatarisht e arsyeshme.

Nga pikëpamja ligjore, procedura e rimbursimit të TVSH-së për bizneset është përmirësuar por sërish ka nevojë të rishikohet.

Pagesa në avancë e tatimeve rëndon mesatarisht gjendjen e tatimpaguesve.

Vendosja e një norme TVSH-je të ndryshme për kategori të ndryshme produktesh dhe shërbimesh është më e pranueshme.

Skema e aplikimit të TVSH-së duke u bazuar në çmimet e referencës është e gabuar.

Vlerat e penaliteteve në rast shkelje ligjore nuk janë të arsyeshme.




Figura 4.12 Problematikat në lidhje me politiken fiskale

Burimi: Të dhëna primare

4.3.2.3 Përmbledhje për pëgjigjet e punonjësve tatimor në lidhje me efijencën

Ekzistojnë këto opinione në lidhje me efijencën e administratës tatimore:

Sistemi i Menaxhimit Tatimor në Shqipëri është relativisht kompleks në mënyrën e funksionimit të tij.

Administrata Tatimore në Shqipëri nuk ka infrastrukturen e nevojshme për të realizuar menaxhimin tatimor.

Sistemi i Mbledhjes së Tatimeve nuk është efijent (përdor minimumin e burimeve për të marrë maksimumin e rezultatit).

Mbledhja e vlerave të buxhetuara të tatimeve nuk është lehtësisht e arritshme.




Figura 4.13 Efijencia e administratës tatimore

Burimi: Të dhëna primare

4.3.2.4 Përmbledhje për pëgjigjet e punonjësve tatimor në lidhje me objektivitetin

Mendimet në lidhje me objektivitetin janë si më poshtë:

Në administratën tatimore ekziston burokracia.

Punonjësit tatimor nuk janë të pavarur (nga ndërhyrjet politike apo shoqërore) në realizimin e detyrës së tyre.

Administrata tatimore nuk është e pavarur në përzgjedhjen e punonjësve dhe ka ndërhyrje politike.

Përzgjedhja e subjekteve për kontroll pjesërisht bëhet në bazë të analizës së riskut dhe nuk është transparente për tatimpaguesit.




Figura 4.14 Objektiviteti i administratës

Burimi: Të dhëna primare

4.3.2.5 Përmbledhje për pëgjigjet e punonjësve tatimor në lidhje me sistemin informatik

Në lidhje me sistemin informatik ekzistojnë këto konstatime:

Sistemi informatik që përdor administrata tatimore ka mangësi serioze.

Website i Administratës Tatimore plotëson mesatarisht nevojat e tatimpaguesve.

Akresi në Website-n e Administratës Tatimore është jo gjithmonë i mundshëm (në çdo kohë) pavarësisht fluksit të përdoruesve.




Figura 4.15 Sistemi informatik

Burimi: Të dhëna primare

4.3.2.6 Përmbledhje për pëgjigjet e punonjësve tatimor në lidhje me cilësinë e kontrollit tatimor

Në lidhje me kontrollin tatimor, administrata tatimore ka këto opinione:

Punonjësit mendojnë se kontrolli tatimor është shumë i rëndësishëm në arritjen e të ardhurave të tatimore të buxhetuara nga qeveria.

Kontrolli tatimor (në administratën tatimore në Shqipëri) zvogëlon evazionin fiskal dhe parregullsi të tjera.

Nga përgjigjet e mbledhura arrihet në përfundim se arsyeja kryesore e kontrollit tatimor është zbulimi i detyrimeve të fshehura nga tatimpaguesit dhe realizimi i të ardhurave.

Arsyeja kryesore e kontrollit tatimor është mesatarisht zbulimi i të metave, ndreqja e tyre për të ardhmen dhe edukimi i tatimpaguesve.

Inspektori tatimor është nuk ka në dispozicion logjistiken e nevojshme për realizimin e kontrollit tatimor.

Koha për realizimin e kontrollit është mesatarisht e mjaftueshme.

Komunikimi me tatimpaguesit është i vështirë gjatë realizimit të kontrollit.




Figura 4.16 Cilësia e kontrollit

Burimi: Të dhëna primare

4.3.2.7 Përmbledhje për pëgjigjet e punonjësve tatimor në lidhje me trajtimin e punonjësve

Përsa i takon trajtimeve të punonjës mund të arrihet në këto konkluzione:

Punonjësit e administratës tatimore kanë pak mundësi të trajnohen dhe zhvillohen përmes trajnimeve të ndryshme.

Punonjësit e tatimeve nuk e kanë procedurën e punës të shpjeguar qartë.

Orari i punës shtesë nuk paguhet nga administrata tatimore.

Punonjësi i administratës tatimore nuk është i motivuar për të realizuar maksimalisht kërkesat e punës.

Sistemi tatimor stimulon mesatarisht dhënien e rryshfetit administratës tatimore nga ana e tatimpaguesit.




Figura 4.17 Trajtimi punonjësve

Burimi: Të dhëna primare

4.3.3 Rasti studimor në lidhje me drejtorinë rajonale tatimore

Në mënyrë që të shqyrtohet efekti i kontrollit tatimor është marrë në konsideratë një drejtori rajonale tatimore në Shqipëri. Nga të dhënat e mbledhura mund të arrihet në konkluzion se kontrolli tatimor zë një peshë të vogël në të ardhurat e realizuara nga drejtoria rajonale tatimore. Numri i kontrolleve të realizuara është i vogël në krahasim me subjektet për kontroll. Një pjesë të konsiderueshme të zbulimeve të kontrollit e zë “ulja e humbjes”. Gjatë tre viteve të fundit të marrë në konsideratë vërehet se ka rënie të zbulimeve të kontrollit tatimor. Zbulimet kryesore janë të përqendruara tek tatimi mbi vlerën e shtuar.




Figura 4.18 Realizimi i të ardhurave përkundrejt zbulimeve të kontrollit

Burimi: DPT

Tabela 4.18 Zbulimet ndër vite nga kontrolli tatimor

	2010	2011	2012	2013	2014
Numri mesatar i kontrolleve dhe vizitave fiskale të kryera për inspektor në vit	35	35	16	19	22
Zbulimi mesatarisht për një kontroll (mijë lek)	1,017	1,034	1,198	1,094	897
Zbulimi gjithsej nga këto:	567,503	577,269	452,536	374,814	344,573
Detyrime	324,341	194,653	199,927	95,792	116,931
Gjoha	85,030	283,595	118,866	49,022	48,450
Ulje humbje	122,698	95,693	71,422	200,109	165,608
Ulje Kredie TVSH	35,434	3,323	62,321	29,891	13,584
Totali Zbulimeve/TA (faktike)	0.14	0.14	0.11	0.09	0.08

Burimi: DPT

KAPITULLI 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ky kapitull pasqyron konkluzionet dhe rekomandimet e punimit.

5.1 KONKLUZIONE

Nga përpunimi statistikor i të dhënave të grumbulluara nga pyetësorët e shpërndarë rezultojnë këto konkluzione.

Nëse xhiroja e biznesit rritet, përqindja e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore rritet për rrjedhojë fshehja e të ardhurave ulët. Nga kjo konstatohet që bizneset me xhiro të lartë deklarojnë të ardhura për efekte tatimore më shumë. Sa më pak të larta të konsiderohen norma e TF dhe TAP përqindja e deklarimit për efekte tatimore ulët. Nëse vlerësimi për aftësitë profesionale të inspektorit konsiderohen të pamjaftueshme përqindja e deklarimit për efekte tatimore ulët dhe fshehja e të ardhurave rritet. Nëse biznesi nuk është në gjendje të paguajë në kohë detyrimet tatimore përqindja e deklarimit për efekte tatimore ulët dhe fshehja e të ardhurave rritet.

Faktorët e tjerë si: gjërat, besimi në qeveri, statusi ligjor etj kanë rezultuar si të parëndësishëm nga analiza.

Dallimet midis bizneseve me status të ndryshëm dhe midis degëve të ndryshme lidhur me përqindjen e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore nuk janë sinjifikante.

Nga kontrolli i gjithë variablave të marrë në studim nëse ato kishin ndonjë ndikim rezultoi që teknikat e kontrollit dhe numri kontrolleve të kishin ndikim në përqindjen e deklarimit për efekte tatimore.

Me rritjen e numrit të kontrolleve ulët përqindja e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore nga ana e tatimpaguesve, kjo mund të shpjegohet me faktin se mes inspektorëve tatimore dhe bizneseve mund të krijohen marrëdhënie familiariteti. Me përmirësimin e teknikave të kontrollit tatimor, rritet përqindja e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore. Nga tatimpaguesit e anketuar rezulton se përqindja mesatare e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore është 78%.

Me përmirësimin e kushteve të punës të punonjësve, rritet eficientia e administratës tatimore. Me rritjen e një shkalle në vlerësimin e përmirësimit të kushteve të punës të punonjësve eficientia rritet me 0.35 shkallë vlerësimi.

Me rritjen e kulturës së tatimpaguesve rritet eficientia e administratës tatimore. Me rritjen e një shkalle në vlerësimin e kulturës së tatimpaguesve eficientia rritet me 0.45 shkallë vlerësimi.

Me rritjen e burokracisë ulët eficientia e administratës tatimore. Me rritjen e një shkalle në vlerësimin e burokracisë eficientia ulët me 0.23 shkallë vlerësimi.

Faktorët e tjerë (si transparenca kundrejt tatimpaguesve, sistemi informatik, cilësia e kontrollit tatimor dhe objektiviteti) kanë rezultuar të parëndësishëm në analizë.

5.1.1 Konkluzione në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar

Nga opinionet e mbledhura nga pyetësorët rezulton se legjislacioni i TVSH-së të jetë i paqëndrueshëm. Paradhënia e TVSH-së rëndon gjendjen financiare të biznesit. Nga opinionet e tatimpaguesve të anketuar rezulton se shkalla tatimore e TVSH-së konsiderohet e lartë. Procedura e rimbursimit të TVSH-së nuk respekton të drejtat e tatimpaguesit gjë që

sjell probleme me likuiditetin për bizneset. Nga ana tjetër, TVSH-ja e llogaritur mbi bazën e referencave doganore nuk është një mënyrë e drejtë e llogaritjes së TVSH-së. Në rastin e borxhit të keq, tatimpaguesit nuk janë dakord që njohja e TVSH-së nga organet tatimore të bëhet vetëm kur të jetë i shpallur i pambledhshëm nga organet gjyqësore pasi është një procedure e gjatë dhe burokratike që sjell kosto për biznesin. Norma e kreditimit të TVSH-së për naften nuk është e mjaftueshme gjë që është shqetësuese për disa biznese që e shfrytëzojnë këtë input për veprimtarinë e përditshme të biznesit të tyre. Pagesa e TVSH-së në doganë në momentin e importit të mallit nuk është e drejtë (pra, akoma pa e shitur mallin). Me ligjin e TVSH-së për nënkontraktorët rëndohet likuiditeti i biznese nga pagesat e TVSH-së.

Ka vështirësi administrative për shmangien e pagesës së TVSH për lëndën e parë që është e destinuar për përpunim dhe ri-eksport. Ky nuk i referohet rastit klasik të fasonit por importit të lëndës së parë për prodhim me cikël të mbyllur kur klienti është nga një vend i huaj dhe malli i përpunuar do të eksportohet. Nga përpunimi statistikor i të dhënave rezulton që norma tatimore e TVSH-së nuk ndikon në nivelin e deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore të biznesit.

5.1.2 Konkluzione në lidhje me tatimin mbi të ardhurat

Baza ligjore e tatimit mbi të ardhurat është e paqëndrueshme. Norma e aplikuar e tatim mbi të ardhurat konsiderohet e lartë. Sistemi progresiv i tatimit mbi të ardhurat personale në të shumtën e përgjigjeve shikohet si i padrejtë. Pagesa në avancë e tatim fitimit rëndon gjendjen financiare të biznesit. Për të paguar këstin e tatim fitimit biznesi nuk merr kredi në bankë. Shpenzimet që nuk njihet nga organet tatimore për efekt tatim fitimi të tilla si: normat për firot ligjore, normat për shpenzimet e interesit, (për huatë bankare), normat e amortizimit, shpenzimet për aktivet biologjike nuk janë të arsyeshme. Konsiderimi i kësteve të tatim fitimit si borxh ndaj shtetit nuk është e pranueshme pasi në thelb është “parapagim”. Përcaktimi i kësteve të tatim fitimit për bizneset e reja është arbitrare gjë që kushtëzon biznesin që në fillimet e tij. Aplikimi i gjobave për parapagimet e kësteve të tatim fitimit nuk është e drejtë. Tatim i mbajtur në burim për pagesat e qerave prej 15% konsiderohet i lartë (15%). Aplikimi i çmimeve të referencës për qeratë e ndërtesave dëmton mesatarisht biznesin. Tatim i mbajtur në burim për dividendët prej 15% shikohet si i paarsyeshëm.

5.1.3 Konkluzione në lidhje me kontributet

Baza ligjore e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është e qëndrueshme. Norma e kontributeve e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është mesatarisht e arsyeshme. Në situatën e vendit tonë, aplikimi i pagave të referencës nuk është i pranueshëm. Nuk shikohet problematike dhe shqetësuese fakti i ndryshimeve të herëpashershme të pages minimale, ndikimi është i papërfillshëm për biznesin. Detyrimi për të paguar kontributet (për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore) për punonjësit me kohë të pjesshme jo me pak se niveli i pagës minimale (pavarësisht pagës) nuk është i drejtë sepse imponon një pagesë më lartë se është realisht.

5.1.4 Konkluzione në lidhje me kontrollin tatimor

Aftësitë profesionale të inspektorit tatimor nuk janë të mjaftueshme. Interpretimi i ligjit nga inspektorët tatimor nuk është plotësisht i saktë. Inspektorët tatimore bashkëpunojnë me bizneset për të nxjerr detyrimet tatimore në shkëmbim të rryshfetit. Mes inspektorëve tatimore dhe biznesit krijohen marrëdhënie personale. Nuk respektohen me përpikmëri të plotë procedurat e kontrollit tatimor. Strategjia e kontrollit tatimor nuk është e bazuar në risk. Teknikat e përzgjedhura për të realizuar kontrollin pengojnë pjesërisht aktivitetin e përditshëm të biznesit sepse në momentin e realizimit të inventareve apo kryerjen e procedurave të tjera të nevojshme duhet të pezullohet aktiviteti. Dënimet në rast mosrespektimi të legjislacionit janë të larta, kjo theksohet sidomos për muajt e fundit të vitit 2015. Gjobat e vendosura nga kontrolli tatimor janë të larta. Pagesa e detyrimeve të vlerësuara nga kontrolli ose vendosja e garancisë bankare si kusht për fillimin e apelimit nuk është e drejtë. Arsyeja kryesore e kontrollit tatimor nuk është zbulimi i të metave, ndrejtja e tyre për të ardhmen dhe edukimi i tatimpaguesve, në përgjithësi konstatohet se kontrollet tatimore kanë synim të penalizojnë bizneset. Nuk është e qartë në procedurën tatimore rastet e rikontrollit: kur mund të kërkohet nga tatimpaguesi (cilat janë kriteret) dhe si funksionon nga ana administrative.

E rëndësishme për tu theksuar është se ka një përputhshmëri mes opinionëve të tatimpaguesve dhe opinionëve të administratës tatimore në lidhje me paqëndrueshmërinë e bazës ligjore, normat tatimore, procedurën e rimbursimit të TVSH-së, aplikimin e çmimeve të referencës në doganë për llogaritjen e TVSH-së dhe vlerën e penalteteve.

5.1.5 Konkluzione në lidhje me politiken fiskale në përgjithësi

Biznesi ka vështirësi të paguajë në kohë detyrimet tatimore kjo theksohet më shumë për bizneset me përgjegjësi të kufizuar. Niveli i besimit në qeveri për kthyeshmërinë e pagesave të tatimeve dhe taksave në formën e të mirave dhe shërbimeve publike për komunitetin është i ulët. Ecuria e përfitueshmërisë së biznesit vitin e fundit nuk është e kënaqshme. Konkurrenca e pandershme është një problem shqetësues për biznesin. Politika fiskale e vitit të fundit ka ndikuar negativisht në eficiencën e biznesit. Mendimet e mësipërme të administratorëve të bizneseve ose financierëve mund të jenë influencuar edhe nga aksioni i qeverisë i ndërmarrë në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2015.

5.1.6 Konkluzione në lidhje me eficiencën e administratës tatimore

Nga rezultatet e modelit të dytë u arritën këto konkluzione:

Me përmirësimin e kushteve të punës të punonjësve, rritet eficienca e administratës tatimore. Me rritjen e kulturës ndaj tatimpaguesve rritet eficienca e administratës tatimore. Me rritjen e burokracisë ulët eficienca e administratës tatimore.

Faktorët e tjerë të tillë si transparenca kundrejt tatimpaguesve, sistemi informatik, cilësia e kontrollit tatimor dhe objektiviteti kanë rezultuar të parëndësishëm nga analiza statistikore. Administrata tatimore në Shqipëri nuk ka infrastrukturen e nevojshme për të realizuar menaxhimin tatimor dhe sistemi i menaxhimit tatimor është pjesërisht kompleks. Sistemi i mbledhjes së tatimeve nuk është eficient. Mbledhja e vlerave të planifikuara për secilin lloj të tatimeve nuk është lehtësisht e arritshme. Në administratën tatimore ekziston burokracia

gjithashtu, punonjësit tatimor nuk janë të pavarur (nga ndërhyrjet politike apo shoqërore) në realizimin e detyrës së tyre. Në përzgjedhjen e personelit nga administrata tatimore nuk ekziston pavarësia dhe ka ndërhyrje politike. Përzgjedhja e subjekteve për kontroll pjesërisht bëhet në bazë analizës së riskut. Sistemi informatik që përdor administrata tatimore ka ende mangësi. Website i administratës tatimore ka mangësi në plotësimin e nevojave të tatimpaguesve. Aksesit në website-n e administratës tatimore nganjëherë është i pamundur si rezultat i mbingarkesës. Sipas mendimit të punonjësve, kontrolli tatimor konsiderohet shumë i rëndësishëm në realizimin e të ardhurave tatimore të buxhetuara nga qeveria, në uljen evazionin fiskal dhe në zbulimin e parregullsive nga ana e tatimpaguesve. Arsyeja kryesore e kontrollit tatimor është më shumë zbulimi dhe realizimi i të ardhurave sesa ndrejja e gabimeve të realizuara nga tatimpaguesit dhe edukimi i tyre. Inspektori tatimor është nuk është i pajisur me logjistiken e nevojshme për realizimin e kontrollit tatimor. Koha për realizimin e kontrollit nuk është plotësisht e mjaftueshme dhe ka vështirësi në komunikimin me tatimpaguesin gjatë realizimit të kontrollit. Administrata tatimore nuk krijon shumë mundësi trajnimit dhe zhvillimit të punonjësve të saj. Nuk ka përshkrime punë të përcaktuara qartë, kjo është sidomos e rëndësishme për punonjësit e ri për të eliminuar paqartësitë. Administrata tatimore nuk merr në konsideratë pagesën shtesë për orët shtesë të punës të punonjësve. Punonjësit e administratës tatimore nuk ndihen të motivuar për të realizuar maksimalisht kërkesat e punës. Sistemi tatimor stimulon dhënien e rryshfetit administratës tatimore nga ana e tatimpaguesit. Nga të dhënat sasiore arrihet në konkluzion se kontrolli tatimor zë një peshë të vogël në të ardhurat e realizuara nga drejtoria rajonale tatimore e marrë në konsideratë. Numri i Kontrolleve të realizuara është i vogël në krahasim me subjektet për kontroll. Një pjesë të konsiderueshme të zbulimeve të kontrollit e zë “ulja e humbjes”. Tre vitet e fundit të marrë në konsideratë ka rënie të zbulimeve të kontrollit tatimor. Zbulimet kryesore janë të përqendruara tek TVSH-ja.

5.2 REKOMANDIME

Më poshtë paraqiten rekomandimet e studimit.

5.2.1 Rekomandime në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar

Duhet të merren masa që norma e TVSH-së të diferencohet; për ushqimet dhe produktet (shërbimet) të vendoset një normë më e ulët ndërsa për produktet e tjera të vendoset një normë më e lartë.

Duhet të rishikohet skema e parapagimit të TVSH-së pasi kjo rëndon tatimpaguesit; do të krijonte më frymarrje për bizneset në qoftë se pagesa e TVSH-së do të bëhej pas shitjes së mallrave.

Me gjithë përmirësimet e fundit në procedurën e rimbursimit të TVSH-së, akoma ka vonesa dhe procedura burokratike që nuk janë eliminuar duke krijuar vështirësi tek biznesi dhe për këtë duhet të rishikohet edhe një herë kohëzgjatja e procedurave të rimbursimit.

Në rastin e borxhit të keq, procedura e njohjes së TVSH-së nga organet tatimore duhet të realizohet në mënyrë më të shpejtë dhe të kufizohet procedura vetëm tek administrata tatimore.

5.2.2 Rekomandime në lidhje me tatimin mbi të ardhurat

Duhet të merren masa që legjislacioni tatimor të jetë më i qëndrueshëm pasi kjo krijon pasiguri tek biznesi dhe kufizim të iniciativës për zgjerime të mëtejshme të investimeve.

Duhet të rishikohen normat për firot ligjore, shpenzimet e interesit, normat e amortizimit dhe shpenzimet për aktivet biologjike pasi ato konsiderohen mjaft të ulëta dhe të krijohet fleksibilitet në raste të caktuara pasi biznesi realisht mund të ketë situata specifike që administrata tatimore për mungesë të bazës ligjore mund të mos i njohë shumën të konsiderueshme shpenzimesh si shpenzime të zbritshme.

Politika fiskale duhet të ofrojë lehtësira për bizneset që fillojnë aktivitetin për herë të parë në përcaktimin e kësteve të tatim fitimit në mënyrë që ato të mos jenë arbitrare.

Duhet të shikohet mundësia e aplikimit të një norme tatim fitimi e diferencuar për industri të caktuara në funksion të prioritetëve që qeveria mund të ketë. Në bazë të rezultateve të analizës së regresionit, u arrit në përfundim se një normë e ulët e tatimit mbi të ardhurat dekurajon sjelljen ligjore të tatimpaguesit dhe zgjidhja më mirë do ishte optimizimi i kësaj norme në një nivel të pranueshëm.

5.2.3 Rekomandime në lidhje me kontributet

Duhet të rishikohen pagat e referencës për profesionet e lira sepse ato krijojnë vështirësi për bizneset. Shumë biznese që nuk punojnë i vendosin në të njëjtin pozicion si ato që punojnë.

5.2.4 Rekomandime në lidhje me kontrollin tatimor

Administrata tatimore duhet ti krijojë mundësi inspektorëve të kontrollit tatimor të trajnohen në lidhje me zbatimin e legjislacionit tatimor dhe për raste specifike të problematikave që mund t'i shfaqen në punën e tyre të ekzistojë një zyrë funksionale ku mund të marrin përgjigje të shpejtë. Nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të merren eksperiencë edhe nga praktika të suksesshme të vendeve të tjera.

Të krijohen mënyra komunikimi me tatimpaguesit sa më formale në mënyrë që të shmangen marrëdhënien personale që mund të krijohen mes tatimpaguesve dhe inspektorëve të kontrollit.

Administrata tatimore duhet të krijojë një strategji përzgjedhje të subjekteve për kontroll bazuar në risk dhe kjo të bëhet transparente tek tatimpaguesit në mënyrë që vetë tatimpaguesit të ndërgjegjësohen.

Motivi kryesor i kontrollit tatimor duhet të jetë zbulimi i të metave, ndreqja e tyre dhe edukimi i tatimpaguesve. Kontrollët duhen të jenë të shpeshta me qëllim orientimin e zbatueshmërisë së ligjit në mënyrë të drejtë dhe transparente. Inspektorët tatimor nuk duhen të bëhen palë me subjektin në gjetjen e mënyrës për evazion përkundrejt rrushfetit apo punësimit të ndonjë të afërmi.

Meqë në procedurën tatimore nuk është e qartë rasti i rikontrollit kur kërkohet nga tatimpaguesi (kushtet) dhe si funksionon nga ana administrative, duhet të merren masa që të saktësohet situata.

Administrata tatimore nuk duhet të vendos stimuj për inspektorët tatimor të tillë si: vlera e gjobave të vendosura apo vlera e detyrimeve të vendosura. Aplikimi i këtyre “stimujve” orienton në mënyrë të gabuar inspektorët. Një mënyrë për vlerësimin e punës së

inspektorëve tatimor do të ishte realizimi i herëpashershëm i sondazheve drejtuar tatimpaguesve në lidhje me përmirësimet e mundshme mes dy palëve.

Administrata tatimore duhet të mundësojë përmbushjen me përpikmëri të procedurave të kontrollit duke ofruar mjetet e nevojshme për inspektorët tatimor duke filluar nga koha që ato kanë në dispozicion për të realizuar kontrollet dhe mjetet e domosdoshme për realizimin e kontrollit.

Duke qenë se numri i kontrolleve të realizuara është i vogël në krahasim me subjektet për kontroll, duhet të rritet numri i inspektorëve tatimor në propocion me rritjen e numrit të bizneseve.

5.2.5 Rekomandime në lidhje me përmirësimin e efijencës së administratës tatimore

Studimi si nga pikëpamja sasiore dhe cilësore ka theksuar një efijencë të ultë të administratës tatimore. Duhet të merren masa që të ulët burokracia, të krijohet një sistem rekrutimi i punonjësve bazuar në meritë pa ndërhyrje politike.

Pavarësisht investimeve dhe përmirësimeve në infrastrukturën teknologjike sërish ka mangësi në këtë drejtim. Infrastruktura me të cilën punojnë punonjësit është e vjetëruar. Website i administratës tatimore është i varfër, duhet të ketë publikime çdo muaj që të informohen palët e interesuara në lidhje me ecurinë e arkëtimit por njëkohësisht evidentimin e problematikave. Me rëndësi është të publikohet edhe raporti vjetor i administratës tatimore. Gjithashtu, duhet që tek ligjet e publikuara të evidentohen shumë shpejt ndryshimet e miratuara.

Administrata tatimore duhet të organizojë në mënyrë të herëpashershme trajnime me fokus punonjësit në drejtim të përmirësimit të tyre në vendin e punës.

Duhet të rishikohen mënyrat e shpërblimit të punonjësve pasi është një arsye motivimi shtesë për punonjësit.

5.2.6 Rekomandime për studime të mëtejshme

Së pari, studimi fokusohet vetëm në qytetet e Durrësit dhe Shkodrës për mbledhjen e opinionioneve të tatimpaguesve lidhur me problematikën aktuale të politikës fiskale në Shqipëri. Studimet e mëtejshme mund të zgjerojnë numrin e qyteteve të përfshirë në analizë për të siguruar një panoramë të përgjithshme.

Së dyti, punimi merr në konsideratë një drejtor rajonale tatimore për të pasqyruar opinionet e punonjësve lidhur me politiken fiskale dhe për të evidentuar faktorët kryesor që ndikojnë efijencën e administratës tatimore. Studimet e mëtejshme mund të zgjerojnë numrin e drejtorive rajonale tatimore të marrë në konsideratë.

Së treti, punimi analizon për një periudhë pesë vjeçare rezultatet e kontrollit tatimor të një drejtorie rajonale tatimore. Kërkimet e mëtejshme mund të fokusohen edhe në drejtoritë tjera.

Së katërti, në analizen e faktorëve ndikues të deklarimit të të ardhurave për efekte tatimore dhe të efijencës së administratës tatimore mund të përfshihen edhe faktorë të tjerë makroekonomik.

BIBLIOGRAFIA

1. A world Bank Group Flagship Report, **Economy Profile Albania**, *Doing Business*, 2016, 13th edition: 68
2. Abdixhiku, L.: **Determinats of business tax evasion in transition economies**. Phd Disertacion. Staffordshire University Business School, Angli, 2013
3. AICPA, (2007) **Guiding principles for tax equity and fairness**, 12
4. Allingham, M., and Sandmo, A., (1972): **Income tax evasion: a theoretical analysis**. *Journal of Public Economics*, Vol (1): 323-338.
5. Alm, J., McClelland, H., and Schulze, W., (1992): **Why do people pay taxes?** *Journal of Public Economic*, Vol. (48): 21-28.
6. Ameer F., Tkouat M., (2012): **Taxpayers Fraudulent Behavior Modeling the Use of Datamining in Fiscal Fraud Detecting**, marrë nga <http://www.scirp.org/journal/>
7. Baldry, J.C., (1987): **Income tax evasion and the tax schedule: Some experimental results**. *Public Finance*, Vol. 42(3): 357-383.
8. Barthelemy, P., (1989): **The underground economy in France**. In: Feige, E. (Ed.), *The Underground Economies: Tax Evasion and Information Distortion*; Cambridge University Press, New York: 281–294.
9. Berman, J., (2013): **Utility of a conceptual framework within doctoral study: A researcher's reflections**. *Issues in Educational Research*, Vol 23(1): 1-18
10. Bhattacharjee, A., (2012): Social Science Research: **Principles, Methods, and Practices**: Creative Commons Attribution-NonCommercial-Share Alike 3.0 Unported License, 6-12
11. Brojba L., Dumitru C., Belciug A., (2010) **On the use of some optimal strategies of fiscal administration during economic crisis**, *Romanian Journal of Economic Forecasting*-1(2010): 151-163.
12. Cargill, M., O'Connor, P., (2009): *Writing Scientific Research Articles: Strategy and Steps*: Wiley-Blackwell, 35
13. Carroll, R., (1998): **Do Taxpayers really respond to changes in tax rates? evidence from the 1993 tax act**. *U.S. Department of the Treasury, Office of Tax Analysis*, working Paper 78.
14. Charles W. B., John B. C., Kelly D. M., K. Praveen P., (2010): **national culture and firm – level tax evasion**. *Journal of Business Research* 66 (2013): 390-396.
15. Chiarini, B., Marzano, E. and Schneider, F., (2008): **tax rates and tax evasion: an empirical analysis of the structural aspects and long-run characteristics in Italy**, *IZA Discussion Paper*, No. 3447.
16. Clotfelter, C., (1983): **Tax evasion and tax rates: an analysis of individual returns**. *Review of Economics and Statistics*, Vol. 65(3): 363-73.
17. Crandall, W., (2010): **Revenue Administration: Performance Measurement in Tax Administration, Technical Notes and Manuals**, Fiscal Affairs Department, International Monetary Fund: 1-6
18. Çule, M., and Fulton, M., (2007): **Business Culture and Tax Evasion: Why Corruption and the Unofficial Economy can Persist**. *Journal of Economic Behavior & Organization*, (2009), Vol (72): 811-822.
19. Despa. S., 2012, Quantile Regression nga <https://www.cscu.cornell.edu/news/statnews/stnews70.pdf>

20. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, (2011): **Manuali i kontrollit tatimor.**
21. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, (2014): **Plani Strategjik.**
22. Engida, T., and Baisa, G., (2014): **factors influencing taxpayers' compliance with the tax system: an empirical study in mekelle city, Ethiopia.** *eJournal of Tax Research*, Vol 12 (2): 433-452.
23. Esposito Vinzi, V., Trinchera, L. and Amato, S., (2010): **PLS path modeling: from foundations to recent developments and open issues for model assessment and improvement.** In *Esposito Vinzi, V., Chin, W., Henseler, J. and Wang, H. (Eds.), Handbook of partial least squares: concepts, methods and applications*: Springer-Verlag, Berlin: 47–82.
24. European Bank for Reconstruction and Development (EBRD) and the World Bank Group (the World Bank), (2015), **Business Environment and Enterprise Performance Survey (BEEPS) V Country Profile.** 3-14.
Faculty of Economics, Vol (2): 375-380
25. Falsetta, D., Schafer, J. K., and Tsakumis, G. T. (2010): **Tax evasion: audit probability and themoderating role of goal conflict.** Working Paper. Retrieved on July 2013
26. Feige, E., (1989): **The meaning and measurement of underground economy.** In: *Feige, E. (Ed.), The Underground Economies: Tax Evasion and Information Distortion*; Cambridge University Press, New York, 13–57.
27. Feige, E., (1990): **Defining and estimating underground and informal economies: the new institutional economics approach.** *World Development* 18, 989–1002.
28. Feige, E., (1994): **The underground economy and the currency enigma.** *Public Finance* 49: 119–136.
29. Feige, E., (1996): **Overseas holding of U.S. currency and the underground economy.** In: *Pozo, S. (Ed.), Exploring the Underground Economy: Studies of Illegal and Unreported Activity*: W.E. Upjohn Institute for Employment Research, Kalamazoo, MI: 5–62.
30. Feinstein, J. S. (1991): **An Econometric Analysis of Income Tax Evasion and its Detection,** *Rand Journal of Economics*, Vol. 22(1), 14-35.
31. Feldstein, M., (1976): **On the theory of tax reform.** *Journal of Public Economics*, Vol (6): 77-104
32. Fisman, R. and Wei, S., (2004): **Tax rates and tax evasion: evidence from ‘missing imports’ in china.** *Journal of Political Economy*, Vol. 112(2): 471-496.
33. Fjeldstad, O. H., and Semboja, J., (2001): **Why people pay taxes: the case of the development levy in Tanzania.** *World Development*, Vol. 29 (12): 2059-2074.
34. Forumi Kombëtar i Biznesit, (2014): **Problematika të Kontrollit Tatimor tek Bizneset Private në Shqipëri,** Qershor, 2014: 29.
35. Frey, Bruno S. and Werner P., (1984): **The hidden economy: state and prospect for measurement.** *Rev. Income Wealth*, Vol (30): 1-23.
36. Friedland, N., Shlomo M. and Aryeh R., (1978): **A simulation study of income tax evasion.** *Journal of Public Economics*, Vol. 10(1): 107-116.
37. Gorodnichenko, Y., Martinez-Vazquez, J. and Sabirianova Peter K., (2009): **Myth and Reality of flat tax reform: micro estimates of tax evasion response and welfare effects in Russia.** *Journal of Political Economy*, Vol. 117(3), 504-554.
38. Greene, H. William: **The classical multiple linear regression model.** In *Econometric*

- Analysis 5th edition*; Prentice Hall: 2002: 16-17
39. Groebner, D., Shannon, P., Fry, P., Smith, K., (2011): **Business Statistics. A decision making-approach**, Pearson 2011, 634
 40. Hofstede, G. H., & Bond, M. H., (1988): **The Confucius connection: From cultural roots to economic growth**. *Organizational Dynamics*, 1988, Vol (16): 5–21.
 41. Hofstede, G. H., (1980): **Cultures consequences: international differences in work-related values**. In: *Beverly Hills*. CA: Sage Publications.
 42. Hofstede, G. H., (1983): **Dimensions of national cultures in fifty countries and three regions**. In: J. B. Deregowski, S. Dziurawice, & R. C. Annis (Eds.), *Expiscations. in cross-cultural psychology*; Lisse, The Netherlands: Swets and Zeitlinger: 335–355.
 43. Hofstede, G. H., (2001): **Cultures consequences: comparing values, behaviors, institutions and organizations across nations** (2nd ed.). London: Sage Publications.
 44. Hoppe, M. H. (1990): **A comparative study of country elites: International differences in work-related values and learning and their implications for management training and development**. Unpublished doctoral dissertation. University of North Carolina at Chapel Hill.
 45. Husted, B. W., (1999): **Wealth, culture, and corruption**. *Journal of International Business Studies*, Vol (30): 339–359.
 46. INSTAT
 47. International Bureau of Fiscal Documentation. (2001).
 48. International tax glossary (4th ed.). Amsterdam, Netherlands: IBFD Publications.
 49. Ioan, P., (2015): **Tax control - prevention and control of tax evasion**, *Annals of*
 50. Jain, T., Khanna, O., Grover., Jain, D.,: **Taxation System**. In: *Macroeconomics, Money, Banking and Public Finance*; V.K publications; 2007: 398-401.
 51. Kothari, C.R., (2004): **Research methodology, new age international publishers**, 2
 52. Langfeldt, E., (1989): **The underground economy in the Federal Republic of Germany: a preliminary assessment**. In: Feige, E. (Ed.), *The Underground Economies: Tax Evasion and Information Distortion*; Cambridge University Press, New York: 197–217.
 53. Ledbetter, M., (2004a). **Comparison of BEA estimates of personal income and IRS estimates of adjusted gross income: new estimates for 2001; revised estimates for 1959–2000**. *Survey of Current Business* 84: 8–23.
 54. **Ligj Nr.10383, datë 24.2.2011**, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
 55. **Ligj Nr.8438, datë 28.12.1998**, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar
 56. **Ligj Nr.92/2014 datë 24.7.2014**, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar
 57. **Ligj Nr.9920 datë 19.05.2008**, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
 58. Long, S., & Swingen, J., (1991): **Taxpayer compliance: Setting new agendas for research**. *Law and Society Review*, vol (25): 637–683.
 59. Lubell, H., (1991): **The Informal Sector in the 1980's and 1990's Paris: OECD** Smith, Philip. 1994. "Assessing the Size of the Underground Economy: The Canadian Statitcal Perspectives," *Canadian Econ. Observer*, Cat. No. 11-010, 3,16-33
 60. Mason, R. and Calvin, L. (1978): **A study of admitted income tax evasion**. *Law and Society Review*, Vol. (12): 73–89.

61. Minh Le, T., (2003): **Value added taxation: mechanism, design, and policy issues**, *World Bank course on Practical Issues of Tax Policy in Developing Countries*, 2003: 2
62. Ministria e Financave, Treguesit Fiskal sipas Buxhetit të Konsoliduar
63. Molefsky, B., (1982): **America's underground economy**. In: Tanzi, V. (Ed.), *The Underground Economy in the United States and Abroad*; Lexington Books, Lexington, MA, 47–68.
64. Myslimi, O., 2013: **Metodat e Ekonometrisë me Eviews**: Maluka: 2013
65. O'Higgins, M., (1989): **Assessing the underground economy in the United Kingdom** In: Feige, E. (Ed.), *The Underground Economies: Tax Evasion and Information Distortion*; Cambridge University Press, New York: 175–195.
66. Palil, M., Hamid, M., and Hanafiah, M., (2013): **Taxpayers Compliance Behaviour: Economic Factors Approach**. *Jurnal Pengurusan*, 2013, Vol (38): 75-85
67. Pommerehne, W. and Weck-Hannemann, H., (1996): **Tax rates, tax administration and income tax evasion in Switzerland**. *Public Choice*, Vol (88): 161-170.
68. Pommerehne, W. W. and Frey, B. S., (1992): **The effects of tax administration on tax morale**, Unpublished Manuscript, University of Zurich.
69. Pommerehne, W. W. and Frey, B. S., (1992): **The effects of tax administration on tax morale**, Unpublished Manuscript, University of Zurich.
70. Richardson, G., (2008): **The Relationship between culture and tax evasion across countries: Additional evidence extension**. *Journal of International Accounting and Taxation*, (2008), Vol (17): 67-78.
71. Rosen., H.,: **Të tatuarit në mënyrë eficiente dhe të barabartë**. In *Financa Publike*; Shypshkronja albin; Botimi 6- të, 2003: 386-387
72. Rosser, J., Rosser, M and Amhed., E., (2003): **Multiple unofficial economy equilibria and income distribution dynamics in dystemic transition**. *Journal of Post Keynesian Economics*, Spring 2003, Vol (25), no. 3: 425-447
73. Rowley, J., (2002): **Using Case Study in Research**, *Management Research News*, Vol (25), 2002: 18
74. Rrumbullaku, O.,: **Hyrje në sistemin fiskal dhe parimet dhe karakteristikat e sistemit tatimor**. In *Taksimi, leksione të përditësuara për sistemin tatimor shqiptar*; Shtypshkronja “Urtësia Bektashiane”, 2015: 1-47
75. Sandford, C., (2000): **Why tax systems differ: A comparative study of the political economy of taxation**. Bath, The United Kingdom: Fiscal Publications.
76. Schneider, F., & Enste, D., (2000): **Shadow economies around the World: Size, causes and consequences**. IMF Working Paper WP/00/26, 1–56.
77. Schneider, F., (2015): **Size and development of the shadow economy of 31 European and 5 other OECD Countries from 2003 to 2015: Different Developments**. Johannes Kepler University Linz, Department of economics
78. Sekretariati i Këshillit të Investimeve: Dokument pune – **Propozime për përmirësimin e procesit të kontrollit tatimor: Një analizë në kuadër të përmirësimit të klimës së biznesit në Shqipëri**, Shtator 2015: 8 – 11.
79. Shagari, Sh., (2014): **Determinants of tax administration efficiency: a study of Bauchi State, NIGERIA**, University Utara Malaysia.

80. Shneider, F., (1994): **Measuring the size and development of the shadow economy: can the causes be found and the obstacles be overcome?** In Hermann Brandstaetter and Werner Guth, eds. *Essays on Economic Psychology*, Berlin: Springer: 193-212.
81. Sillamaa, M. and Veall, M.R., (2000): **The effect of marginal tax rates on taxable income: A panel study of the 1988 tax flattening in Canada**, Research Institute for Quantitative Studies in Economics and Population Research Reports, McMaster University, Hamilton, Ontario, Canada, No 354, 2000.
82. Slemrod, J., (2003): **Trust in public finance**. In S. Cossens & H. W. Sinn (Eds.), *Public finance in the new century*, Cambridge, MA: MIT Press, 2003: 49–88.
83. Spicer, M. W. and Hero R. E., (1985): **Tax Evasion and Heuristics**. *Journal of Public Economics*, Vol (26): 263-267.
84. Surrey, S. S., & McDaniel, P. R., (1985): **Tax expenditures**. Cambridge, MA: Harvard University Press.
85. Tanzi, V., (1999): **The underground economy in the United States: annual estimates, 1930–1980**. In: Fiorentini, G., Zamagni, S. (Eds.), *In: The Economics of Corruption and Illegal Markets*; Edward Elgar, Northampton, MA, vol (3): 88–110.
86. The Intra-European Organisation of Tax Administrations: <https://www.iota-tax.org/>
87. World Bank, (2015): **Next generation albania, a systematic country diagnostic**, 12-75.
88. Yin, R.K., (1994): **Case study research: design and methods**, 2nd edition. Thousand Oaks: Sage, 13.

Webgrafia

<http://www.tatime.gov.al>
<http://www.financa.gov.al>
<https://www.iota-tax.org>
<http://www.imf.org>
<http://www.worldbank.org>
<http://www.instat.gov.al>
<https://www.bankofalbania.org/>

APENDIKSI I. NORMAT TATIMORE DHE TË ARDHURAT NDËR VITE




Figura 1.1 Norma e Tatimit Fitimit ndër Vite

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve




Figura 1.2 Norma e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar ndër Vite

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve




Figura 1.3 Norma e Tatimit mbi Të Ardhurat Personale ndër Vite

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve




Figura 1.4 Norma e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore ndër Vite

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve




Figura 1.5 Norma e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për Punëdhënësin ndër Vite

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve




Figura 1.6 Norma e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për Punëmarrësin ndër Vite

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Tabela 1.1 Të ardhurat e grumbulluar gjatë viteve 1993-2014

Të Ardhurat e Grumbulluara 1993-2014																						
Vitet	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
I. Të ardhura tatimore	23.4	36	39.7	42.8	45.6	72.6	83.6	104.1	114.3	128.9	145.4	166.0	183.8	205.5	228.2	264.4	270.8	288.6	303.9	300.9	299.9	335.87
II.1 Nga Tatimet dhe Doganat	18.9	28.2	28.7	28	32.3	55.1	63.3	81.1	87.8	98.1	108.8	123.1	135.6	155.1	176.8	205.3	208.9	223.0	235.5	232.6	229	253.9
1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	5.0	5.0	5.6	9.1	15.7	28.8	29.8	38.1	41.1	46.1	50.6	58.2	64.5	74.3	87.8	107.1	110.1	114.0	119.2	116.5	111.9	123.7
2. Tatimi mbi Fitimin	4.0	2.7	2.5	3.4	2.4	4.3	6.0	8.1	10.2	12.2	13.1	16.3	19.2	22.3	21.1	18.1	17.1	17.6	19.7	16.9	15.1	21.5
3. Akcizat	4.3	9.5	10.4	4.9	2.2	4.9	7.0	9.2	9.5	9.3	12.3	15.8	18.5	23.0	28.7	32.5	33.5	38.8	40.4	36.4	38.2	40.9
4. Tatimi mbi Të Ardhurat Personale	0.1	0.6	0.6	0.6	0.8	1.2	3.1	4.6	6.3	6.1	6.4	6.9	7.4	8.6	14.8	24.5	26.8	27.1	28.0	28.0	29.6	28.9
5. Taksa Nacionale dhe të Tjera	1.9	4.2	3.4	2.3	2.3	3.3	6.0	7.6	7.7	10.9	12.5	12.1	12.3	13.0	14.5	14.4	13.4	18.3	21.4	28.7	28.5	32.6
6. Taksa Doganora	3.6	6.3	6.2	7.7	9.0	12.6	11.4	13.5	12.8	13.4	13.9	13.9	13.6	14.0	9.8	8.7	7.9	7.3	6.9	6.1	5.8	5.9
II.2 Të Ardhura nga Pushteti Lokal	0.7	1.4	1.7	2.1	1.0	1.6	2.1	3.0	4.0	5.2	7.9	9.6	12.0	11.1	9.4	11.3	12.1	11.9	11.8	10.9	10.8	12.4
1. Taksa Lokale	0.1	0.5	0.8	1.4	0.6	0.7	0.9	1.3	2.0	2.7	5.0	5.6	8.2	8.5	7.1	7.1	8.2	7.7	7.3	6.2	2.5	7.1
2. Tatimi mbi Pasurinë (ndërtesat)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.6	1.5	1.9	1.9	2.5	2.0	3.7
3. Tatimi mbi Biznesin e Vogël	0.6	0.8	0.9	0.8	0.4	0.9	1.2	1.6	2.0	2.5	2.9	4.1	3.8	2.6	2.2	2.6	2.5	2.3	2.6	2.1	6.0	1.7
III.3 Të Ardhura nga Fondet Speciale	3.9	6.4	9.2	12.7	12.2	15.8	18.2	20.1	22.5	25.6	28.7	33.3	36.2	39.3	42.0	47.8	49.8	53.6	56.6	57.4	60.0	70.0
1. Sigurimi Shoqëror	3.9	6.4	8.6	11.6	11.3	14.6	16.8	18.5	20.7	23.5	26.1	30.4	33.1	35.7	37.6	42.5	44.3	45	48.8	49.5	51.1	61.49
2. Sigurimi Shëndetësor	0.0	0.0	0.6	1.0	0.9	1.3	1.4	1.5	1.8	2.1	2.6	2.9	3.1	3.6	4.4	5.3	5.5	6.4	6.2	6.6	7.4	8.19
3. Të ardhurat për kompensim në vlerë të pronarëve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.2	1.6	1.3	1.6	0.32

Burimi: Ministria e Financave

APENDIKSI II. PYETËSORI DREJTUAR TATIMPAGUESVE DHE PUNONJËSVE

PYETËSOR DREJTUAR TATIMPAGUESVE

Qëllimi i këtij pyetësoni është të evidentojë problematikat e politikës fiskale dhe faktorët ndikues në performancën e administratës tatimore në Shqipëri. Rezultatet e përpunuara të pyetësorëve të grumbulluar shërbejnë për të nxjerrur konkluzione dhe rekomandime në kuadër të një punimi doktore pranë Fakultetit të Biznesit, specializimi Financë-Bankë, Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”. Do ju jemi shumë mirënjohës për bashkëpunimin tuaj në plotësimin e këtij pyetësoni. Ju sigurojmë që ky pyetësor do të mbesin anonim, pra emri dhe mbiemri i kompanisë tuaj asnjëherë nuk do të bëhen publik ndaj asnjë pale. Pyetësoni i drejtohet _____ bizneseve në qytetin e Durrësit dhe të Shkodres.

Faleminderit paraprakisht!

Nevila Kiri, MK
Fakulteti Ekonomik
Universiteti i Shkodres “Luigj Gurakuqi”
Adresa email-it: kiri.nevila@gmail.com

SEKSIONI A: Informacion i Përgjithshëm në Lidhje me Biznesin

Pyetja 1: Emri i biznesit _____ (opsionale)

Pyetja 2: Si klasifikohet biznesi juaj sipas pronësisë?

- a. i huaj
- b. shqiptare
- c. joint venture (e përbashkët)

Pyetja 3: Si klasifikohet biznesi juaj sipas xhiros vjetore?

- a. deri në 2 milion lekë
- b. 2 milion deri në 8 milion lekë
- c. 8 milion deri në 180 milion lekë
- d. 180 milion lekë e sipër

Pyetja 4: Si klasifikohet biznesi juaj sipas numrit të punonjësve?

- a. Deri në 5 punonjës
- b. 6-20 punonjës
- c. 21-80 punonjës
- d. Mbi 80 punonjës

Pyetja 5: Cili është statusi ligjor i biznesit?

- a. Tregtar i regjistruar (TR)
- b. Shoqëri kolektive (SHK)
- c. Shoqëri komandite (SHKM)
- d. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK)
- e. Shoqëri aksionere (SHA)

Pyetja 6: Cili është viti i krijimit të biznesit? _____

Pyetja 7: Cili është pozicioni juaj në biznes?

- a. kontabilist/financier
- b. administrator
- c. ekspert kontabël
- d. konsulent fiskal

Pyetja 8: Cili është sektori ku operon biznesi?

- | | |
|--|---|
| a. Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura | g. Aktivitete financiare |
| b. Peshkimi | h. Pasuritë e patundshme; dhënia me qira dhe shërbime për ndërmarrjet |
| c. Industria nxjerrëse | k. Administrim publik |
| d. Industria përpunuese | l. Arsimi |
| e. Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit dhe e ujit | m. Shëndeti dhe veprimtaritë sociale |
| f. Ndërtimi | n. Shërbime kolektive, sociale dhe personale |
| g. Tregëtia, riparimi i automobilitave dhe artikujve shtëpiake | o. Shërbime shtëpiake |
| h. Hotelet dhe restorantet | p. Aktivitete të organizmave ndërkombëtare |
| i. Transporti dhe telekomunikacioni | k. Tregtim naftë |
| | l. Prodhim me material të porositësit (fason) |

SEKSIONI B: Problematikat në lidhje me politikën fiskale të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në Shqipëri

Pyetja 9: Duke gjykuar në lidhje me politiken fiskale të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në Shqipëri, ju lutem jepni opinionin tuaj në lidhje me pohimet e mëposhtme:

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Baza ligjore e TVSH-së është e qëndrueshme.						
2. Paradhënia e TVSH-së rëndon gjendjen financiare të biznesit tuaj.						
3. Shkalla tatimore e TVSH-së është e lartë.						
4. Procedura e Rimbursimit të TVSH-së respekton të drejtat e tatimpaguesit.						

5. TVSH e llogaritur mbi bazën e referencave doganore është e drejtë.						
6. Në rastin e borxhit të keq, njohja e TVSH-së nga organet tatimore vetëm kur është shpallur si i pambledhshëm nga organet gjyqësore është e drejtë.						
7. Norma e kreditimit të TVSH-së për naftën është e mjaftueshme.						
8. Vendosja e një norme tatimore të ndryshme për kategori të ndryshme produktesh dhe shërbimesh është më e pranueshme (p.sh për shqimet 5%, për mallrat e luksit 30 % etj).						
9. Pagesa e TVSH-së në doganë në momentin e importit të mallit është e drejtë (pra, akoma pa e shitur mallin).						
10. Përrjashtimi nga TVSH-ja i makinerive dhe pajisjeve që importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve dhe importimi kryhet nga vetë tatimpaguesit, pa nënkontraktim, me vlerë mbi 50,000,000 (pesëdhjetë milionë) është e drejtë.						

SEKSIONI C: Problematikat në lidhje me politikën fiskale të **Tatimit mbi Të Ardhurat** në Shqipëri

Pyetja 10: Duke gjykuar në lidhje me politiken fiskale të Tatimit mbi të Ardhurat në Shqipëri, ju lutem jepni opinion tuaj në lidhje me pohimet e mëposhtme:

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Baza ligjore e Tatimit mbi Të Ardhurat është e qëndrueshme.						
2. Norma e aplikuar e Tatim Fitimit për biznesin tuaj është e lartë.						
3. Norma e Tatim Fitimit duhet të jetë e diferencuar bazuar në industri të ndryshme ku bën pjesë biznesi.						

4. Norma e aplikuar e Tatimit mbi të Ardhurat Personale është lartë.						
5. Sistemi progresiv i Tatimit të të Ardhurave Personale është i drejtë.						
6. Pagesa në avancë e Tatim Fitimit rëndon gjendjen financiare të biznesit.						
7. Për të paguar këstin e Tatim Fitimit biznesi merr kredi në bankë.						
8. Një pjesë e shpenzimeve nuk njihen për efekte tatimore. Shpenzimet që nuk njihet nga organet tatimore për efekt Tatim Fitimi të tilla si: a. normat për firot ligjore, janë të arsyeshme.						
b. normat për shpenzimet e interesit, (për huatë bankare) janë të arsyeshme.						
c. normat e amortizimit, janë të arsyeshme.						
d. shpenzimet për aktivet biologjike, janë të arsyeshme.						
9. Konsiderimi i kësteve të Tatim Fitimit si borxh ndaj shtetit është e pranueshme.						
10. Përcaktimi i kësteve të Tatim Fitimit për Bizneset e reja është arbitrare.						
11. Aplikimi i gjobave për parapagimet e kësteve të Tatim Fitimit është e drejtë (megjithëse akoma nuk ka hyrë në fuqi).						
12. Tatim i mbajtur në burim për pagesat e qerave është i pranueshëm (15%).						
13. Aplikimi i çmimeve të referencës për qeratë e ndërtesave dëmton biznesin.						
14. Tatim i mbajtur në burim për dividendët është i arsyeshëm (15%).						

SEKSIONI D: Problematikat në lidhje me normat e **Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore** (që paguajnë bizneset në Shqipëri)

Pyetja 11: Duke gjykuar në lidhje me normat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Shqipëri, ju lutem jepni opinion tuaj në lidhje me pohimet e mëposhtme:

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Baza ligjore e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore është e qëndrueshme.						
2. Norma e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore është e arsyeshme.						
3. Norma e kontributeve të Sigurimeve Shëndetësore është e arsyeshme.						
4. Në situatën e vendit tonë, aplikimi i pagave të referencës është i pranueshëm.						
5. Ndryshimet e herëpashershme në pagën minimale kanë ndikim të konsiderueshëm.						
6. Detyrimi për të paguar kontributet (për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore) për punonjësit më kohë të pjesshme jo me pak se niveli i pagës minimale (pavarësisht pagës) është i drejtë.						

SEKSIONI E: Problematikat në lidhje me **Kontrollin Tatimor** në Shqipëri

Pyetja 12: Mesatarisht, sa kontrolle tatimore keni në vit?

- a. asnjë
- b. 1
- c. 2
- d. 3
- e. __ (specifikojini numrin e saktë)

Pyetja 13: Cili prej tipeve të kontrollit është më i shpeshtë gjatë një viti?

- a. Kontroll i plotë
- b. Vizitë fiskale
- c. Verifikim në vend

Pyetja 14: Duke gjykuar në lidhje me kontrollet tatimore për 5 vitet e fundit, ju lutem jepni opinionin tuaj në lidhje me pohimet e mëposhtme:

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Aftësitë profesionale të inspektorit tatimor janë të mjaftueshme.						
2. Interpretimi i ligjit nga inspektorët tatimor është i saktë.						
3. Inspektorët tatimore bashkëpunojnë me bizneset për të nxjerr detyrimet tatimore në shkëmbim të rryshfetit.						
4. Mes inspektorëve tatimore dhe biznesit krijohen marrëdhënie personale.						
5. Respektohen me përpikmëri procedurat e kontrollit tatimor.						
6. Strategjia e kontrollit tatimor është e bazuar në risk.						
7. Teknikat e përzgjedhura për të realizuar kontrollin nuk pengojnë aktivitetin e përditshëm të biznesit.						
8. Dënimet në rast mosrespektimi të legjislacionit janë të larta.						
9. Gjjobat e vendosura nga kontrolli tatimor janë të larta.						
10. Pagesa e detyrimeve të vlerësuara nga kontrolli ose vendosja e garancisë bankare si kusht për fillimin e apelimit është e drejtë.						
11. Arsyeja kryesore e kontrollit tatimor është zbulimi i të metave, ndreqja e tyre për të ardhmen dhe edukimi i tatimpaguesve.						
12. Kontrollet tatimore kanë synim të penalizojnë bizneset.						

SEKSIONI E: Problematikat të Përgjithshme të **Politikës Fiskale** në Shqipëri

Pyetja 15: Duke gjykuar në lidhje me politiken fiskale në Shqipëri, ju lutem jepni mendimin tuaj deri në çfarë shkalle jani dakord apo jo me në lidhje me pohimet e mëposhtme:

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Biznesi është në gjendje të paguajë në kohë detyrimet tatimore.						
2. Politika fiskale në Shqipëri është e drejtë.						
3. Niveli i besimit në qeveri për kthyeshmërinë e pagesave të tatimeve dhe taksave në formën e të mirave dhe shërbimeve publike për komunitetin është i ulët.						
4. Ecuria e përfitueshmërisë së biznesit vitin e fundit është e kënaqshme.						
5. Konkurrenca e pandershme është një problem shqetësues për biznesin.						
6. Politika fiskale e vitit të fundit ka ndikuar negativisht në eficienten e biznesit.						

Pyetja 16: Mesatarisht, sa orë gjatë një viti trajnoheni për ndryshimet e legjislacionit tatimor?

_____ orë në vit

Pyetja 17: Duke gjykuar në lidhje me situatën aktuale, si mendoni ju, sa përqind e të ardhurave totale të një biznesi në industrinë ku ju operoni deklarohen për efekte tatimore?

_____ %

Pyetja 18: Si mendoni ju, cilët janë problemet më të rëndësishme që ju krijon kjo politikë fiskale në Shqipëri? Jeni të lirë të shprehni opinionin tuaj në lidhje me politiken fiskale.

Në qoftë se jeni të interesuar, jam e gatshme t'ju dërgoj një kopje të analizës së rezultateve të studimit!

☐ PO

☐ JO

Nëse **PO**, ju lutem shkruani adresën e e-mailit: _____

PYETËSOR DREJTUAR PUNONJËSVE

Qëllimi i këtij pyetësoi është të evidentojë problematikat e politikës fiskale dhe faktorët ndikues në performancën e administratës tatimore në Shqipëri. Rezultatet e përpunuara të pyetësorëve të grumbulluar shërbejnë për të nxjerrur konkluzione dhe rekomandime në kuadër të një punimi doktorature pranë Fakultetit të Biznesit, specializimi Financë-Bankë, Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”. Do ju jemi shumë mirënjohës për bashkëpunimin tuaj në plotësimin e këtij pyetësoi. Ju sigurojmë që ky pyetësor do të mbesin anonim dhe asnjëherë nuk do të bëhet publik ndaj asnjë pale. Pyetësoi i drejtohet _____ punonjësve të Drejtorisë Rajonale Tatimore.

Faleminderit paraprakisht!

Nevila Kiri, MK
Fakulteti Ekonomik
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Adresa email-it: kiri.nevila@gmail.com

SEKSIONI A: Informacion në Lidhje me Të Dhëna të Përgjithshme

Pyetja 1: Cilës prej grupeve të mëposhtme i përket mosha juaj?

- a. nën 30 vjeç
- b. 31- 40 vjeç
- c. 41- 50 vjeç
- d. 51- 60 vjeç
- e. 61- 65 vjeç

Pyetja 2: Gjinia juaj është:

- a. Femër
- b. Mashkull

Pyetja 3: Arsimi juaj është:

- a. nivel universitar (3 vjeçar ose 4 vjeçar)
- b. nivel pasuniversitar (master ose doktoraturë)

Pyetja 4: Pozicioni juaj në Administratën Tatimore është:

- a. Inspektor Tatimor
- b. Përgjegjës
- c. Drejtor Drejtorie
- d. Drejtor Rajonal

SEKSIONI B: Pyetje në lidhje me Politiken Fiskale dhe Menaxhimin Fiskal në Shqipëri

Pyetja 5: Duke gjykuar në lidhje me politiken fiskale në Shqipëri në Shqipëri, ju lutem jepni opinion tuaj në lidhje me pohimet e mëposhtme:

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Baza ligjore fiskale në Shqipëri është e qëndrueshme.						
2. Shkalla tatimore e TVSH-së është e arsyeshme.						
3. Shkalla tatimore e Tatimit mbi Të Ardhurat është e arsyeshme.						
4. Shkalla tatimore e Tatimit mbi Fitimin është e arsyeshme.						
5. Sistemi progresiv i Tatimit mbi Të Ardhurat është i përshtatshëm për situatën aktuale në Shqipëri.						
6. Norma e Kontributeve Shoqërore dhe Shëndetësore (për punëmarrësin dhe për punëdhënësin) është e arsyeshme.						
7. Procedura e rimbursimit të TVSH-së për bizneset është përmirësuar.						
8. Pagesa në avancë e Tatimeve rëndon gjendjen e tatimpaguesve.						
9. Vendosja e një norme të TVSH-je të ndryshme për kategori të ndryshme produktesh dhe shërbimesh është më e pranueshme.						
10. Skema e aplikimit të TVSH-së duke u bazuar në çmimet e referencës është e gabuar.						
11. Vlerat e penalteteve në rast shkelje ligjore janë të arsyeshme.						

Pyetja 6: Duke gjykuar në lidhje me çështjet e mëposhtme ju lutem jepni opinion tuaj:

(kjo pyetje është ndërtuar bazuar në një studim të kryer në Nigeri nga Shagari (2014)).

a. Eficienca e Administratës Tatimore

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Sistemi i Menaxhimit Tatimor në Shqipëri është kompleks.						
2. Administrata Tatimore në Shqipëri ka infrastrukturen e nevojshme për të realizuar menaxhimin tatimor.						
3. Sistemi i Mbledhjes së Tatimeve është eficient (përdor minimumin e burimeve për të marrë maksimumin e rezultatit).						
4. Mbledhja e vlerave të buxhetuara të tatimeve është lehtësisht e arritshme.						

b. Objektiviteti i Administratës Tatimore në punën e saj

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Në administratën tatimore ekziston burokracia.						
2. Punonjësit tatimor janë të pavarur (nga ndërhyrjet politike apo shoqërore) në realizimin e detyrës së tyre.						
3. Administrata tatimore është e pavarur në përzgjedhjen e punonjësve dhe nuk ka ndërhyrje politike.						
4. Përzgjedhja e subjekteve për kontroll bëhet në bazë analizës së riskut.						

c. Sistemi Informatik në Administratën Tatimore

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Sistemi informatik që përdor administrata tatimore ka mangësi serioze.						
2. Website i Administratës Tatimore plotëson nevojat e tatimpaguesve.						
3. Aksesit në Website-n e Administratës Tatimore është i mundshëm në çdo kohë pavarësisht fluksit të përdoruesve.						

d. Cilësia e Kontrollit Tatimor

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Kontrolli tatimor është shumë i rëndësishëm në arritjen e të ardhurave të tatimore të buxhetuara nga qeveria.						
2. Kontrolli tatimor (në administratën tatimore në Shqipëri) zvogëlon evazionin fiskal dhe parregullsi të tjera.						
3. Arsyeja kryesore e kontrollit tatimor është zbulimi dhe realizimi i të ardhurave.						
4. Arsyeja kryesore e kontrollit tatimor është zbulimi i të metave, ndreqja e tyre për të ardhmen dhe edukimi i tatimpaguesve.						
5. Inspektori tatimor është ka në dispozicion logjistiken e nevojshme për realizimin e kontrollit tatimor.						
6. Koha për realizimin e kontrollit është e mjaftueshme.						
7. Komunikimi me Tatimpaguesit është i vështirë gjatë realizimit të kontrollit.						

e. Transparenca kundrejt Tatimpaguesve

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Rritja e transparencës kundrejt publikut ndikon në rritjen e ndërgjegjësimit në pagimin e detyrimeve fiskale.						
2. Administrata tatimore njofton në kohë të arsyeshme tatimpaguesit për ndryshimet e shpeshta në legjislacionin tatimor.						

f. Trajtimi i Punonjësve

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Punonjësit e Administratës Tatimore kanë mundësi të trajnohen dhe zhvillohen përmes trajnimeve që zhvillohen.						
2. Punonjësit e tatimeve e kanë procedurën e punës qartësisht të shpjeguar.						
3. Orari i punës shtesë paguhet nga Administrata Tatimore.						
4. Punonjësi i Administratës Tatimore është i motivuar për të realizuar maksimalisht kërkesat e punës.						
5. Sistemi Tatimor nuk stimulon dhënien e rryshfetit administratës tatimore nga ana e tatimpaguesit.						

g. Kultura e Tatimpaguesve

(1-shumë dakord; 2-dakord; 3-mesatarisht; 4-nuk jam dakord; 5-nuk jam aspak dakord)	1	2	3	4	5	N/A
1. Tatimpaguesit kanë kulturën e domosdoshme në pagimin e detyrimeve fiskale.						
2. Tatimpaguesit informohen në kohë për ndryshimet e legjislacionit.						

Në qoftë se jeni të interesuar, jam e gatshme t'ju dërgoj një kopje të analizës së rezultateve të studimit!

☐ PO ☐ JO

Nëse **PO**, ju lutem shkruani adresën e e-mailit

Abstrakti

Shumica e vendeve në tranzicion përfshijnë nivele të larta të evazionit fiskal dhe shmangies tatimore kështu administratës tatimore (qeverisë) në Shqipëri i nevojitet të evidentojë problematikat e politikës fiskale, faktorët ndikues të sjelljes së tatimpaguesve dhe të përforcojë strukturat me qëllim përmirësimin e situatës dhe arritjen e një rezultati të mirë në realizimin e të ardhurave.

Ky punim ka synim të trajtojë problematikat e politikës fiskale aktuale, të evidentojë faktorët ndikues në sjelljen e tatimpaguesve dhe elementët ndikues në efikasitetin e administratës tatimore dhe të pasqyrojë ndikimin e kontrollit tatimor në performancën e administratës tatimore.

Studimi sugjeron përmirësime në drejtim të politikës së disa prej tatimeve të rëndësishme (tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi fitimin), kontrollit tatimor dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Nga rezultatet e punimit vërehet se norma tatimore, xhiroja, aftësia paguese e bizneseve, aftësitë e inpektorëve dhe kontrolli ndikojnë në nivelin e të ardhurave të deklaruar për efekte tatimore. Studimi evidenton faktin se burokracia, kultura e tatimpaguesve dhe trajtimi i punonjësve ndikojnë nivelin e efikasitetit të administratës tatimore. Nga rasti studimor konstatohet se zbulimet nga kontrolli tatimor zënë një pjesë të vogël në raport me të ardhurat e grumbulluara.

Fjalët kyçe: problematikat e politikës fiskale, efikasiteti i administratës tatimore, kontrolli tatimor, niveli i deklarimit të të ardhurave

Abstract

Most emerging economies are facing a high rate of tax evasion and tax avoidance, thus tax administration (government) needs to identify fiscal policy problems, factors affecting taxpayers's behaviour, to consolidate its own structure aiming to improve the situation and achieve a high performance in tax collections.

This study tends to deal with problems that creates actual fiscal policy, to evidence factors affecting legal compliance behaviour of taxpayer and efficiency of tax administration and to emphasize the role of tax audit in tax administration's performance.

The paper suggests improvements in tax policy of most important tax (value added tax, personal income tax and profit tax), tax audit and social and health contributions. From study's results is noticed that tax rates, turnover, business solvency, tax employee professional skills and tax audit influence income level declared from taxpayers for tax purpose. The study evidences the fact that bureaucracy, taxpayer's culture and employee treatment influence the efficiency level of tax administration. From the case study, is observed that tax audit findings are a small part of total income gathered.

Key words: fiscal policy problems, efficiency of tax administration, tax audit, level of revenues declared